

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

*13 - 2020
Vjeti V i botimit,
Shkodër*

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

13-2020

Vjeti V i botimit,

Shkodër

Redaksia:

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija,

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër
dhe Bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Përmbajtja

▪ Viti i Fishtës ▪

Letër e Luigj Gurakuqit drejtuar Atë Gjergj Fishtës 7

▪ Antologji e Festivalit Letrar të Shkodrës (2003-2020) ▪

Gjovalin ÇUNI

Dy rreshta mbi "Festivalin Letrar të Shkodrës"

EDICIONI I, VITI 2008

Stefan ÇAPALIKU

Kapter Behari (tregim)

Gazmend KRASNIQI

Shkodra (prozë)

Sokol ZEKAJ

Cikël poezish

Shpëtim KELMENDI

Epifania (poemë)

Ridvan DIBRA

Ku ke humbur "ty, hypocrite lecteur, - mon semblable,

- mon frere"?

EDICIONI II, VITI 2009

Skënder DRINI

"Përballje" (aforizma)

Primo SHLLAKU

Cikël poezish

Ledri KURTI

Sallatë "mix". Kujtohu (poezi)

Arben PRENDI

Çorodia (rrëfim)

EDICIONI III, VITI 2010

Ledia DUSHI

Me mujt me fjet (poezi)

Mentor QUKU (1939-2014)

Në vend të epilogut, përsëri në Itali

Fadil KRAJA

Letër djalit. Cingarja (poezi)

Paulin SHTJEFNI (1946-2018)

Cikël poezish

Nexhmi BUSHATI

Faqe burgu

Alfred ÇAPALIKU

Cikël poezish

EDICIONI IV, VITI 2011

Lisandri KOLA

Saga e një dite (prozë)

Brikena SMAJLI

Cikël prozë, poezi

Xhahid BUSHATI

Dedë Gajtani (Kola) – Mjeshtri shpirtpoet i përkthimit

Mehmet H. GUCIA (1943-2018)

O Mendime

EDICIONI V, VITI 2012

Hajredin KOVAÇI

Cikël poezish

Zef ZORBA (1920-1993)

Cikël poezish nga “Buzë të ngrira në gaz”

Arjeta FERLUSHKAJ

Letërsia Postmoderne dhe Lexuesi Dominantja

Postmoderne e Ridvan Dibrës

EDICIONI VI, VITI 2013

Astrit FANI

Cikël poezish

Albri BRAHUSHA

Atje ku gjenen fjalët (prozë)

Ilirjana STANKAJ

Cikël poezish

Rozafa SHPUZA

Cikël poezish

EDICIONI VII, VITI 2014

Zija VUKAJ

I fundmi i disidentëve. Për Skënder Drinin (Jo requiem)

Asllan BISHA

Dritaren lëre hapur

Dashmir CACAJ

Cikël poezish

Tonin ÇOBANI

Është grua**EDICIONI VIII, VITI 2015**

Lazër STANI

Korbat. Vonesat (prozë)

Dimitrov POPOVIÇ

Cikël poezish

Mustaf TUKAJ

(fragment nga romani) "Ajo dhe të tjerët"

Nikolin GURAKUQI

Apokalips (poezi)

Marçel HILA

Në Amerikë apo në Qaf të Barit? (prozë)**EDICIONI IX, VITI 2016**

Haxhi SHABANI

Cikël poezish

Kolec TRABOINI

Cikël poezish

Adrian PACI

Menditime mbi nënshtrimin e mbi larine

Shpëtim SELMANI

Cikël poezish**EDICIONI X, VITI 2017**

Arjola ZADRIMA

Cikël poezish

Vinçens MARKU

Hyrje mbi Letërsinë e Mesjetës evropiane (Perkthim)

Erion TEMALI

Dasma përvëluese (tregim)

EDICIONI XI, VITI 2018

Andreas DUSHI

Shoku yt, Baba (tregim)

Skender TEMALI

Cikël poezish

Edlira LLUKAÇAJ

Cikël poezish

Qamil GJYREZI

*Hyrje në Muzikologjinë konjitive”, të Niels Trusbak Haumann***EDICIONI XII, VITI 2019**

Jozef RADI

Cikël poetik

Frano KULLI

Mbamendjet e Ardian Ndrecës

Ahmet PRENÇI

Cikël poetik

Bashkim GOLEMI

Cikël poetik**EDICIONI XIII, VITI 2020**

Ag APOLLONI

Cikël poetik

Durim TAÇI

Fjalja tregim

Rudolf MARKU

Cikël poetik

Viti i At'Gjergj Fishtës

(1871-1940)

**LETËR E LUIGJ GURAKUQIT DREJTUAR
ATË GJERGJ FISHTËS**



I përndershmi Zotni,

Nji tufë atdhetarësh të qytetit të Beratit, të prekun në ndiesit mâ të thellat e zëmrës së tyne prej përgjigjes së drejtë, të ndershme e trimoshe me të cilën i patëtë kundërshtuem me anën e “Postës së Shqipnis” lëndimit të rëndë , qi dr. Rizov-i kishte hedhun disa kohë përpara kundër të drejtave të kombit shqiptar, patën menduem e dhânë vendim qi me Ju kushtuem një pendë ari në shëj nderimi dhe mirnjohsije për provën e re të shkëlqyeshme të dhânun prej Jush si atdhetar e si shkrimtar.

Në rasën e të shkuemit t’im në Berat, ZZ. Veli Efendi Libohova e Salih Gjuka, të cilët mâ tepër u përpoqën për të kryemit e dëshirit e vendimit të shokvet të tyne, m’a vûnë për barrë qi me Ju paraqitun pendën e artë të premtueme e të punueme prej një mjeshtri vendit.

Tue mbaruem me gëzim detyrën, qi mora për sipër, kam sot nderin me Ju dorzuem pendën e përmëndun. Kjo dhonti e çmueshme, qi Ju dërgojnë atdhetarët e Beratit, mâ tepër se një shpërblim e një nxitje

për Juve qi me vijuem në veprën t'Uej, do të jetë një provë e gjallë qi shqiptarët dijnë të çmojnë nderin kombtar e të mprojnë të drejtat e Atdheut të vet.

Ju ngjatjetoj me nder,

Miku i juej,

Alois Gurakuqi

Shkodër, më 20 prill 1918.

I Përndershëm Zotni

At Gjergj Fishta

Drejtuer i gazetës "Posta e Shqipnis".

SHKODËR

A.Q.SH. F17 D.36. Fl. 19

(Marrë nga "Hylli i Dritës"- XXXV/2015 Nr. 3-4, ff.245-246)

**Antologji e festivalit letrar të Shkodrës
(2003-2020)**

Gjovalin ÇUNI

**DY RRESHTA MBI
“FESTIVALIN LETRAR TË SHKODRËS”**



E keni ditun edhe ju, por gjithsesi edhe ne e përsëritsha, nuk baj gabim. Æsht thënë përherë e mâ së shumti, që bibliotekat janë vende ku ruhen, studiohen dhe krÿhet huamartja e librave. Pra, cilësohen funksione tashma tradicionale të saj.

Shumë mâ parë bota, por edhe te ne, sidomos me fillimin e mijëvjeçarit të ri, bibliotekat kanë krÿe lloj-lloj “operacionesh” apo ndërhyëmjes, janë përballue me një konkurrencë të fortë të mjeteve informative dhe kanë bashkëjetue, janë përballue edhe me ambientin që brenda përfshin edhe dÿshimet, paragjykimet, pse jo edhe refuzimet, aq sa në ambientet tona ndiejmë edhe të tilla shprehje ngallnjuese, fatkeqësisht të ashtuqjtuna të modës: “E unë nuk kam kohë me lexu libra!”.

Në një klimë të ktillë, vjete mâ parë tek po bisedonim me shkrimtarin shkodran Stefan Çapaliku rreth problemeve të bashkëkohësisë në biblioteka na lindi ideja e ndërtimit të një veprimtarie të përvitshme kulturore, që mâ sugjeroi me u emërtue: “Festivali Letrar i Shkodrës”.

Kjo nismë e fillueme qysh në vjetin 2003 tashma, sidomos vjetët e fundit, gjithnji me financimin e ndihmën e Bashkisë Shkodër e të kryetarëve të saj Lorenc Luka e Voltana Ademi, ka marrë tiparet e një institucioni kulturor që në themel ka trinomin: Autor-Vepër- Lexues. E për vite me radhë ky aktivitet nuk e ndërpreu rrugën e tij tue u kthye në një traditë pozitive ku vërtetë Autori dhe Vepra takoheshin konkretisht me Lexuesin, tue u takue fizikisht por edhe tue ngallitë njeni-tjetrin për ide e diskutime që mbajnë gjallë klimën kulturore të një qyteti apo të një kombi.

Festivali nuk u ndërtue si konkurim vlerash letrare, as me shpërnda çmime letrare apo me caktu rend si kush është shkrimtari ma i madh e as më i randësishmi. Megjithëse mban një emertesë të tillë, festivali u konceptue si një mundësi komunikimi e shkrimtarëve me lexuesit. Ky i fundit është çmimdhënësi dhe vlerësuesi i çdo shkrimtari. Ndodh shpesh që autorë të lauruem, pak njihen nga lexuesit, për mos me thanë se shkrimtarët e rinj nuk njihen aspak.

Përgjatë këtyne 13 vjetëve në këtë event letrar janë paraqitë rreth 50 shkrimtarë që kanë bashkëbisedue me lexuesit e tyne, të rritun e fëmijë. Mjafton me ba një llogari të thjeshtë, me një pjesëmarrje mesatare lexuesish prej 40 vetësh në çdo takim, për me vertetue se j□ vlejti një nismë e tillë. Emnat e autorëve të ftuem janë të brezave të ndryshëm e të përvojave të ndryshme letrare, tashma emna të afirmuem në kulturën shqiptare bashkëkohëse. E një kontribut modest e ka për këtë edhe “Festivali Letrar i Shkodrës” i cili i paraqiti publikut herë mbas here vlerat e veprës së këtyne autorëve.

Festivali ndonëse mban një emën lokal, krahas shkrimtarëve shkodranë, që jetojnë në Shkodër dhe jashtë saj, ka pasë të ftuem shkrimtarë nga kryeqyteti dhe nga hapësinat shqiptare jashtë kufijve, prej Ulqinit, Kosovës apo diaspora tjetër shqiptare.

Si promovues i këtij aktiviteti jam i bindun se kjo nismë kulturore ka me pasë jo vetëm vijueshmëni ndër vite, por edhe rritje në cilësi. Ndonëse në kushte mjaft të vështira të pranisë së Covid19 organizimi i sivjetshëm i Festivalit nën drejtimin drejtuesit të bibliotekës zotit Maxhid Cungu në mjediset e Muzeut Historik, ishte një arritje sa i takon organizimit dhe risive të sjelluna. Ideja e organizuesit për me e promovue Festivalin jo vetëm në bibliotekë, por edhe në institucionet kulturore të qytetit është një vlerë e shtueme. Drejtuesi i këtij Festivali sýnon që ky aktivitet kulturor me pasë edhe statusin e një aktiviteti

kombëtar në të ardhmen, gja e cila do t'ia rriste edhe ma tepër prestigjin këtij aktiviteti, tue pasë parasysh se Ministria e Kulturës synon me e propagandue kulturën e artin vetëm në Tiranë e krejt pak mbështetë aktivitetet kulturore në qytete të tjera.

Botimi antologjik, që revista “Gegnia” po realizon në këtë numër, me krijimtarinë e shkrimtarëve të ftuem ndër vite në “Festivali Letrar i Shkodrës” □sht një mundësi e promovimit të këtij aktiviteti dhe të autorëve pjesëmarrës. Lexuesi ka me pasë mundësi jo vetëm me shijue produktin letrar, por nga ana tjetër edhe me u njoftë me përmasat kulturore të këtij eventi. Autorët janë renditë këtu kronologjikisht, simbas viteve kur kanë marrë pjesë në Festival dhe përfaqësohen me krijimet e tyre letrare, poezi, prozë, ese, shkrime publicistike apo kritike, simbas dëshirës së tyre.

Shumica e pjesëmarrësve të Festivalit vijojnë me qenë aktivë në jetën kulturore e letrare lokale e mbarëkombëtare, por sigurisht asht rasti me ju ba një homazh edhe atyne që tashmë nuk janë mes nesh fizikisht veçse përmes veprës së tyre, si: Skënder Drini, Paulin Shtjefni, Mentor Quku dhe Muhamet H. Guçia.

Nji rast i veçantë ishte prezantimi i veprimtarisë së poetit të mirënjohun Zef Zorba, që u paraqit nga e bija, Elena Zorba.

Urojmë e dëshirojmë që kjo antologji me krijime të autorëve të ftuem në aktivitetin “Festivali Letrar i Shkodrës” që organizohet nga biblioteka publike “Marin Barleti” të ngjallë edhe një herë vëmendjen e lexuesit, por edhe të institucioneve të tjera kulturore kombëtare e sidomos të shtëpive botuese për veprën letrare të këtyne autorëve, e cila ka nevojë për mbështetje dhe promovim të matejshëm në nivel kombëtar e ndërkombëtar.

EDICIONI I, VITI 2008

Stefan ÇAPALIKU

KAPTER BEHARI
tregim

1.

U mbërthye mirë me kapotë, ngjeshi kapelen dhe, pak para se të mbyllte mbas vetes derën e apartamentit, u kujtua se kishte lënë radion ndezë. Pa orën. Ishte 13.45 e datës 26 nëntor 1972. Qielli i rënduar, era e fortë, ishin shenja të qarta se dimri kishte ardhë me vrull të madh. Nuk di pse iu shkaktua një ndjesi alarmi. Spikerja, një zë jashtzakonisht i njohur i Radio Tiranës, po llototiste diçka, si puna e: “Me nismën e Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe të Universitetit Shtetëror të Tiranës nga data 20 nëntor deri në 25 nëntor në Tiranë zhvilloi punimet Kongresi i Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe. Në Kongres u përfaqësuan gjerësisht forcat e shkencës, të arsimit dhe të kulturës shqiptare...” Këtu, tamam në këtë çast, kapterr Behari e fiku radion e vet “Iliria”, duke ia ndërprerë asaj fjalën në fyt.

Me të dalë jashtë diçka e akullt i ra ballit. Kjo do thoshte se temperatura kishte rrëshqitur shumë ndën zero. Por për fat punën e kishte ekzaktësisht 56 hapa larg banesës, domethënë diçka më shumë ose më pak se tre minuta. Por nëse të del dikush para atëhere mund të iknin dhe dy minuta të tjera. Pastaj pesë minuta zgjaste kontrolli i trupit dhe pesë të tjera ndërrimi i turrit me kolegun e vet, kapterr Kamberin.

Në burg qenë gjithsej 200 të burgosur, të rrasur në katër dhoma me nga pesëdhjetë vetë secila. Kishte gjithashtu edhe katër qeli që përdorshin për ndëshkime gjithfarësh. Burgu ishte më i vjetri në vend, i ndërtuar më 1938 nga Mbreti Zog, si burg i sigurisë së lartë. Përgjatë Luftës së Dytë Botërore u njoh si “Burgu nr.3” dhe më pas, si Reparti nr. 321. Pra, kapterr Behari po shkonte të merrte detyrën në Repartin nr. 321, i cili tashmë përmblihte të burgosurit më të rrezikshëm, armiqtë e pushtetit popullor, të cilët, në rast se Shqipëria pushtohej prej ndonjë shteti, do mund të shkëmbeheshin si pengje, apo të ekzekutoheshin një më një, në shenjë presioni kundrejt ndonjë situatë të paparashikuar.

Te dera kryesore prej nga hynte dhe dilte personeli qenë shkruar me të madhe dy parrulla: “Të zhvillojmë drejt dhe me vendosmëri Luftën e Klasave” qëndronte në ballë të kapakut të jashtëm, pra për t’u lexuar nga ata që hynin dhe parrulla tjetër “Armiku më i rrezikshëm është ai që harrohet” që në kapakun e brendshëm, pra për tu mbajtur mend nga ata që dilnin.

Kapterr Behari u shkëmbye me kapterr Kamberin te oborri. I la në dorë çelësin e apartamentit dhe i tha të bënte kujdes për groshën, që e kishte lënë të zihej mbi furnelën me vajguri, mbas derës së banjos.

- Ke edhe disa turshi domatesh, që kanë ngelë prej mbrëmë. Për bukë s’jam fort i sigurtë.

Kapterr Behari ndeshi në shikimin prej ujku të kapterr Kamberit, bash sapo dha lajmin se buka në mos kishte mbaruar, ishte kah mbarimi...

Kapterr Behari duhej të shkonte te dhoma e kulturës dhe të vazhdonte leximin e veprës të sapo botuar të shokut Enver Hoxha me titull “Njerëzit tanë janë të mrekullueshëm”. Ai ndërpreu rubrikën sportive që po transmetonte Radio Tirana dhe ia nisi leximit me zërin e tij femëror. E kishte lënë te faqja 55. Libri që marshallah. Ai ia nisi tamam aty kur shoku Enver fliste për veprat e mëdha të dritës, hidrocentralet. Tamam në këtë moment, kur kapterr Behari kishte ngjeshur gojën te mikrofoni, një mi i madh u shfaq në dhomën e kulturës dhe mbas tij edhe një mi i vogël. Ngjanin si macja me miun, e në fakt ishin dy minj. I madhi

ndiqte të voglin anë e kënd dhomës derisa i vogli u fut dhe u mbështoll me pecat e këmbëve të kapterr Kamberit, që i kishte lënë të thaheshin në fund të krevatit prej hekuri. Kapterr Behari kishte merakun e madh se mos duke parë me bisht të syrit minjtë mund të bënte ndonjë gabim në leximin e veprës, gabim ky që do të mund t'i kushtonte rëndë. Prandaj vazhdoi të lexonte i përqëndruar: “Ne e kishim parashikuar se udhëheqja revizioniste e Bashkimit Sovietik, e zënë për gryke nga vetë tradhtia e saj, do përpiquej të binte në kompromis me klikën e Dubçekut...”, mirëpo në këtë çast miu i madh iu fut midis këmbëve dhe gati sa nuk i kërceu në prehër për të lëpirë një njollë vaji që shndriste tamam te vendi i organit të vet seksual.

Këtu kapterr Behari u tremb dhe me një dorë fiku mikrofonin dhe me dorën tjetër ia futi sa mundi shpullë miut. Kur miu i turbulluar iku me rrokullisje diku nga fundi i krevatit metalik, kapterr Behari lidhi edhe njëherë altoparlantet me Radio Tiranën, që po transmetonte muzikë simfonike dhe u soll nëpër dhomë për të kuptuar më mirë se nga hynin ato minj gjigandë. Me siguri kishte ndonjë vrimë që lidhte dhomën e kulturës me kuzhinën.

2.

Kur shkoi nga kuzhina vuri re se në një kazan të madh ziheshin ca speca. Kuzhinieri, një kapterr i vjetër e pa asnjë dhëmb në gojë, pinte një cigare të mbështjellë me gazetë. Pistoletën e kishte mbështetë aty ku grinte qepët. Në tokë gjendeshin dy-tre thasë me qepë, që i kishin sjellë badihava për të burgosurit. Komandanti qe ankuar atje lart në Tiranë se viheshin re shenja verbimi në masë të burgosurit. Kjo kishte bërë që të merreshin masa konkrete. Të burgosurit mund të merrnin qepë jashtë norme në orarin e ajrosjes dhe t'i hanin ashtu të gjalla, si frutat. Bënin shumë mirë për shikimin.

Mbasi u përshëndet me kuzhinierin u nis për nga qelia e parë, aty ku prej një jave rrinte Pjetër Mëhilli, një i burgosur veteran, i dënuar me 25 vjet për tentativë të themelimit të Partisë Socialdemokrate. Pjetrit i kishin dhënë të përkthente nga anglishtja kujtimet e shefit të misionit britanik në Shqipëri, Klint Halmer. Ai me siguri që do ketë avancuar me përkthimin, që dje kur kapterri kishte qenë për herë të fundit. Kapterr Behari pastaj i dha urdhër rojes të hapte derën e qelisë së Pjetrit, ku e gjeti ashtu të kërrysur mbi një makinë të vjetër shkrimi.

- Erdha. Më lexo! - tha ai, dhe ia tërhoqi Pjetrit stolin. Pjetri pastaj u ul përtokë në atë dy metër katrorë vend, mori në dorë një tufë letrash dhe ia nisi.

- Po vazhdojmë me parathënien - tha Pjetri

- Aty ku e lamë dje pra.

- Po pra. Parathënien e Ditarit të Klint Halmer - tha Pjetri dhe vazhdoi me zë gjysëm të lartë:

“Klint Halmer ishte rreth 29 vjeç kur zbarkoi në Shqipëri për herë të parë në vitin 1943. Ai rridhte nga një familje e pasur angleze dhe gjyshi i tij ishte pronari i kompanisë më të madhe botërore të biskotave, Huntley&Halmers. Halmer kishte përfunduar studimet në Universitetin e Oksfordit dhe fliste frëngjisht, gjuha e huaj në të cilën Enver Hoxha mund të fliste pa përkthyes.”

- Shoku Enver Hoxha - tha kapterr Behari.

- Shoku Enver Hoxha - tha edhe Pjetri.

- Mirë, vazhdo! - tha kapterr Behari.

“Pasi kaloi një dimër të vështirë 1943-1944, Klint Halmer do të takohej për herë të parë me Enver Hoxhën në pranverën e vitit 1944.”

- Me shokun Enver - tha kapterr Behari.

- Me shokun Enver - tha edhe Pjetri.

- Mirë, vazhdo! - tha kapterr Behari.

“Në qershor të vitit 1944 u vra në mënyrë të mistershme kreu i misionit britanik Filip Lik dhe britanikët e zëvendësuan atë me Klint Halmer, që sapo kishte mbushur 30 vjeç.

Halmer, i ri dhe ambicioz, ishte i vetmi oficer britanik që fitoi respektin e Enver Hoxhës dhe ai mund ta takonte atë pa nevojën e një përkthyesi”.

-E shokut Enver - tha kapterr Behari.

-E shokut Enver - tha edhe Pjetri.

-Mirë, vazhdo! - tha kapterr Behari.

“Enver Hoxha nuk pranonte asnjë tjetër për të komunikuar dhe gjithnjë komanda aleate e Mesdheut i kërkonte Halmerit të negocionte me Enver Hoxhën. Në përfundim të luftës, Halmer u bë këshilltari politik i misionit Britanik në Tiranë dhe sërish ai do të ishte i vetmi që do të bisedonte me Hoxhën për tema të nxehta. Enver...”

- Po “me shokun Enver”, mor pis. Po është e treta herë që po të tërheq vemëndjen more mut. Po “me shokun Enver” more shkërdhatë. Po “me shokun Enver” more të qifsha robt e shpisë. Po kush të lejon ty,

more armik i betuar i pushtetit popullor, ta thërrasësh udhëheqësin tonë në emer.

- Më fal...

Dhe kapterr Behari iu lëshua me shqelma e grushte Pjetrit, i cili duke u kryspullosur pëshpëriste: “po ashtu është e shkruar more shoku Behar. Unë jam thjesht përkthyes, përkthyes. O kapterr Behari!”.

Në këtë çast, për fatin e madh të Pjetrit, dikush hapi me arrogancë sportelin e derës së qelisë dhe thirri emrin e kapterr Beharit. Ishte kuzhinieri. Ai si duket kishte përgatitë diçka të mirë për kapterr Beharin dhe i bëri me shenjë që ta linte atë punë se po i ftohej gjella.

3.

- Vazhdo! - i tha Pjetrit, duke pastruar dhëmbët me një fije shkrepse dhe në shenjë pendese i afroi një cigare, bashkë me fijen e shkrepse, sapo të dalë nga goja.

- Veçse shiko këtu! Lexo më shpejt! Më shpejt! Lëre parathënien! Kaloje! Dhe mos guxo ta zësh më në gojë emrin e shokut Enver. Ashtu...- foli me ton miqsor kapterri.

Dakort, tha Pjetri. U ul sërish në dysheme, shfletoi edhe njëherë letrat dhe kaloi direkt te kapitulli i dytë i librit. Pasi u kërrys mbi letra, kafshoi gjuhën që të prodhonte ndocapak pështymë, aq sa t'i lagej qiellza dhe foli me zë të ulët, duke theksuar edhe njëherë faktin se këto fjalë nuk ishin të tijat, por qenë thjesht përkthim. Klint Halmer thirret autori. Ishte anglez. Ia kishte dhënë Partia që ta përkthente. Ky vetë nuk qe hiç dakort me çfarë shkruhej në të e të tjera si këto.

- E di, e di, por vazhdo!

“Në darkën e shtruar për Vitin e Ri 1945 në Hotel “Dajti” pata afër gruan e re të ambasadorit jugosllav, shkelqësisë së tij Darko Maric. Pamja e rafinuar e së cilës duhet thënë se më magjepsi. Natyrisht që të kujdesesh për pamjen tënde fizike është hapi i parë për të tërhequr sytë e meshkujve, por është e rëndësishme që zonja Simona nuk e tepron. S’ka nevojë ta teprojë. Ajo si duket e di mirë se grimi i tepërt ose pamja vulgare përfundojnë duke korrë rezultatin e kundërt. Simona është prej atyre që e ka kuptuar që krejt e re se sensualiteti është një kombinim i sharmit, personalitetit dhe bukurisë. Bukuria dhe sharmi nuk maten me centimetrat e lëkurës së zhveshur.”

Tek po dëgjonte këtë fare teksti kapterr Behari vuri re dy gjëra: e para,

se i qe hapur goja tej mase dhe e dyta se mund t'i dëgjonte edhe dikush tjetër nga jashtë. Nga ana tjetër po afronte edhe orari i përfundimit të turrit. Kështuqë u ngrit në këmbë. Rregulloi koburen dhe rripin e mesit dhe vuri re se i qenë mpirë këmbët nga i ftohti i qelisë. Tjera herë do merrte me vete një batanijë. Do sillte me vete një batanijë, ndërkohë që Pjetri lexon.

- Ta ndërpres? - pyeti Pjetri

- Jo, jo vazhdo?

- Ti jap më shpejt?

- Jo, jo. Në asnjë mënyrë. Kush të tha më shpejt?!

Me më falë, tha Pjetri dhe shfrytëzoi rastin t'i kërkonte një cigare tjetër. Kaptërr Behari ia dha me një mendjehetësi të pashoqe. E ndezën që të dy dhe Pjetri vazhdoi, kësaj radhe interpretimin e vet:

“Kur Simona me të shoqin, simbas protokollit, erdhën e zunë vend në tavolinën time, ndjeva më së pari tonin e saj ngrohtë, qetësues, që bënte ndryshim me tonin e lartë dhe të qeshurat e mprehta të zonjës së konsullit rus, që qe ulur në tavolinën përbri.

S'do mend që kërcimin e parë ajo e bëri me të shoqin. Vërejta me një shikim diskret se ajo kishte veshur një palë këpucë me taka të tilla, aq sa mos ta nxirrnin më të gjatë se të shoqin. Tek kërcente dukej se po shijonte me të gjithë trupin e vet komoditetin dhe sportivitetin e këtij qëndrimi të relaksuar, pa e pasur fare mendjen te sytë e të tjerëve përreth.”

Por kësaj here kaptërrri ndjeu se uria po procedonte me ritme më të shpejta se kërshtëria e vet estetike.

- Mirë! - tha kaptërr Behari – Nesër duhet të vijojmë me pjesën tjetër. Është gjë e mirë që në këtë pjesë nuk permendet më as shoku Enver e as ndonjë antar tjetër i Byrosë Politike.

- Po - tha Pjetri- është gjë shumë e mirë që në këtë pjesë nuk permendet më as shoku Enver e as ndonjë anëtar tjetër i Byrosë Politike.

- Qepe ti! Ou ky! Na qenka gjë e mirë që në këtë pjesë nuk permendet më as shoku Enver e as ndonjë antar tjetër i Byrosë Politike?!

- Po këtë e thatë ju vetë. Sapo e thatë.

Atëhere kaptërr Behari, kësaj here i zënë ngushtë, foli atypëraty se Partia kërkonte që Pjetri të përkthente më shpejt dhe të kishte kujdes gabimet.

- Duhet edhe të njihesh më nga afër edhe me mësimet e Kongresit të Drejtshkrimit të Gjyhës Shqipe.

Dhe në vend që të dëgjohej një e përshëndetur për Pjetrin, u ndje emri i rojes që kapterr Behari thirri që t'ia hapte derën e qelisë dhe pastaj gërvima e shulit nga jashtë.

4.

Në orën 10 kapterr Beharit iu hapën dyert e parajsës. Mbesnin 56 hapa për të arritur te apartamenti i vet. I ftohti që shtuar në mënyrë galopante. S'e kish ndjerë fort deri më tash, ngaqë kishte ndenjor me krye mbi stufën e kuzhinës. Rojet që hapnin e mbyllnin derën nuk i përshëndeste kurrë, e aq më pak sonte.

Sapo hodhi këmbën e parë në rrugë pa se në të dy anët e saj qenë ndezur zjarre. Qenë familjarët e të burgosurve, të ardhur nga anë e anës që prisnin me ditë e me netë t'i krijohej mundësia e takimit me të afërmit që kishin brenda. Në ato tufa mbisundonin gratë. Zakonisht grupet që vinin ishin treshe: nëna, motra dhe nusja e të burgosurit. Qëllonte të ishte nëna me të atin dhe me motrën. Rradhë të zinte syri burra të rinj. Burrat e kishin të pamundur të vinin për shkak të pamundësisë për të munguar në punë. Gjithsesi nuk qe e lehtë të vije deri këtu. Përdroreshin kamionët që mbartnin mineral, që në kthim merrnin në rimorkio këtë soj e sorollop njerëzish. Merrnin me vete batanije, ushqime dhe furnella me vajguri, për të gatuar diçka aty në rrugë dhe për të ngrohë ndopak duart.

Hapi i 50-të e zuri tamam te hyrja e pallatit. Mbesnin edhe katër këmbë shkallë të ngjitej deri te dera e apartamentit të vet, të katit të parë. Qe një dhomë e kuzhinë dhe një banjo që e ndante me kapterr Kamberin. U lut që ta gjente zgjuar kapterr Kamberin në këtë orë, jo për gjë, po kapterri gërhiste fort. Ai edhe pse flinte nga dhoma tjetër prapë se prapë dëgjohej deri këndeje nga kuzhina, ku qe foleja e Beharit.

Në katin e dytë rrinte komandanti dhe në katin e tretë komisari i repartit. Kurse katin e katërt e banonin kuzhinieri me ndihmës mjekun, njërin apartament dhe oficeri me nënoficerin apartamentin tjetër. Shkurt ky pallat qe i gjithi i ushtarakëve.

Derën e gjeti hapur. Dhe meqënëse ata kishin vetëm një çelës, kjo ishte shenjë se kapterr Kamberi kishte fjetur apo thënë më me doreza, po dremiste në formën e një traktori sovietik me motor dy kohësh. Thithje dhe nxjerrje.

I hodhi një sy tenxheres së groshës. Dukej si e larë. Natyrisht që nuk

qe e larë, por e fshirë me trashamanllëk nga ana e kapterr Kamberit. Nanën ku ta ketë, shau me vete dhe u shtri. Pastaj u ngrit shpejt dhe i hodhi edhe një dru sobës thujse të fikur. Le të nxirrte ndoca tymb gjatë natës.

Kësaj rradhe, përveç pantallonave hoqi edhe donat e leshta. Do të masturbonte për lezet. Sonte ishte me Simonën. Asaj ia marrsha të keqen, tha, dhe ia nisi asaj pune me vrull. Simona, pupupupu çfarë pele që ishte atë natë... dhe pas dy minutash lagu veten deri ndër sy. Ashtu i lagur përtoi të çohet e të fshihej me ndonjë gjë, ndaj dhe u kthye nga ana tjetër dhe fjeti edhe ai si derr.

Të nesermen dëgjoi si nëpër ëndërr kapterr Kamberin që qe zgjuar dhe po kërkonte pecet e këmbëve. Me siguri që ora po i afrohej gjashtës. Tubat e ujit duhej të jenë ngrirë dhe me siguri që Kamberi kishte harruar të vente ibrikun te soba, që të kishte pak ujë, sa për të larë sytë. Ai shante me të madhe në mënyrë që ta dëgjonte edhe kapterr Behari, por ky nuk jepej. U kthye në krahun tjetër dhe ia nisi një të gërhiture, si për të dashur ta nervozonte edhe më shumë atë farë idioti. Kapterr Kamberi duhej të zhdukej sa më shpejt, në mënyrë që Behari të kryente punë edhe me të shoqen e konsullit rus.

Dhe kështu u bë. Pastaj kapterr Behari ashtu i lagur deri në fyt, u çua, u vesh dhe u nis për nga kafeneja në qendër të qytezës të pinte një kafe ekspres. Kafeneja ishte njëqind e njëzet e katër hapa nga apartamenti i tij, në anën tjetër të punës së vet. Pothuajse askush në rrugë. Vuri re sërish zjarret e shuara të vizitorëve të një nate më parë. Te kafeneja që thirrej “Rinia” qenë vetëm dy burra pensionistë. Liza, banakieria, ia bëri kafenë pa e pyetur fare dhe ia la mbi banak.

Mbasi piu edhe kafen, kapterr Behari mendoj me vete se më mirë do qe të shkonte më heret në punë sot dhe të kalonte prapë nga qelia e Pjetrit.

5.

Kapterr Behari hyri brenda si gjithmonë, pa u përshëndetur me rojet. Ai i bëri me shenjë njërit prej tyre t’ia hapte qelinë numër një. Pjetri natyrisht që ishte aty, mbështjellë me batanijen e vet. Për herë të parë në jetën e tij kapterr Beharit i erdhi keq t’ia merrte batanijen, ndaj edhe urdhëroi rojen t’ia sillte të veten. S’vonoi dhe kapterr Beharit i erdhi një batanije jeshile nga dhoma e “Këndit të kuq.”

Pjetri u habit pak kur pa këtë gjest human duke ndodhur aq natyrshëm para syve të tij, falenderoi duke ia liruar mikut stolin e vet, dhe u ul gjithë qef në çimento. Kësaj radhe ai kishte batanijën e vet ndaj dhe s'trembej aspak nga i ftohti. Kësisoj ishte mirë. Ndaj edhe ia nisi leximit me një zë të ngrohtë:

“Kur u ul në tavolinë, me një marrje të lehtë fryme, u kthye nga unë, buzëqeshi lehtë, duke treguar ashtu si padashje një vetbesim, që i qe ulur në gjestet dhe zërin e saj.

Unë bëra sikur belbëzova diçka, por ndërkaq ajo kërkoi që t'i ofroja pak kripën me piperin, dhe zgjati dorën e saj të bardhë, me gishtërinjtë e gjatë, duke e cukur paksa dorën time mbi tavolinë dhe duke e shoqëruar kësaj me batutën “Ju lutem”.

Mbas disa çastesh, kur vemendja e saj u duk sikur iku sërish nga i shoqi, e pyeta se kush do ishte muzika me të cilën ajo do dëshëronte të kërcente. Dhe u mahnita kur ajo shqiptoi aty për aty dhe pakurrfarë sforcimi “Lindy hop”

- Çfarë?-pyeti kapterri?

- Lindy hop- tha Pjetri

- Po përktheje more burrë! - foli për herë të parë me të butë kapterri.

- Ah, po. Lindy Hop është një vallëzim amerikan, i cili lindi në komunitetet afro-amerikane në Harlem, në New York City domethënë, që më 1928. Natyrisht që ky kërcim ka evoluar që nga ajo kohë. Ishte shumë popullor gjatë fundit të viteve 1930 dhe fillimit të viteve 1940. Bazohet kryesisht në muzikën xhaz, tap, dhe charleston.

- Kuptova- tha kapterr Behari. Vazhdo, vazhdo.

Pjetri çoi kokën dhe pa një fytyrë njerëzore. Po, ishte kapterr Behari. Ai që i kishte thyer brinjë një ditë më parë. Pastaj iu duk sikur u panë në sy.

- Vazhdo...

- Po.

“Ndjeva me të vertetë se po çmendesha mbas saj. U ngrita dhe shkova te orkestra. Orkestrantët qenë absolutisht më të mirët dhe nuk bënë ndryshim me bandat e Londrës. Maestro Guraziu priti sa t'i ofrohesha tryezës dhe lëshoi akordet e para tamam kur dora ime u shtri drejt saj në formën e një lutje, thujse kalorsiake.

Lindy hop ishte një mrekulli për Tiranën e asaj kohe. Me dorën time të majtë kapa të djathtë e saj dhe pastaj mbas një rrotullimi e djatha ime i shkoi te beli, kurse e djathta e saj mbi supin tim.

Me këtë hapje dhe mbledhje kështu të menjëhershme, ne jo vetëm që zumë gjysmën e pistës, por edhe morëm vëmendjen e të gjithëve.

U dëgjuan zëra në oborr. Klithma. Dikë e kishin nxjerrë jashtë në brekë dhe kanatiere. Zakon i vjetër ky, para se të dënonin dikë me izolim në birucë. Ishte e pamundur të lexoje tek dëgjoje ulurima të tilla njerëzore.

Si duket edhe kapterr Behari e kish kuptuar këtë. Ai ndezi një cigare dhe instinkti e shtyu të ia drejtonte një edhe Pjetrit. Me këtë rast ai e ndezi dhe u ngrit të shpinte këmbët dhe kurrizin. Kapterr Behari pati idenë se do ishte e mira të shikonte pak nga sporteli i derës së qelisë se çfarë po ndodhte realisht në oborr. Nuk ishte e mira ta gjente kush këtu e, aq më tepër duke pirë duhan me një të dënuar. Por në oborr qe rrëmujë e madhe. Dhe ndërkohë që kapterr Behari po përgjonte nga vrima, Pjetri mori frymë thellë dhe u bë gati të mblidhte letrat. Sot kishte shkuar çdo gjë mirë.

- Ma jep vazhdimin - tha Behari- e lexoi vetë. Dua ta marr vesh si shkoi kjo punë.

Këtu Pjetri deshi të kundërshtojë, por një instinkt i kahershëm mësuesi ia mbajti gojën. E si mund të ndalonte dikë që donte të lexonte?!

6.

Kur doli të shkonte për të ngrënë në shtëpi pa një grua të vjetër duke bërë petulla mbi një furnellë me vajguri, te një tigan me bisht të shkurtë.

- Hajde, merr nja dy petulla. Janë të nxehta - tha ajo dhe i zgjati kapterrit një tenxhere të vogël të mbushur me avull.

Kapterr Behari frenoi. Shikoi para dhe mbrapa se mos po e vinte re njeri dhe ashtu si ishte i uritur, ia mori.

- Kam djalin këtu. Mbas pak kemi takim. Atij gjithmonë i kanë pëlqyer petullat, - vazhdoi ajo - të nxehta.

Kapterr Behari u largua pa bërë zë dhe aty për aty kuptoi se ajo plakë e gjorë merrte me vete furnelën, tiganin e të gjitha harxhet e tjera, që i biri t'i hante të ngrohta. Seç pati pastaj një kthim te nëna e tij atje në fshat, por shpejt e davariti atë ndjesi. Te hyrja e pallatit u ndesh me gruan e komandantit që po kthehej nga shkolla. E kishte gojën plot me petull dhe nuk diti as t'i flasë. Po ajo qe zonjë grua dhe nuk do t'i tregonte gjë komandantit.

Ktheu edhe njëherë kokën nga burgu dhe pa se dikush, një puntor

komunaleje, me një kovë gëlqere në dorë, po shlyente nga një sipërfaqe muri një parrullë armiqsore, që duhej ta ishte shkruar dikush gjatë natës: “Burrel, hyn e s’del”. Dhe shikimi iu turbullua në kërkim të një fokusi të ri.

Me këtë turbullim shikimi hyri në apartament, ku ia nisi punës për të përgatitur groshën e së mërkures. Vaj në tigan, pastaj qepë të grira, ndërsa në tenxhere niste zierja e groshës. Mori do ujë nga një bidon plastik pesë litërsh që e ruanin për emergjenca dhe e hodhi aty ku do zihej grosha. Diku nga mesi i procesit ato bëheshin bashkë. Në fund i hidhte edhe salcën dhe kripën. Por, për drej kishte qëlluar groshë që nuk ziente kollaj. I donte më së paku një orë. Kështu që me të skuqur qepën, iu desh të priste.

Atëhere nxorri nga xhepi letrat që i kishte dhënë Pjetri dhe ia nisi të lexonte me zë të lartë. Por jo. Nuk e di se çfarë kishte në atë tekst. Ose kapterr Behari nuk dinte të lexonte ose në gojën e tij e gjitha tingëllonte si teneqe.

Mirë, tha me vete, ndoshta do mund të mësoj kërcimin. Si i thonin atij? Ah, po “Lindy hop”. Kështu pra: “Me dorën time të majtë kapi të djathtën e saj dhe pastaj mbas një rrotullimi e djatha ime i shkon asaj te beli... Ja kështu, dhe kapterr Behari bëri një rrotullim perfekt në mes të kuzhinës së tij, shtruar me pllaka betoni. Kurse e djathta e saj mbi supin tim, tha dhe u hap.

E gjithë kjo, instiktivisht dhe padashje i solli ndër mendje se nuk kishte dhjerë në mëngjes. S’e kuptonte pse. Si rregull grosha duhej të bënte efektin e kundërt, por ja që ndodhte. Për fatin e tij të madh kapterr Kamberi nuk kishte dhjerë në shtëpi atë mëngjes, kështu që wc-ja alla turka gëzonte një farë higjene. Grisi gazetën e djeshme “Zëri i Popullit”. Si gjithmonë faqen e katërt, aty ku botoheshin lajmet e jashtme dhe u ul ta bënte. Lajmet flisnin për disa greva të minatorëve të Kongos. Diku tjetër kishte diçka për njësitet gurrile palestineze në luftë me sionistët izraelitë si dhe disa kronika të tjera më të vogla për sportin e peshëngritjes.

Duke ndenjur ashtu galuc dhe pa asnjë rezultat të pritshëm, i shkoi mendja se në atë darkë Viti të Ri 1945, të shtruar në Hotel Dajti, në mos vetë shoku Enver, duhej të kishin qenë të paktën Mehmeti, Tuku apo fundja shoku Spiro...

Gazmend KRASNIQI

SHKODRA



Jam i interesuar të di nëse jemi mbi Shkodër, por nuk kuptoj gjë, sepse ekranet e avionit nuk japin tregues se ku po fluturojmë.

Më kujtohet vajza. Në moshën 4 vjeçe, ajo duhet të mësohet me idenë se babi ka një punë tjetër dhe se mund të komunikojmë vetëm me anë të skype-it. Unë duhet të mësohem me idenë se ndërsa shkruaj në ndonjë park vjenez, fëmijët që vrapojnë do të ma kujtojnë atë.

Ajo do të shkojë të jetojë ca ditë në Shkodër, ku mami i saj do të vijë të kalojë ca ditë në Vjenë dhe dua të di nëse ka cinizëm në

raportin me vajzën tonë.

Dua të më kujtohen njerëz që kanë nënën apo gjyshen austriake.

Si vinin ato për të jetuar në Shkodër?

Që Shkodra është një qytet i vjetër, e tregon edhe kështjella e saj.

Dikush mund të thotë se bien në sy veshjet e ca kohëve më të reja, por ka njerëz që do t'ju çojnë te një copë muri i cili flet për ca kohë antike.

Sigurisht, mund t'ju thonë edhe çfarë shkroi Tit Livi në vitin 168

p.e.s., kur foli për disfatën e mbretit Gent, varrin e të cilit duhet ta kërkonte në tokën e romakëve.

Meqë në Shkodër ka kaluar njëra nga kryqëzatat (1101), përfytyroj një prift, benediktin ose domenikan, i cili pëlqen shumë gjithçka përreth. Ai i dënon me vete të parët e tij barbarë që dikur e kanë shkatërruar e djegur këtë vend.

Sipas tij, këtu duhet një kishë. Sado e vogël. Ndoshta i pëlqen për të jetuar këtu, por e prët rruga e gjatë për në Jeruzalem.

Kjo kapelë e vogël, shtatë metra gjatësi, ka jetuar deri përtej messhekullit XX, në kohën e tërbimit ateist komunist.

Përfytyroj Marin Bainën duke ëndërruar për të gjitha këto:

Nuk ka poet që nuk e pëlqen historinë.

Marin Baina nuk mund të bënte përjashtim.

I pari shkodran që ka shkruar për Shkodrën, është një Marin tjetër: Barleti.

Ai është i pari që e bëri Shkodrën të njohur në të gjithë Europën.

Ai i bëri Shkodrës një monument, por për vete nuk ka asnjë të tillë.

Sigurisht, mendoj (kush më kundërshton dot?!), as Marin Baina nuk do ta ketë.

Rrugëve të ngushta të liqenit (qoftë dhe në përfytyrim), sigurisht, Marin Baina ëndërronte për femrën e tij.

A nuk është e çuditshme ta mendosh se autorët e vjetër nuk e përmendin qenien e këtij liqeni gjigant?!

Sidomos kur je poet!

(po kush na siguron se Marin Baina nuk kërkonte këtyre brigjeve rrënojat e shtëpive ku besohej se fshihej Diamanti Vrasës?)

Dihet se Marin Barleti bëri të famshëm edhe Heroin Kombëtar, Gjergj Kastriotin Skënderbeun.

Në kreun e parë të librit të parë me ese të Montaigne-it, do të shihni se paragrafi i tretë flet për “Scanderberch, prince d’Epire”.

Një paragraph më përpara rri Edouard, *prince de Galles*, kurse një paragraf më pas *L’empereur Conrad troisieme* (Perandor i Gjermanisë).

Titulli i kreut:

Par divers moyens on arrive á pareille fin.

(Prej burrash të ndryshëm të mesjetës me arrit te një përfundim i

ngjashëm)

(Ose: qëllimi arrihet me mënyra të ndryshme.)

Montaigne-i hap librin e tij me idenë se mënyra më e mirë që të zbuten ata që kemi fyer, janë përdëllimi ose mëshira, megjithatë, kurajoja, qëndrimi burrëror dhe vendosmëria kanë pasur të njëjtin efekt.

Siç bën të gjithë këtë vepër të madhe, ku përdor histori e anekdota të ndryshme, Montaigne-i ngre këtë argument me Skënderbeun:

Skënderbeu ndjek për të vrarë një nga ushtarët e vet, me gjithë lutjet e përdëllimet e këtij të fundit për falje. Në çastin e fundit ushtari ngre shpatën përballë Prijësit dhe këtij të fundit i pritet turri.

Skënderbeu, duke parë këtë kthesë të ngjarjes, jo vetëm që e fal ushtarin, por do ta mbajë më pranë vetes.

Montaigne-i nuk harron ta mbyllë argumentin me fjalët:

Vetëm ata që nuk e dinë se çfarë luftëtari i jashtëzakonshëm që Skënderbeu, mund t'i japin kësaj historie një kuptim tjetër.

Montaigne-i vetë është një hero:

Pagëzoi një formë të re të të shkruarit.

Që të mos kemi hatërmbetjen e Senekës me shokë, fjala pagëzoi është shumë e drejtë.

Tri preokupimet e tij kryesore:

- Vetënjohja si kusht për të njohur të tjerët
- Vdekja
- Edukimi i epokës (për një jetë të virtytshme dhe më të mirë).

Montaigne-i tha:

Jam unë ai që mendon...

Jam unë vetë material i librave të mi...

Esetë e mia nuk janë tregime a histori, por unë vetë, thelbi im...

Emerson-i e adhuronte Montaigne-in, përderisa i thotë dikujt:

Do të doja të shkruaja një libër si Montaigne-it, plor humor, poezi, brumë, hyjnitet, filozofi, anekdota e palavi.

Ky pohim mbetet një pohim e kaq, por na tregon për të mundshmen.

Palavi - fjalë të ndyra, qelb. Ose: prish gojën, fëlliq, ndyj. Fjalë e përdorur në shkrime së pari nga bashkëkohësi i Montaigne-it, Pjetër Budi.

Me mkat gjith palavuom.

Këto kanë mbetur vetëm pronë e poezisë. Kohët moderne s'para lexojnë poezi, kur mungon imagjinata për të kuptuar se si shkallmohet perandoria e gjuhës.

Montaigne-i thotë atë që duhej të ishte vënë në krye të këtij libri:

Ka më shumë libra për librat, sesa tema për ta. Ne s'bëjmë tjetër, veçse interpretojmë njëri-tjetrin.

Duket sikur e thotë Borges-i në shekullin që lamë pas.

Duket sikur e thonë klasikët kinezë.

Ne, të tjerët, ngurrojmë ta themi me zë një fjalë të tillë prej Zoti, sepse jemi gjithmonë në kërkim të këtij të fundit, arsyeja ku gjendet bindja.

Kurse në krye të këtij kapitulli duhet të kisha treguar se si më ra në dorë libri i Montaigne-it.

Dikush një herë më tregoi ca çelësa dhe më tha se ata janë të një dhome me libra të ardhur nga Austria.

Një universitet austriak që binjakëzuar me universitetin e Shkodrës.

Që unë kam disa libra antikuarë të gjuhës gjermane, i dedikohet atyre çelësave dhe zellit të austriakëve për të ndihmuar arsimin.

Më krijohet ideja se kështu, edhe pa i njohur, paskam prekur duart e ca austriakëve.

Udhëton mendja, por udhëtojnë edhe vetë gjërat.

Që Marin Barleti i ka bërë të njohur Shkodrën dhe Skënderbeun, e tregon edhe përmendja e shumë të që u bëhet atyne në letrat e disa personazheve të kohës, kalorës aventurierë apo qëllim-mirë, dërguar nëpër disa kancelari të kohës, sidomos mbretit të Spanjës, superfuqia e kohës, por edhe papatit, sa të krijohet bindja se është shekulli i tyre, para se t'i kaplonte letargjia qindravjeçare. (Vetëm pas qëndresës antiturke do të ngrihej ylli i Habsburgëve vjenezë.)

Janë shumë nga këta kalorës që mendojnë se duhet filluar nga Shkodra.

Do të fitohen menjëherë kaq e aq ushtarë, edhe nga pala myslimane, sepse ata janë kriptokristian dhe mezi ç'presin për të shpëtuar nga zgjedha e turkut.

Pra, megjithëse bëhet fjalë për çlirimin e Ballkanit, Shkodra shihet si një qytet kyç.

Se çfarë ka bërë Marin Baina për Shkodrën, presim të flasë historia.

Ngjitesha shpesh herë në kështjellë, por mbaj mend atë ditë kur sipër meje pashë një zog.

Nuk e mbaj mend në ishte skifter apo korb.

Kur po vështroja lart dhe ndiqja lëvizjen e tij, fare papritur, gjuha u rrëmbye aq shumë, sa në çast kreu edhe një herë, në praninë time, martesën e lashtë me zogun.

Duhet të themi se shkrimtari i mirë nuk thotë më tepër se atë që mendon.

Thënia është jo vetëm të shprehurit, por pikërisht realizmi i të menduarit. Kështu ajo nuk është vetë një shprehje e dëshirës për të arritur një qëllim, por edhe arritja e saj.

Duhet të themi se shkrimtarit të keq i kujtohen kaq e kaq gjëra, por pikërisht për këtë ai nuk mundet asnjë herë të thotë esëll atë që mendon.

Duhet të themi se shkrimtari i mirë nuk thotë kurrë më tepër nga çfarë ka menduar:

Shkrimi nuk i sjell dobi vetëm atij vetë, por asaj çka ka dashur të thotë.

Monedha ku shkruhet “Skodrinon” i përket shkullit III para Krishtit, pra Shkodra është bashkëkohëse me Athinën dhe me Romën. Pak qytete të botës e kanë këtë privilegj.

Atëherë Vjena ishte kelte, fqinje me ilirët.

Autorët antikë nuk përmendin liqenin, por flasin për një Bunë të lundrueshme, sepse nëpër Bunë erdhën anijet që sollën përfaqësuesit e Romës, vrasja e të cilëve do t'i kushtonte luftën mbretëreshës Teuta.

Kjo mbretëreshë, që i rriti me shpejtësi kufijtë e sundimit të saj, sigurisht, është femra më e shquar e shekullit të vet.

Genti, mbreti i fundit që u qëndroi romakëve në fushën para kështjellës (gabimi taktik që i kushtoi betejën), do të merrte me vete (siç thotë Plini Plaku te libri “Historia naturalis”) Gentiana lutea-n, bimën ose ilaçin më të mirë për plagët e marra në luftë.

Historia (lavdinë dhe palavdinë) e mbartin librat e biologjisë ose të enciklopedisë së përgjithshme.

Sokol **ZEKAJ**



LIQENI NË DIMËR

U zgjerua liqeni një zgjimi të papritur,
Hyri livadhesh që patë bleruar në verë
Ku lopët herë - herë duke harruar etikën,
Kujtonin fëmijërinë a rininë si atëherë,

Pas një lodre të afërt sa të pamundur,
Te njëri sy - e kaltër, te tjetri - e verdhë.
Në ujërat pushtuese, peshku vallëzues
Sot lot me gjurmët e bareshës së bukur.

Vështroj pa pasione këtë liqen lëbyrës
Ku derdhet argjendi i diellit i shkrirë
Duke endur kurora e duke i flakur valëve
Si shpirti i njeriut në ditë dashurie.

Nën ujë asht e shtrirë hija e shelgut
Mbetur bërthyer te gjëlpanat e barit
Dridhet si pëlhura n' krahor nga fryma
Ah, po, si pëlhura e një fustani të kaltër!

POETI

I
O hënë, ndritma dritaren
Por mos ma digji letrën
Që më fluturoi nga dora!

II
Gjithkush e ka gjakun të shtrenjtë
Më mirë se eshtrat e mba në këmbë.

Po kur padashur një gisht e ther
Pa dert e shtrydh që gjaku të bjerë.

Mendo poetin që theret në zemër
Ndër ferra jete, si zbehet mbi letër!

NJË PLAK PO THUR GARDHIN

Një plak po thur gardhin e arës
Me ferra gardhin po e thur
Dhe i kundron me shpirt në paqe
Si mermerin përmbi mur.

Nga ferrat duart i janë lëruar
Siç është lëruar ara e tij
Me gjak po njomet e bekuara
Thua se mbillet me flori.

Po ç' është florir? Plaku i pakët
Cigaren ndez te syri i zjarrtë
Nga goja i del një tym i kaltër
Sikur i digjet shpirti i artë.

SHTËRNGATA

I
Era e grafullon, e kreh trëndafilin
Me pasionin e shenjtë të shiut
Për simfoninë e gjetheve dhe
Piruetat e luleve plot nur nusëror

Ç'muzg i mundimshëm po bie
Për një mëngjez mbretëror!

II

Në fillim ish era mbi pendët, pastaj
Një shi i forte, shi diamantesh, shi inxhi,
Ia bani pendët të tana gjëlpana
Mbi shpirtin e etur për kaltërsi.

Mos qaj zogo, dhe mos e shaj qiellin!
Ai ka me këtë pyll një akord dashurie
Që t'krijon ty njomësinë e egzistencës
Në dritën prej biluri të agullimit.

III

O shtërgatë shiu, breshëri e ere,
E qetë shkunde fshatin tim,
Fshatin tim me përroje hane,
Deri në shëndritje e margaritarëve!

Shpëtim **KELMENDI**

EPIFANIA



X

Katër metra larg hijes nëpërkambet
dinjiteti i sendeve që kanë frymemarrje.
Vëmendjen tonë, shpuplue ndër sorollatje t'kota,
kuptimi i fshehtë i çështjeve të zgjidhuna,
me logjikën e mbijetesës, që troket n`pleqni,
si mysafir i vonë e na gjen mungesë.
Tradhëtue nga shëndeti, materiali e guximi,
harta shekullore e fjalëve ku më kot lypëm
thesare landore e poqëm në hell përkohësinë,
rruga e përshkueme, ku dot nuk e zgjuam
vetëdijen e ndryshimit të pandalshëm,
kali pa kalorësin që mund të ishim ne,
mëshira hyjnore mbi sende e gjallesa.
Vonesa në takimin e fundëm tek shënon
fillimin e një fundi që s`i dihet moshë.

Në lumenjtë e turbulluem të gjakut,
 kur përmytën të vjellat e mandej vjellim.
 Një bukë të hidhun amëshimi dhe epokat
 përmbi na bien si ortiqet, e rreziqet,
 si hijena, enden ekzistencës sonë.
 Në etjen e pellgut rilind imazh i qiellit
 e mjeshtri e shfletimit të pamjeve t`reja
 që heshturazi janë rritë bashkë me ne,
 me barin, me pemët, qenin që leh te porta,
 ditët që s`jetuam e mureve përvidhen
 si hardhucat netëve të vona kur pushojmë.
 Punë e mërzi e tymosim cigaren e fundit
 që shuhet udhës së kthimit në vetëdije.
 Dhe asht e gjatë, por shejtnohet sa ora çasti
 i tejpërsëritun, kënaqësi e pashijueme,
 mungesa e fjalës, dhimbja e panjohun që trokon,
 fshesa natyre në duart e jevgës e jevga
 kur qurrat fshin me mangë, heshtja me në zemër.
 Putrat e maçokut plak e planet për ditën
 që s`vjen, fishkëllimë e trenit afrue në stacion
 dhe rruga, dhe rruga që kurrë nuk mbaron.

XI

Çasti nuk sjell jetë, por gjasa kuptimi mbi jetën
 e deritashme, ashtu si zogu me fijen e barit
 në sqep ndërton folenë e së ardhmes
 në mot të kthjellët pa ia beh stuhija.
 Kujtim i mosqënies në shëndet të mirë
 shtyn portat ku dëshpërohet vullneti,
 por dhe tërsëllima e shkapetjes me durimin
 a me natën që përton të ikë e në duar
 na len një shëmbëllyrë të ndritshme,
 si ftyra e laturisun e një kurve t`braktisun,
 përkulë ndaj kurmit të rrëgjuej të qenit plak,
 na kujton atë që duhej t`ishim kur flejmë.
 Katër hapa larg zbulimit e s`e dijmë.

Përplasja e të kundërtave, mirëkuptim i mërzisë,
 unazat e së keqes ndër gishtat e gjatë të haresë,
 prani e të vdekunit, mungesë e kujt rron
 në zgrip të vëmendjes, njësimi i shqisave,
 frymëmarrja bleroshe e sendeve, fjalët që thonë,
 mëkim i së dukshmes me vështrimin tonë.
 Muzika ngjethëse e ujit tek shtëpi e vjetër,
 ku hyjnizohen mornicat e dimnit në papafingo
 me vdekjen që dremit pranë teje e s'ë shpalos
 njëherësh virtytin e zgjimit por kafshon nga pak.
 Toka e ndjesi të mbjella me veten çdo mbramje,
 kundërmuese prej pikëllimesh të freskëta,
 janë dije tjera kohësh e botësh e shfaqje
 të fundme para se të shuhet vezullim i mishit
 që kurrë nuk u la në lumë të Heraklitit.

Ndoshta fati ynë asht në pëllambën e shtrime
 të burrit që jo pare prej nesh, po mëshirën e Zotit
 lyp për ne e dashurinë e shndrrueme në kujtim,
 në ndjesinë e fajita për brenga e dhimbje njerëzish
 që s'i njohën kurrë, e mugullon në mbramje
 si fëshfërimë e gjetheve të limonit dhe kërkërimë
 e hanës që rrokulliset tjegullave të thyeme
 me në bark dhimbjen tonë të papërtypun.
 Dita e re s'na përmban, teptisim në të shkueme
 tue shkelë barin e së ardhmes me trifilin
 e shpresës ndër dhambë, e mbramjen që kollet
 nën qiellin e përhimtë të mendimit.

Ridvan **DIBRA**

KU KE HUMBUR “TY, HYPOCRITE LECTEUR, - MON SEMBLABLE, - MON FRERE”?

- Shënime kinse autobiografike-
(Shkëputur nga vëllimi me ese “Dekalogo i Turpit”)

1. Prologu



Me një trastë aspak të leshtë para këmbëve – mbushur dinga me libra dhe jo me baltë Bune a gurë Rozafati, ngjeshur në një makinë që “përpin rrugën si harusha” e troshitet më keq se varkat në Liqenin e trazuar, i kthej shpinën Shkodrës sime “provinciale” (Zot i Madh, sa guxim duhet ta quash të tillë qytetin tim të lindjes!) tamam aty ku “zhduket Buena nën një kodër, zhduket Drini nën një mal”; synimi:

të arrij sa më shpejt në metropol.

Dje bëra një kërkim nëpër të gjitha libraritë e qytetit *tim*: nuk ishte shitur asnjë prej librave të *mi*. Librat *tuaj* janë tepër të avancuar për lexuesit provincialë të qytetit *tonë*, më kishte ngushëlluar njëri prej librashitësve. (Duhej të ishte zgërdhirë, sapo i kisha kthyer shpinën. *Hamendje e imja*. Rd). Kurse unë i kisha thënë vetes (për të njëqintën herë): Askush nuk është profet në vendin e vet. Dhe në çast kisha marrë

vendimin e rëndësishëm: ta mësyj Metropolin! Bashkë me librat e mi.
Dhe ja ku jam ne Rrugë të Madhe.

2. Libra dhe librashitës

Përshëndetjes sime të përvuajtur e plot politesë (Pppp), librashitësi i njëjës prej librarive në qendër të Metropolit i përgjigjet përtueshëm (pp) sapo dallon trastën e fryrë mbi shpinën time.

“Libra?”

“Libra”, përgjigjem me zë të mekur dhe një ndjesi e lehtë frike më përfshin të tërin, thua se ai përballë meje ka zbuluar “një armë pa leje” e që unë e mbaj të fshehur diku nën xhaketën time *postmoderne*.

“Të tutë?”

“Të mitë”. Ul trastën para këmbëve dhe mbushem me frymë.

“Jo, ngarkoju prapë”, thotë rrufeshëm librashitësi dhe tregon me gisht trastën para këmbëve të mia. “Nuk kam vend. Dollapi i Letërsisë Shqipe (DLSH. *Shkurtim i imi. Rd*) është plot. Sa s`po thyhet”.

Ashtu i kërrusur nën peshën e librave të mi, bëj dy hapa para, mandej një prapa dhe më pas tre të tjerë përpara, derisa gjëndem ngjitur me raftin e Letërsisë Shqipe. Librashitësi kishte pasur të drejtë; aty nuk ka vend as për librin e hollë të një fillestari dhe jo më për romanin tim të *parafundit*, që i kalon të 300 (treqind) faqet. Dy *siratë* e epërme të DLSH-së i kishin zënë veprat (tregime, novela, romane, ese, biografi, drama, poezi, studime, përkthime, analiza etj. etj.) e shkrimtarit shumë të mirënjohur KB; *siraja* e tretë ishte e tëra për zonjushen P., e cila, që me librin e saj të parë, kishte zgjuar interesim të pazakontë ndër lexues e lexuese; *siraja* e fundit, domethënë e katërta, ishte pronë e dy (2) zonjave të nderuara, YZ dhe XHZH, të cilat shkruanin dhe botonin thjeshtë për inat të njëra -tjetrës.

“Ndoshta gabohe, por njëfarë zgjidhjeje mund të ketë”, belbëzova unë.

“Për shembull?”. Toni i librashitësit vazhdonte të ishte aspak miqësor. Unë bëra një hap prapa dhe fola me zë të dridhur:

“Ndoshta- ndoshta mund të ngjishet pak KB-ja. Dy *sira* vetëm për të janë pak si shumë... ndoshta... i moshuar është... klasik tashmë... vepër e mbyllur... të gjitha ribotime... edhe lexuesit... gjithë jetën... ndoshta vetëm një *sira* ... vend për të tjerët...”

“Kurrën e kurrës!”, sokëlliu librashitësi.” As mos e ço nëpër mend.

DLSH-ja nuk ka kuptim pa KB-në. KB-ja është nderi i DLSH-së. E kërkojnë dhe e blejnë lexuesit. Si bukën! *Sidomos ato të moshës 40-60 vjeç*. Kupton? Tjetër ide?”

“Hëm ...si të them...ndoshta mund të bashkoheshin ne një *sira* ...zonjusha P. me zonjat e nderuara YZ dhe XHZH... si të thuash ...grupim mbi baza seksi... fitojmë një *sira* të lirë...”

“Në asnjë mënyrë!”, ulëriu prapë librashitësi. “Nuk ka kurrfarë (kkk) sensi ajo që thua ti. Bile është paragjykim. Paragjykim i pastër ndaj letërsisë që bëjnë femrat. E *përlajné* lexuesit. *Sidomos ato të moshës 20-40 vjeç*. Si bukën!”

“E misërt?”. (“Pasiguria ime po anonte kërcënueshëm nga mllefi”. *Varg i Rich-it. Rd*).

“Nuk kuptoj...”

“Të grunjta ishin veprat e KB-së”.

“Po tallesh?”

“Aspak! Sepse ju po merrni rolin e pamerituar të një kritiku...”

“T`i kam dhjerë kritikët! Ku i ke?”

“...si dhe atë të një sociologu letërsie”.

“T`i kam dhjerë edhe ata! Ku janë?”

Nuk fola më. Shtrëngova trastën fort dhe bëra të dal. Librashitësi, i penduar si duket për fjalët e fundit (“Jetoj, sepse ende di të pendohem”. *Thënie e s`di kujt e mbetur në kujtesë.Rd.*), foli që përtej banakut:

“Ej ti, shkrimtar vendi! Je i mirëpritur nëse sjell përktihme. Edhe libra për kalamaj. Me ilustrime. E kupton vetë...nuk ecën letërsia shqipe...”

“Po sikur t`ia vëmë drynin? Ta mbyllim për disa vjet?”

“Kë? Librarinë?”

“Jo. Letërsinë Shqipe”.

Librashitësi filloi të shante prapë. Ndoshta mua. Ndoshta Letërsinë Shqipe. Por unë nuk ia vura veshin. Shtrëngova trastën edhe më fort dhe dola në Rrugë të Madhe.

3. Kamarierë dhe koncepte

Pas kërkimesh jo pak të mundimshme nëpër rrugët e zhurmshme të Metropolit, ia dola më në fund të gjej një lokal që nuk *frekuentohej* as prej shkrimtarëve e as prej artistëve. (Pyetjes “a është shkrimtari artist?”, e cila bëhet sa herë vihen pranë këto dy emërtesa, do t`i përgjigjem në ndonjë rast tjetër. *Shënim i imi. Rd.*). Zura njërën prej qosheve dhe u

lëshova në karrige. Trastën me libra e vura mes këmbëve. Hodha sytë përreth: në lokal nuk kishte asnjë klient tjetër. Isha vetëm. Krejt vetëm! (“I dorëzohem vetmisë më etshëm se puthjes”. *Varg i një poeti anglosakson, në përktimin e kolegit tim ON. Shënim i imi.Rd.*)

“Më se mund të kënaq zotërinë?”

“Kafe! Jap gjithë botën për një kafe”.

“Botën apo letërsinë?”

Vetëm atëherë ngrita kokën dhe i kushtova vëmendje kamarierit: ngjasonte çuditshëm me Umberto Eco-n, semiologun e shkrimtarin e *njohur* (ose shkrimtarin e semiologun e *njohur*): po ajo kokë e rrumbullt, po ajo mjekër e dendur gjithandej nëpër fytyrë, po ato sy të qeshur e të zgjuar, po...

“E di se ia ke këputur kokën një koke të madhe?”

“Unë atij apo ai mua?”. Kamarieri qeshi me zë të lartë dhe u nis drejt banakut. Unë e ndeza një cigaredhe u shtriqua këndshëm (shtrq). Ishin të gjitha gjasat (“ju nuk keni gjasa, sepse çuni është vetëm i imi”, këndonte nga ekрани përballë një bukuroshe *llërëgjiejgjitçkatjetërzbular*) që librari i pakmëparshëm të gremisej honeve të harresës. (Kujtesa është thjesht emocionale, thoshte një kolegu im, që kishte vdekur para 200 vjetësh). Kamarieri u kthye pas pak. Mbi tabakanë trekëndëshe, domethënë *postmoderne*, mbante dy filxhanë kafeje.

“A mund ta pi kafënë me ju, zoti Brida?”

“Si, ju më njihni?”. Toni im ishte më shumë se habitör.

“Njoh *disa* prej librave tuaj”. Kamarieri u ul përballë meje dhe ndezi një cigare. “Nuk ndiheni i lumtur që takoni një lexues tuajin?” (Ndihem i rilindur, sa herë që i takoj lexuesit e mi. *Deklaratë e një shkrimtari të njohur shqiptar. Moshë: rreth 60 vjeç*)

“Nuk besoj se është lumturi e madhe të kesh një lexues kamarier”, thashë unë kinse me shaka (kmk).

“Edhe kur ai *kamarier* është diplomuar për *Semiotikë Konstruktive dhe Poststrukturalizëm Dekonstruktivist?*” (Korsivet, në këtë rast, janë të folësit).

Edhe pse e dëgjoja për herë të parë një disiplinë të tillë letrare, e pashë kamarierin tim me respekt të fshehur. Mpreha sa munda mendjempreftësinë time (mmmm) dhe formulova këtë pyetje:

“Nuk ndiheni i penduar që keni harxhuar kohë me librat e mi?”

“Në fillim jo. Atëherë kur librat tuaj ishin taksur për lexuesin e nivelit të parë, atë *semantic*”

“Që do të thotë?” (Këtë pyetje e mora të gatshme nga media audio-vizive. *Shënimi i imi. Rd.*).

“Atëherë më interesonte thjesht çka thuhet”.

“Më pas u penduat?”

“Jo. As atëherë kur librat tuaj ishin taksur për lexuesin e nivelit të dytë, atë estetik”.

“Që do të thote?” (Shih sqarimin e pakmësisipërm. *Prapë shënim i imi. Rd.*).

“Atëherë më interesonte thjesht si thuhet”.

“Dhe në fund?”

“Po. Tashti që librat tuaj janë taksur për lexuesin e nivelit të tretë, atë *semantiko – estetik*”.

“Që do të...”

“Ju duhet të vdisni Divran Brida! Që të ringjallet lexuesi i vdekur”.

“Unë të vdes? Në djall lexuesi! Edhe nivelet e leximit!”

Kamarieri im qeshi me të madhe dhe iku duke më lënë prapë vetëm. Unë u ndjeva thjesht i lodhur. Mbi tryezë mbështeta bërrylet. Mbi ta kokën time.

Dhe...

4. Pantera dhe profka

...një panterë (çuditërisht në ngjyrë të verdhë), e rrethuar gjithandej nga lloj-lloj papastërtish e hedhurinash, rri e strukur në kafazin e cirkut. Asgjë nuk ka mbetur nga shkëlqimi, forca, bukuria, rinia, gjallëria e mrekullia e saj. Trupi i dobësuar e brinjët e dala, gëzofi i vyshkur e pa ndriçim, sytë e tharë e pa shkëlqim, gjoksi i shterur e i varur, gjymtyrët e mpakura e të lakuara jo vetëm që nuk joshin më, por i neveritin ata pak kureshtarë që provojnë të afrohen te hekurat. Dikur, dekada më parë, ishin të panumërt adhuruesit e panterës, të cilët zinin radhën para kafazit që në mëngjes herët dhe nuk largoheshin prej aty pa rënë mbrëmja.

Njëri prej drejtuesve të cirkut kërkoi të dinte nga kujdestarët se pse lihej i papërdorur ai kafaz aq i mirë. Rrëmuan me shkopinj nëpër kashtën e pistë brenda kafazit, derisa dalluan panterën e drobitur.

“Ende këtu, ti?” pyeti drejtuesi. “Kur dreqin ke ndërmend të shporresh?”. “Më falni të gjithë!”

Pëshpëriti pantera aq lehtë, sa u dëgjua vetëm prej drejtuesit që

kishte vënë veshin te hekurat. “Sigurisht”, tha drejtuesi dhe i ra ballit me gisht për t’u treguar kujdestarëve se në çfarë gjendjeje qe ajo kafshë, “të falim”. “Unë gjithmonë kam dashur që ju ta admironit mrekullinë time”, tha pantera e drobitur. “Ne e admirojmë atë”, tha drejtuesi me mirësi. “Por ju nuk duhej ta admironit atë”, tha pantera e drobitur. “Mirë pra, atëherë nuk e admirojmë”, tha drejtuesi. “Po pse nuk duhet ta admirojmë?”. “Sepse unë jam viktimë e këtij admirimi, nuk mund të rroj pa të, tha pantera e drobitur. Këto ishin fjalët e saja të fundit, ndërsa në sytë që shquheshin mbeti këmbëngulja e forte, por jo më krenare se ajo vazhdonte të ishte në qendër të vëmendjes.

“Mirë, pastrojeni!”, urdhëroi drejtuesi dhe kujdestarët e groposën panterën, kashtën. Hedhurinat e gjithçka tjetër. Në kafaz futën një Artist të Ri. Edhe më i pavëmendshmi e ndjente risinë e kësaj krijese të zbutur, që sillej krenar Brenda kafazit. Artisti ishte në formë. Ushqimet që pëlqente e kërkonte, kujdestarët ia sillnin menjëherë. Admirues të shumtë u mblodhën sakaq rrotull kafazit dhe...

“Ej, xhaxho!”. Hap sytë i trembur. Kam dremitur dhe kam parë në ëndërr TREGIMIN e Francit të gjorë. (Më i miri i të gjitha kohrave. *Thjeshtë konsideratë e imja. Rd*). Fundin e Tij. Veçse kokëposhtë. “Nuk je në hotel këtu. Paguaj dhe qërohu!”.

Mbi dy supet e mi rëndojnë rëndshëm dy gjëra të llahtarshme: të stërmëdha e të djersitura. Paguaj. Për vete. Edhe për kamarierin. Lexuesin tim. Ngrihem. Hedh mbi shpinë trastën. Me librat e mi. Dal jashtë.

Prapë në Rrugë të Madhe.

5. Media dhe modele

Idetë e mëdha gjithmonë më kanë lindur në Rrugë të Madhe. Kështu më ndodh edhe kësaj here: kujtohem për ftesën e njërit prej televizioneve të Metropolit, ftesë të cilën, deri më tash, e kam refuzuar paturpësisht. (Dhe kam kurajon të kërkoj mirëkuptim prej lexuesit tim... kur ai s`ma ka parë surratin qoftë edhe një herë të vetme...*Reflektim i imi. Rd*). Çapitëm drejt burimit të ftesës. Trasta rëndon rëndshëm mbi shpinën time. Diku pranë dalloj një kazan hedhurinash dhe sakaq në trurin tim feks një tjetër ide. Heq trastën nga shpina dhe tinzash, pa u vënë re nga ndokush, e le *aty*. Në kthim, pa asnjë dyshim (*rastësor ky rimim*. Shënimi im), trastën me librat e mi do ta gjej prapë *aty*.

Në televizionin “Kozmos” më pritën si Djalën Plangprishës: me qortim (kush je ti që refuzon ftesat tona, të tjerët na lutën etj.) dhe me dashuri (dyshimi im: i kanë mbaruar të gjithë shkrimtarët metropolitanë). Më sajdisin me një kafe dhe më sqarojnë se *intervistat nuk paguhen*. Nuk them gjë. Më pas më urdhërojnë të futem në studio. Hyj aty dhe pres gjatë. Derisa vjen gazetarja. E shoh dhe shtangem (shshsht): është një biondinë e hatashme- vjelë, me siguri nga konkurset mbarëkombëtare të miss-eve; gjoksi i saj i mrekullueshëm, thuajse i zbuluar, e detyron të hepohet pasksa drejt meje. Unë djersij e çoroditëm me gjithsejt. Gjithçka që kisha menduar t’u them lexuesve të mi të dashur, bëhet lëmsh e pështjellohet në trurin tim. Roland Barti ka mjekrën e Umberto Ekos dhe ngre tezën e vdekjes së lexuesit. Tomas Pinçoni i lutet një gazetarjeje (biondinë) për intervistë, kurse Norman Mejler bën të kundërtën, i ikën asaj. Dekonstruktivisti Derrida ngacmon me fjalë e duar Kristevën, e cila kinse shpërfillëse, këmbëngul rreth pavarësisë së tekstit. Borhesi përsërit se gjithë jetën ka lexuar vetëm një libër, ndërsa Kadareja përbetohet rreth shenjtërisë së tekstit letrar. Tahar Ben Zhellun... Kurse Danillo Kish...

“Gati! Fillojmë”, bërtet regjizorja (biondinë). Bëhu burrë, d.m.th. shkrimtar, i them vetes. Përqëndrohem sa mundem dhe rrekem t’i mbledh disi thneglat e mendimeve. Gazetarja flet plot epsh dhe siguri. Gjëra të përgjithshme thotë, ato që thuhën në çdo fillim. Unë guxoj dhe ia hedh sytë prapë: dritat e ndriçuesve kryqëzohen e sajajnë lodra të mrekullueshme mbi gjoksin e saj të zbuluar. Çoroditëm përsëri. E humbas edhe atë pak siguri që sapo kisha fituar. Gazetarja kthehet e tëra nga unë dhe çel bisedën:

“Do të ishte me shumë interes për teleshikuesit tanë e që janë njëkohësisht edhe lexuesit tuaj, të dinin sa të dashura ka, aktualisht, zoti Brida?”

“Asnjë!” përgjigjem unë thuajse *mekanikisht e triumfalisht*. Tashti është radha e gazetares të çoroditet: as që e ka imagjinuar përgjigjen time. E shoh se si bën lëvizje të pakontrolluara (më ndërmend Panterën e KAFKËS në kafaz) dhe trazon letrat para vetës. Pyetjet e saja ngatërrohen. Po kështu edhe përgjigjet e mia. Mes nesh nuk ka kurrfarë mirëkuptimi (nknknk), thua se u përkasim dy planeteve të ndryshëm. Kështu deri në fund, d.m.th. derisa plotësohet minutazhi i caktuar. E zhgul mikro-mikrofonin (thua se heq një akrep të zi) nga jaka e xhaketës sime *postmoderne* dhe marr frymë i lehtësuar. Regjizorja afrohet dhe

më sheh thuajse me neveri.

“E ke dhjerë”, më thotë. Mua më ndërmendet librashitësi. Edhe pantera. Edhe ata pak lexues që duhet t’i kem zhgënjyer përfundimisht.

Dal jashtë.

Prapë në Rrugë të Madhe.

6. Epilogu

Kam marrë Rrugën i Kthimit. Druhem të pohoj. (pohime të tilla nuk janë në nderin e shkrimtarit *bashkëkohor*), porse një vel i hollë *malli* më ka mbështjellë të tërin. Mall për Shkodrën time dhe *provincializmin* e saj. Ose për diçka tjetër. Mall të cilin, për turpin tonë!, kemi turp t’ia pohojmë vetes. Sidomos të *tjerëve*. Mall për të thjeshtën. Të vërtetën. Të pabujën. Thelbin. Që, ndoshta, ruhet ndokund i pacënuar. (“Më lini në strehëzën time të qetë/të qesh me botën budallaqë”. *Varg i një poeti frankofon, në përkthimin e kolegut tim N.O. Shënim imi. R.d.*). Diku nga fundi i Rrugës, tamam aty ku “zhduket Buena nen një kodër, zhduket Drini nen një mal”, kujtohem për trastën me librat e mi: i kam harruar në Metropol, te kazani i hedhurinave. Trishtohem. Por vetëm për pak çaste. Sepse (ashtu si përherë) e ngushëlloj veten: ndoshta, falë një rastësie fatlume, atë trastë e gjen ndonjeri prej lexuesve të mi.

Ndjehem i drobitur.

Mbyll sytë e dremis.

Maj, 2004

EDICIONI II, VITI 2009

Skënder **DRINI**
(1935-2014)



“ Përballje”

A mos është paradoks të mendosh që shkrimtarët shkruajnë për të jetuar një botë që e krijojnë vetë?
Atë që citon gjithnjë të tjerët, të tjerët nuk e citojnë asnjëherë.
Afinitetet seksuale janë afinitete selektive.
Ai që vdes i ri, humbet pleqërinë.
Ajo që ti do është refleksi yt.
Altruisti është një person i shumëzuar për gjashtë miliard njerëz.
Amerika është punë edhe gjumë, pastaj është prap punë dhe prap gjumë.
Amerikës i mungon finesa, sepse i ka munguar aristokracia.
Apatikët nuk e vrasin mendjen dhe e lënë horizontalisht vezën e Kolombit.
Argumentimi i ringjalljes mund të mos arrihet ndryshe, veçse si një

deformim i idesë së ripërtëritjes së species.

Arti është dhimbje dhe kryengritje.

Arti është e vetmja forcë që mund të konkurojë natyrën.

Arratisja nga koha të kthen prap në pikën e nisjes.

Arroganca të vret më keq se plumbi, por kundër saj nuk ka asnjë ligj.

Asnjë nuk është e përjetshme, as vetë përjetësia.

Asnjë fis nuk është edhe aq i lashtë në këtë tokë, sa të guxojë të zgjedhë baobabin për pemë gjenealogjike.

Askush nuk mund të flasi për lirinë, sepse askush nuk e ka provuar lirinë.

Asnjëri nuk mund ta fshehi karakterin e tij deri në atë masë sa të bëhet i padukshëm.

Asnjëherë nuk ka ndodhur që injorantët të sëmuren nga mungesa e kulturës.

Ashpërsia tek një kategori njerëzish, është një paravento që fsheh komplekset.

Ata që besojnë se mund të shmanget lufta, ndofta besojnë në vdekjen pa dhimbje.

Ata që jetojnë shumë në të kaluarën, jetojnë pak me të sotmen.

Ata që mohojnë të kaluarën do t'i mohojë e ardhmja.

Ateistët duhet të jenë detyrimisht njerëz të mirë, sepse nuk kanë ku kërkojnë falje.

Ata që shfajsojnë të tjerët, në shumicën e rasteve janë njerëz që e njohin shumë mirë vetveten

Ata që urrejnë gjithkënd, nuk kanë kohë të duan as vetveten.

Ata që vdesin të rinj, duhet ta quajnë veten me fat, sepse u zgjatet jeta e përtejme.

Gëzimi i madh i njeriut rrjedh nga e panjohura.

Gënjeshtra përgjithësisht ka një karakter optimist.

Grataçielet të mësojnë se si diçka krejt e nevojshme mund të kthehet në krenari.

Gruaja është trajnuar në një formë iluzioni për të qënë shumë e kërkuar.

Gruja mund të vijë prap në një pozitë sunduese dhe kjo do të ndodhi, kur të komandojë siç duhet seksin dhe feminilitetin e vet.

Grave të zgjuara u rrinë keq kostumet.

Gjaku blu nuk është likuid kozmik.

Gjaknxehtëti kanë dhënë botës shpirt, por nuk i kanë dhënë arsye.

Gjeniu është një hibrid i seleksionuar.

Gjeniu është një krijesë e përjashtuar.

Gjeniu jeton dy kohë, kohën e vet dhe kohën që nuk e kuptojnë dot të tjerët.

Gjeniu nuk është ai që rri mbi të tjerët, po janë të tjerët ata që rrinë nën të.

Gjersa njeriu guxon të fantazojë me anë të mendimit për gjërat më të pabesueshme, kjo është garanci që realizimi i tyre është vetëm çështje kohe.

Gjermanët përdorën dhunën, nga që nazizmi nuk mund të përparonte me arsye.

Gjithë energjinë e saj, natyra e harxhon për seleksionuar njeriun deri te gjeniu, ndërsa njerëzimi gjithë energjinë e tij e harxhon për t'u ngritur deri te njeriu.

Gjithçka që ekziston është e nevojshme, edhe dashuria, edhe urrejtja, edhe buka, edhe helmi.

Gjysëm modern i është sinonim i provincialit.

Gjyshi është garanci më e madhe se babai për origjinën e njeriut.

Qeni e ruan shtëpinë, por nuk është padroni i saj.

Që në sekondën e parë që mat kohën, mat plakjen.

Që të jesh me të vërtetë i lirë, duhet patjetër të jesh pak i çmendur.

Qirinjtë që ndizen për të vdekurit, paralajmërojnë të gjallët.

Qytetërimi poshtërsinë e ushtron me politesë.

Primo SHLLAKU**Vdekja si dashnore**

Shpendë të turrshëm
rrugën ma presin
e me krahët si thika,
ballin ma përgjakin.
Turre të thekshme
trupin ma rrëmbejnë
e, në atë theqafje,
ballin ma djegin.
Nji plumb i ftofun
ballin ma rrmon
e, si brumbull i trembun,
gjen rrugë e mshefet.

28.03.04

Pa titull

Jo, jo
na nuk jemi
dashunia e prindëve tanë
gjatë luftës.
Na jemi fryt i nji paqe dinake
ku brini i errët i dhisë
ishte edhe majë,
edhe thikë.
Mos vdis edhe pak.
Jeta është për ty po aq
e vlefshme sa kapërcimi.
Tashti e ke rastin.
Ville o pshtyje shpirtin,
ta lexoj.
Mos ik i padeshifruem
se unë do të kujtoj
se prap po del fjala fjala ime.

Pefki, 18.03.2006

Fleta e bardhë

Do të jetë bora
që ka me ra
e vetulla e hollë e mbramjes gurrkali
o deti i frymë si hipogastër gulshues,
apo fleta e bardhë do të jetë,
e sigurtë fleta e bardhë.
Ajo mund të jetë
gjithçka që unë mund të jem,
aspak çka duhet,

por çka s'e di se jam
e vesht do ta marr
kur ajo s'do t'jetë e bardhë.
Takim i vështirë me fletën e bardhë
prej majës së këtij hark ure
që më lëshon pingul në ujnate e cekta,
e bardha, e forta
të fletës ,të fletës së bardhë,
sigurisht të bardhë, sigurisht
të fletës,
sigurisht i dërrmuem eshtnash,
i thyem pa gjak,
sigurisht me gjakderdhje të bardhë
mbi fletën sigurisht eshtën-dërrmuese
ku unë një ditë mund t'shfaqem
para vetes së njoftun si një i panjoftun,
me 'i hap të lëshuem përpara
me 'i dritë të naltë verbuese
mbi vorrezën që përmbaj
tash ka mot
vajtueshëm ditën e klimaksit
kur mitrat mund të
valviten si balona të ngecuna ndër tela.
As mbramja gurrkali
as gastarja e hollë e qiellit mbi liqen
as ernat e dritës drejt boshtit të syve të mi
s'ma japin sigurinë e rrëzimit prej harkut të urës
drejt ujit të bardhë të fletës së sigurt
që më përpin si qumësht i bardhë skëterre.

Era e luginës (elegji për tim atë)

Kur ishe ti,
era e luginës
nuk mbërrinte deri te unë,
e kisha shqytin.
Silueta jote po valvitet
si pëlhurë e kalbun
e sendet po t'u shifkan
tejpërtej trupit.
Në këtë çast të rrallë
që lëkura më pushon
e qepalla ime i ndan hemisferat
në me diell e në me hanë
s'më del kohë me mendue,
se tash e kam unë radhën...

S'ka ma hyj

S'ka ma hyj
që këputen netve të gushtit
e bien
mbi pllambën e pritjes.
Mes nesh ka vetëm shi,
shi kambëngulës,
që shtrin horizontin.
Edhe kur të vijë moti e mirë,
edhe kur të dalë vera,
dielli do të jetë i ftoftë
e drita e tij e lagët.
Mund të jenë veç do lule të vogla,
çilun para kohe,

aq para kohe,
sa s'mundën me pasë aromë.
Ky shi e për lau të tashmen
dhe unë vetëm të kam dashtë...
Me dashtë nëpër shi
asht e pamundun...
Me jetue nëpër shi
domethanë mos me të takue
kurr në të tashmen.
Ke ikë nëpër shi
dhe shi do të jesh ba...

Errësina ishe ti

Fola me ty
Fola me errësinën.
Errësina ishe ti.
Errësina ishe ti.
Mes meje e teje pikla drite.
Nata e ka ftyrën pikaloshe.
Nata vrapon drejt agimit
Unë po të humbas
Unë po të humbas.
Sepse
errësina ishe ti.

Ledri **KURTI**



Sallatë “mix”

Përse ne dhe ju jemi gatuar kështu?
Me vaj, kripë e uthull.
Secili me njëren prej tyre të tepërt,
të neveritshëm, të pakapërdishëm
ose të thartë, me njëri-tjetrin rrimë,
pjmë dhe kafe hidhur
ose të sheqerosur pa masë.

Jemi shokë, miq, sipas rastit, kolegë gjoja,
të gjithë kërmij, guackë përballë, jargë pas.
Kotësia na ul bashkë.
Kotësia na uli në gjunjë dje.
Kotësinë presim, të na ngrejë sot.
Përse ne dhe ju, jemi gatuar kështu??...

17 shkurt 2000

Kujtohu!

Një gjarpën stërmadh
n'gabzherr ia nguli njeriut
shijen i idhtë.
E njeriu tue mos muejtë
me qenë kësi lloj gjarpnit
por krijesë disi ma pak e përçudshme,
si zog gjarpnit përhidhet,
n'fyt të atij, që s'din,
çka ka përballë vedit,
e as merr vesh ma pas
se në ç'ka , ai vetë asht shndrrue,
e prej nga, i vjen kjo domosdoshmëni,
prej instikti
me i idhnue tjerët, që s'janë
e s'i gjen si vedin.
O Zot! Der kur do flasim si gjarpnij?
Der kur do flejmë si gjarpnij me çu krye?
Zot! Merr një gur që s'asht në tokë e na gjuej!
Një gur ku nuk mshehen gjarpnij
As fërkue për te, t'mos jetë.
Një gur prej tejet, O Zot!

30 qershor 2000

Arben **PRENDI**

ÇORODIA



-Rrëfim-

Lajmi i fundit që pruni tellalli i kishte bâ me zemër të gjithë banorët. Gjindja shikonin nga qielli, banin kryq e thoshin:

“Peh, rrejna zot, kjo nuk ka si të jetë e vërtetë”.

Mbreti pushtues, kishte nxjerrë dekretin e ri, mbi kufizimin e dritës dhe ngrohjes diellore, për banorët rebelë të krahinës së Kryekcyemit. Kjo nuk ishte pa ndonjiherë.

“Drita e diellit a mund t’i ndalej kujt?!”

Dekreti kishte edhe një shtesë tjetër që bante fjalë për kufizimin e ndriçimit me qirij, llamba me voj guri dhe ngrohje gjatë gjithë periudhës së dimnit që ashtu do të dukej dhe do të ishte në fakt, pa fund, sikur nuk do të kishte kurrë fund, një dimën i përjetshëm, tanësisht i akullt. Një dimën si vdekja e pafundme. Një dimën që vdekjen mund ta bante ma të lehtë se jetën.

“Rrejna Zot!”, bajshin banorët e Kryekcyemit, “kjo nuk është pa e

nuk është ndigjue ndonjiherë”.

Bahej fjalë për kufizime të përçudshme, të cilat mbreti pushtues, që qoftë mallkue në jetë të jetëve, me të parë e me të mbramë, kishte vendosë t’i zbatonte me hekur e me zjarm në krahinë. Kryekcyemi që e vetmja krahinë në të cilën kishin dhanë jetën lulja e ushtrisë në tentativën me e marrë qytetin e mandej gjithë krahinën. Edhe kësaj dite krahina qelbesh nga kërmat e ushtarëve të huej, pushtues. Muranat e tyne nxinin majë çdo suke. Por mbasi pushtimi ishte krye, tmerri për banuesit nuk do të kishte fund kurrë. Këtë ata e dinin mirë, e kishin ditë edhe para se të pushtoheshin, prandaj kishin luftue me tërbim të pashoq, si ai që nuk ka rrugë tjetër veç të vdesë sa ma shpejt për mos me pa tmerre pa fund me sy.

“O të lumët ata që prehen në vorreza, të lumet ato nana që nuk i kanë fëmijët e tyne dhe nuk i shohin në to tmerret që i shohin në vete”, mjeroheshin gratë vetmeveti, kur herë mbas here tellallët e mbretit të huej çirreshin ndër sheshe e ndër qoshe rrugash, si dreqën, të ngacmuem prej kushedi se çfarë gjaje.

Dekreti ishte tmerrësisht i qartë, lejohej përdorimi i mjeteve ndriçuese e ngrohëse vetëm dy orë paradite, dy pasdite, vetëm një orë në darkë. Në këtë masë kohe përfshihej edhe drita e diellit.

“Kjo asht e padurueshme!”, fjaloseshin banorët e krahinës dhe të qytetit.

“Kjo asht një çmenduni. Ai mbreti i huej, që qoftë mallkue për jetë të jetëve, me të parë e me të mbramë, don me e bâ krahinën tonë një çmendinë, e na me u çmendë pak nga pak, fmitë tonë me lindë ngalakeqa, të falisun, coftina që u merren kambët e as shpatën s’kanë me mujtë me e mbajtë, kur t’u mbijnë mustaku nën hundë, në qoftë se ka me u mbi, kështu si po shkojnë punët tona. Ai, Urovi don me e ba këtë popull mozotmakeq, me e nenshtrve deri ku nuk ban ma mendja e njeriut. Kështu kishte ba ai dhe të parët e tij, por ky ua kalonte të gjithëve për nga mnere e çorodia që po sillte në këtë ripushtim”. Thonë se kishte thanë se mbas këtij pushtimi nuk kishte me pasë ma pushtime të tjera të kësaj toke, jo pse i dhimbsej ajo, por se nuk do të kishte ma nevojë, se ai donte të zhdukte çdo gjurmë të qytetnimit vendas tue e rrënue gjithçkafen.

Një djep të madh ia kishte nisë puntoria e krajlit me e ba si në gjasim të monumentit, në qendër të krahinës e shumëkush thoshte se ai nuk ishte djep, por ishte një vorr i madh i cili nuk dihej se kënd do hante në

rrjedhë të shekujve. Punohej me shpejtësi me e lartue këtë djep që dukej si vorr, punohej ditë e natë, pa pushim. Dikush thoshte se ky monument do t'i shërbente historisë së ardhshme kur shumë të dhana e gojëdhana do të zhdukeshin e kur e vetmja dëshmi do të ishte ai djep, e në atë djep do të përkundeshin raca e mbretit të huej. Po ai djep mund të ishte edhe një vorr, shtonte dikush tjetër si nëpër dhambë, ai vorr u baftë. Ndokush tjetër thonte si me frikë, se, në atë djep do të përkundej mbreti i huej me gratë e tij derisa ato të ishin shtatëzana e të pillnin shumë fëmijë e këta fëmijë mandej do të përkundeshin brez pas brezi në këtë djep... “Dalshin fare, dalshin!”, e mbyllte hamendësimin e tij, ky tjetri.

Kishte ra mbamja e vendi qe terratisë krejt, kur në krahinë u shpërnda lajmi që pruni tellalli.

“Medet”, thoshin tanë banorët e Kryekcyemit, “si ka me qenë dita e nesërme pa diell, me diell të kufizuem. A thue ky asht fundi i botës sonë të dashtun?! Si ka me qenë ndryshe fundi i botës përveçse kështu?!”

E kishte thanë tellalli:

“Zbatimi i dekretit ishte i detyrueshëm, ma qartë, moszbatimi dënohej me vdekje, siç e përshkroi ai, lidhun mes dy kuajve, kambësh e duersh. Rebeli do çahet pastaj me një shpatë përmes rropullive dhe trupi i tij do t'u hidhet qenve”. Edhe këtë dënim mbreti i huej, e kishte prue me vete, siç bjen nallbani veglat e veta të punës. Nuk ishte pa ndër ato anë ky farësoj dënimi e njerëzit ishin mnerue. Mbreti qe betue, simbas tellallit, se kjo mënyrë do të zbatohej pikë për pikë, publikisht, që krejt kryekcyemit ta marrin vesh se çka i gjente në rasë se dekreti do të kundërshtohet, a prite Zot! do të shtrembnohet prej ndonji guximtari a budalli të pashtuem.

II

Dita e parë pa diell, ose ma mirë me thanë me diell të kufizuem në Krahinë, ishte edhe ma e zezë, edhe ma e mnertë se pritej prej atyne rrezikzezve që kishin ushqye një soj shprese se një ditë e tillë do të ishte njëfarësoj e durueshme si shumë vujtje të tjera me të cilat i kishte përplasë sa e sa herë shorti i keq e kishin mbijetue papëseparapë.

“Kena me u msue edhe me këtë rregull”, kishin thanë, disa prej atyne shpresëshuemve. “Na jena msue me gjithfarë marrinash e provash të randa, tash po msohana edhe me këtë provë që me gjasë vetë Zoti o dreqi i kuq, e ka nisë me na vete në provë karakterin tonë, duresën tonë karshi

vuejtjeve të pasosuna në jetën e robve të mjerë”.

“Me ba durim, vllazën të dashtun, qoftë edhe për mos me u dhanë para mbretit pushtues dhe veglave të tij të përçudshme”.

“Kryekcyemsit, kanë jetue e do të jetojnë në jetë të jetëve e nuk ka fuqi, veç të madhit Zot që t’i përbijnë prej faqes së dheut”, kishte thanë dikur, mbas kësaj tollovie Uk Kështeja, i ndigjuem fort për urti e trimni në tanë krahinën e vet edhe në krahinat rrotull.

“Qe besa”, kishte thanë ai Uk Kështeja, i pezmuem në ftyrë, “diellin kurrkush nuk mundet me na e ndalë, veç lojë të randë i ka qitë vetit njaj mbreti i huej, si po ia thonë emnin e tij nuk e di, që i humbtë emni për jetë e mot, me të parë e me të mbramë”.

Tanë natën e lume e deri në t’xhixhilluem të dritës së diellit, lulja e ushtrisë së zezë të mbretit pushtues, kishin punue pa prâ një herë derisa krejt krahina qe sterrue, prej një pelerine të zezë, stërmadhe, që nuk e rrokë as mendja e ma të krisunit për fantazina në mjeshtri të së keqes.

“As ndër kallximet e të moçmve tonë, nuk më bahet të kem ndie për një rod ksisoj mushamaje, që të mundet me zhytë Krahinën në këtë farë terratije”, tha plaku ma i moshuem i krahinës Gjon Përralla, i përmendun për kujtesën e pamort dhe fantazinë e shprishun, nëpër kallximet e gojdhana e prallave të vjetra që shetisnin në krahinë prej çse mbahej mend jeta e kensave këso ane. Ai kishte rrfye shumë gojëdhana për katallâj e bajloza, për kreshnikë e trima që një pendë qe e peshonin me një krah, por kurrë nuk kishte ndie për një gja si kjo që po ndodhte e ia kalonte edhe përrallës.

“Kjo gjâ, as pa e as ndigjue, monstër asht, monstër shkue monstrës, krahasue me legjendat për bajloza e lubi të zeza, që tregojshin të Parët”.

Edhe plaka Sose Sosja, siç thirresh në Krahinë, (për shkak se ishte aq e moshueme sa edhe mbiemni i vertetë i qe harrue, të bekuemes) kishte thanë se, kësi mordeje nuk ishte shfaqun ndonjiherë, kurrë ma parë.

“E pava edhe këtë morde”, kishte thanë.

“Nuk di a asht ma e zezë, para ksaj, mordja e bardhë, e bekueme: deka. Kisha me thanë se ky asht fundi i Krahinës”, ofshau me atë rast Sose Sosja e qysh prej asaj dite e qysh në ditën e parë të atyne ditëve të përçudshme, e mbështolli një lingatë e keqe, pse në atë fillim dite ia nisi një logorie të dhimbshme që ta këpuste shpirtin, bash në atë moment që dita leu e lyeme me katran, ose ma mirë me thanë s’leu hiç. Qysh prej asaj dite të lyeme me katran, Sose Sosja (që mbiemni i qe harrue, aq në moshë ishte) nisi me iu lutë Dekës e Mordes, me e marrë sa ma shpejt,

rradhën ma të parë që të kalonte andej pari me karvanin e saj laraman, tue bajtë shpirtent mkatnorë me përdhuní.

III

Ditët e lyeme me katran, ose ma mirë me thanë ditët me fytyra të mekëta nate, u shtuen, si krymat në mishin e qelbun të coftinës. Vetëm dy orët e para dhe dy orët e fundit, të asaj çka kishte mbetun nga dita, sa për ta ba edhe ma të zezë terrinën që pllakoste mandej, pelerina e trashë e territ mblidhej me ca rrotëza metalike dhe krahina mblidhej kutullaç si gjarpni, pa e ditë çka të bâjë, t'i gëzohet orës fatbardhë të dritës së diellit të lumë, të ndaluem, apo të meditojë ashtu e shitueme mbi fatin e saj të zi, mbi orën e namun kur në Krahinë ia mësyni pushtuesi, orën e namun kur në krahinë ia mësyni tellalli me shakujt e pluhnosun mbas krahut dhe me lajmin e kobshëm, të sosjes së dritës, që aty e përtej do të racionohej simbas urdhnave e dekreteve të mbretit armik.

Krahina kishte marrë hijen e flashkët të vdekjes. Në njenën prej këtyne orëve të ndritueme me një dritë të marrtë, të thithun prej kushedi çfarë force, plakës Sose Sosja, që nuk kishte pushue për asnjë dekik lutjet e veta drejtue mordes, i kishte ndodhë ajo që nuk i shkonte ndërmend askujt, por që nuk habiti askënd, nën atë mushama të zezë, (mund të thuhej askënd nën atë qiell). Në shtëpinë e braktisun të plakës u dëgjuen virrmat e mprehta të një foshnjeje, virrma të ngjashme me ato të maceve, në fruer.

“Ruejna Zot!” Plakës i kishte le o shfaqë në shtrat një kens, me fytyrë pis të zezë, sterrë të zezë, që edhe ishte foshnje edhe nuk ishte. Fytyrën e kishte të zezë bash si ajo mushamaja, që mbulonte qiellin e bukur të Krahinës, tue mos lanë asnjë rreze drite me depërtue jashtë orarit të caktuem me dekret.

Vetë Uk Kshteja, që nuk u kishte besue kurrë marrinave të shpërndame nëpër millet, atë orë të hershme u nis e doli rrapitoll për dere tue u mbajtë për muresh si qorr, ia mbajti drejt e te rrënoja ku rrnote plaka që edhe koha e kishte harrue moshën e saj. Bé e rrufé, lëshonte plaka, se atë farë kopili që s'merrej vesh se çfarë ishte, ia kishin lanë në derë natën, se nata ishte e gjatë fort, gabelicat që i kishin zanë me ushtarët e kralit të zi. Ndoshta ishte dhe kështu, po ec e mbushja menden gjindes së tronditun prej lajmit që mori dhenë, se Sose Sosja kishte lindë, diçka, që edhe ishte fmijë edhe jo, një dreq, ma mirë me thanë, he qoftëlarg

nesh...

“Me taman që fmija ishte lara-lara. Ma fort i zi, se lara-lara, si mushamaja që na ka zaptue prej s’mbahet mend, por dikund-dikund, ishte edhe i kaltër si qielli i çmendun kur asht i mbushun me dritë”, tha Uk Kshteja, mbasi e kishte mbajtë frymën te Gjon Prralla, i tronditun për çka kishte pa.

“Ka zi e ma zi”, u përgjigj tjetri si të vazhdonte një muhabet të lanë përgjysë, megjithëse prej ditësh nuk ishin pa me sy, për shkak të murtajës që kishte pllakosë.

“Druej se nuk kena me u nda me kaq pak gjâ”, shtoi pas pak.

“Druej se fmija jonë dhe e fmive të fmive tonë, tash e mbrapa kanë me le ashtu, me njasi larash të mnershme në trup, po edhe në tru, se ti i di si janë punët e trunit, ai pak don me marrë krisë e hajde e jepi maje... Tash po e marr vesh lojën e krajlit, ai hallin ma shumë te truni e ka, ai ia prishë planet, don me na prishë trush, mendsh. Punët e njeriut fillojnë në tru, punët e tjera që s’kanë lidhje me tru i ban edhe shtëza. Po druej se ma shumë ai e ka hallin te fmijtë e fmijve tonë të cilët rrezikojnë të mos jenë kurrë si të tjerët që nuk janë në këtë lingatë që na ka ra ne, e nuk dihet se kur ka me marrë fund nëqoftëse ka me marrë fund ndonjiherë. Një tru i lindun e i rritun në terr pa e pá dritën e diellit ose tue e pá rrallë atë, merret me mend se çfarë përparimi ka me i dhanë jetës. Munden me kalue pesëqind e kusur vjet e mos me u davaritë larat e robnimit të trunit. Edhe mbasi, dashtë Zoti, një ditë mund të shporret i hueji, ai në fakt ka me mbetë i ngulun në tru të gjindjes tonë, çka ka me kenë fundi jonë. Fmija jonë dhe fmija i fmive tonë ka me kenë armiku i vetes dhe armiku jonë”.

“Ka zi e ma zi”, përforcoi atë çka tha në fillim Gjon Prralla, kur dera kërciti përvajshëm, si të ishte çelë një derë e pahapun prej kohësh, si të ishte çelë dera e ferrit. Të dy u ngjethën prej vajit dhe ftohmes cingruese që erdhi prej derës së sapohapun. Qyshse u shpall ai i namun dekret, një ftohme tharëse e kishte pushtue krahinën, ftohme e papame, flijuese.

Dy gra u dhanë në derë bashkë me ftohmen shkretuese dhe vajtimin e derës që s’ishte vetëm i derës por edhe i një foshnjeje të përjargun në gjak dhe në pështymë të neveritshme.

“Pash Zotin more të urtë”, lëshuan vikamën gratë, “na shpjegoni çka po ndodhë me ne?! Dreqi po ban lojë me ne, ksi kopilash lara-lara po léjnë nuset tona... Kqyrni çka po ndodhë ndër ne, e kjo asht punë e dreqit, se e Zotit jo se jo!”

Burrat banë kryq. Gjon Prralla tha prapë:
 “Ka zi e ma zi!”

IV

Çorodia e pushtoi krahinën mbas disa kohësh, qysh se tellalli shpalli dekretin e zi mbi kufizimin e dritës diellore dhe të çdo lloj drite tjetër që binte në kundërshtim me nenet e dekretit që kishte vendosun mbreti pushtues. Gjindja erdhën e u plogështuen krejt, sa përtojshin me bâ edhe një bisedë të zakonshme, mezi pritnin të vinte orari i shplimit të qiellës, bile edhe kuptimi i vetëm i jetës dukej se ishte përmbledhë pikërisht aty në atë pritje: sa me pà një grimë qiell të zhveshun, për t’u zhytë pastaj në një terrinë shumë herë ma të madhe për shkak të efektit shastisës të dehjes dhe lirisë që vinte nga ajo copë qielli. Madje edhe kjo ishte e rrezikshme, prandaj qarkullonin fjalë se mund të bahej një reduktim tjetër në orar, sepse prapë ndonjë kryekcyem i frymëzuem me sa duket nga ajo copë qielli, kishte thanë plot pezëm tash së fundmi:

“O kjo jeta jonë asht ba një natë e gjatë, e pafund, e padurueshme, nën këtë morde që ua kalon të gjitha mordeve të kësaj dhe asaj bote, e ma e mira e të mirave asht me vdekë, nën qiellin e për qiellin tonë të bukur, që mungon...”.

Por nuk kishin mungue zanet se sipër te Shpella e Ujit të Mirë, Marije Fatlumes nësa ishte ngjitë deri atje me mbushë bucelat me ujë të mirë, vjedhazi hafijeve e rojeve të krajlit, i ishte shfaqë Shën Mria dhe nëpër mjegullën e territ që i ishte dvaritë në çast e vendin e kishte mblue drita, tue thanë se Zoti kishte pà gjithçka e nuk do të vononte drejtësia hyjnore... Një ditë, tanë kjo do ishte vetëm një kujtim i shplamë... e kishte fluturue kah thellëtinat qiellore.

E kishin mundue kaq shumë rojet e krajlit Marijen për me tregue se kush kishte qenë ajo grue që kishte thye rregullat e krajlit e grueja e shkretë nuk dinte se çka me thanë pse askush nuk donte ta besonte se Zoja e Lume kishte ba një vizitë aq fantastike tue u dhanë shpresë mijëra shpirtënve të rraskapitun prej robnimit dhe poshtnimit...

...Mbasi kishte marrë vesh lajmin, një prift kishte ardhë natën, s’dihet se prej kah, me një pajton të vogël dhe kishte shkarkue plaçkat te katedralja e heshtun e qytetit. Kjo ndodhi fill mbas dukës së Zojës së Lume edhe persekucionit të bamë publikisht Marije Fatlumes, e cila gjithmonë kishte pasë vizione të çuditshme që gjithmonë ta çuditnin

mendjen e kresë. Disa thonin se prifti kishte ardhë me urdhën të posaçem prej Selisë Shëjte dhe se lajmi i dukës së Zojës së Lume kishte marrë dhenë. Nuk dihej a ishte i huej a i vendit. Ndoshta kjo ishte gjaja ma e natyrshme me ndodhë mbas vrasjes mizore të dom Pjetrit drejt e në meshë kur ai po lutej për fitoren e bashkëatdhetarëve të tij. Sënduqet me shkresa e me libra u dogjën dhe trupi i dom Pjetrit tri ditë e tri net u la sipër dheut ta hanë qentë, i ruejtun nga një togë ushtarësh derisa komandanti i tyne nuk duroi dot ma dhe u zhgreh në vaj para asaj që kishte mbetë nga kufoma dhe urdhëroi varrosjen e të mbetunave në një vend sekret. Edhe mbreti ishte ba kureshtar dhe kishte urdhëruë priftin e tij të çonte një meshë sipas ritit të tij, te shpella e Ujit të Mirë. Flitej se prifti i mbretit kishte kërkue që prifti i sapombërritun të mos lejohej të meshonte në katedrale, sepse ajo do të përshtatej sipas modelit të kishës së mbretit, dhe se ajo kishë ishte e përdhosun.

Nuk dihej a ishte murtajë apo çka ishte lingata e re që po pllakoste, por vdekja po ia mbrrinte gjithandej në krahinë. Vdiq edhe rapsodi Gjon Prralla, thuhej se vdiq ngase iu ndalua të këndoje e të kallxojë.

“Jo, ai i shkreti s’paska pasë faj! Nuk i ndalet kanga lahutarit e kallximi pralltarit, se ai vdes. Si do të jetojmë na pa kangën tonë?!”

Kjo s’ishte pa as ndëgjue ndojherë! Dikush tha se edhe atë e kishin vra e mandej kishin hapë fjalën. Vetë mjeku i mbretit e kishte ba vizitën që vërtetonte vdekjen e rapsodit e bashkë me të...

“Çka do të bajmë na pa fratin tonë, pa rapsodin tonë, pa dritën e diellit?!”

EDICIONI III, VITI 2010

Ledia DUSHI

**“Me mujt me fjet”**

Syçilë m'shtihet Vdekja kur Frymë nuk ndeshi
uj' e heshtje mbledhi n'fashën e kësaj dite
me diellin plasun n' vorre e tinguj ndër lutje
tue pritë me nxjerrë toke ndoj pemë a ndoj njeri...
ku me e marrë kohën që n'ty me u ndeshë m'duhet
tash nis tmerri i frymës që s't'mbërrin
nis mungesa e ditëve që kanë me ardhë
pa mehë n'amë zambakësh t'mpitë...
diku na prët vdekja kujtese me na shlirue
shkrimja e amës së dimrit n'shi
e ndoshta tash m'duhet me e shtrëngue
pse zemrës heshtinë ia kam prishë...
ndoj Shpirt ka me u ulë ndër prroje
dimnor me heshtue kohësh të mbulueme e sendesh

Mentor QUKU
(1939-2014)

NË VEND TË EPILOGUT, PËRSËRI NË ITALI
(Marrë nga libri “MJEDA I”)

*Pjesën tjetër që do ta shohë Zoti dhe superiorët,
as nuk kërkoj ta di.*

(Ndre Mjeda)



Një provë e re për Ndre Mjedën: Ai duhet të qëndrojë në Itali edhe disa kohë si një test për të provuar se është bërë jezuit i bindur. Me mbarimin e vitit shkollor 1887-88. Ndre Mjeda do të pësojë një tjetër zhgënjim: do të mbetet përsëri në Kolegjin Vida në Cremona të Italisë. Për mendimin tonë jasht dëshirës, jasht parashikimeve të tij dhe jasht shpresave të tij të zjarrta. Kjo spjegohet vetëm me prirjen e Mjedës për të takuar vendlindjen dhe familjen dhe nuk ka lidhje me argument të tjera që kanë dashur t’ia veshin këtij fenomeni. Duhet të

theksojmë se Mjeda ishte një klerik i devotshëm, rrugë të cilën e ndoqi me bindje, ndërkohë që ai ishte shumë i interesuar që të kulturohej dhe arsimohej në shkollat e përsosura jezuite. Shpresonte, që sipas programit të mbaronte studimet Teologjike në Universitetin Gregorian të Romës.

Në letën e 27 korrikut 1888, Mjeda mezi ç’pret të njoftojë Atë Dedë Pasin, mbi lëvizjet e ardhshme që parashikohen të ndodhin në Kolegjin

De Vida. Mbi të gjitha bie në sy informacioni se në Cremona pritet të vijë si Prefekt Muzike bashkëkombasi i tij, xhakoni Ivanoviq. Bëhet fjalë për një zëvendësim të mundshëm në kë detyrë të Ndre Mjedës. Parashikimi i Mjedës, përputhet me shpresë e tij për një transferim të mundshëm nga *Kolegji Vida* dhe me mundësinë për ta emëruar atë në Shkodër. Ndre Mjeda ishte një studiues i afirmuar në fushën e studimeve albanologjike dhe veçanërisht të gjuhës shqipe. Mjeda e mbyll këtë parade parashikimesh me një shprehje gjoja indiferente, por që nuk mund të besohet lehtë. Në të vërtetë Mjeda ndalon tek dera mbas së cilës mirren vendimet për shpresat e planet e tij, tek dera që ai ka frikë ta kapërcejë. Mjeda bën sikur është indiferent, si njeri që nuk i intereson transferta në Shkodër, me qëllim që të mos tërheqë vëmendjen e eprorëve për keq. Ka frikë ta bëjë këtë hap sepse mendon se mund të prishë punë. Në shprehjen e Mjedës mësojmë se brenda vetes poeti lutet në heshtje që ta transferojnë, që ta zëvendësojnë, që ta çojnë në Shqipëri, në Shkodër, që të shohë nënën dhe vëllain. Ai ende ka shpresa për një kthim të mundshëm në Shkodër. Mjeda ndërton një strategji të hollë për një kërkesë transferimi. Duke parë transfertën për vitin e ardhshëm shkollor, mësojmë se pothuaj të gjithë parashikimet e Mjedës janë realizuar. Mbetet pa u realizuar vetëm parashikimi për zëvendësimin e supozuar të tij me Ivanoviqin, i cili, në të vërtetë në vitin e ardhshëm shkon në Shkodër si profesor i Kolegjit Saverian. Ka shumë mundësi që dy xhakonat, Mjeda dhe Ivanoviqi, kanë qenë kandidatë alternative, ku Ivanoviqi ka qenë parashikuar të zëvendësojë Mjedën në Cremona dhe ky i fundit të emërohej në Shkodër. Mirëpo në minutën e fundit çdo gjë ka ndryshuar: Kahu i transfertës ka lëvizur. Ivanoviqi ka vajtur në Shkodër, ndërsa Mjeda ka mbetur aty. Diçka e papritur duhet të ketë ndikuar për këtë ndryshim. Mendojmë se kemi të bëjmë me një qëndrim konsekuent të superiorëve të cilët kanë preferuar një provë të re për Mjedën e ri, atë të mbajtjes edhe për disa vite të tjera larg vendlindjes.

Emzot Ernest Çoba, Arqipeshkëv i Shkodrës, në një intervistë, ka thënë: *“Jezuitët, para se me e ba meshtar, Mjedën e banë profesor në një shkollë të naltë, ku u shque tepër. Mbasandej u ba meshtar (si jezuit). Ata deshën me e mbajtë jashtë, si profesor. Kurse ai donte të kthehej në Shqipni e u prish me ta”*¹

¹ Ernest Çoba, intervistë e marrë nga Mark Gurakuqi, në Shkodër, me 6 qershor 1960, *Hulumtime e kumtesa lidhë me jetën e Ndre Mjedës*, në *Nëndori*, viti IX, nr. 8, fq. 147-

Duket si paradoksale që viti 1888, për Mjedën të jetë një vit me prodhimtari të bollshme, por edhe një vit plot vetmi, plot problem shpirtërore, një vit me luftë e paqë, me kryengritje e tërheqje. Në këtë vit Mjeda pati shumë plane, të cilat i realizoi në një pjesë të tyre, pati shumë suksese por edhe shumë dështime, shumë arritje, por edhe shumë tërheqje. Kjo është jeta. Medalja paska dy anë. Duhej që Mjeda të kishte këto probleme me veten e me mjedisin ku jetonte, duhet të kishte këto dallgë shpirtërore, që të ishte ai artist që qe.

Fadil **KRAJA**



Letër djalit

Ke punë të madhe thonë
E unë gjithnjë kam frikë
A kthehesh natën vonë
A lodhesh ndonjë çikë.

A flet gjithnjë në gjumë
Siç flisje në fëmëni,
Sa herë e mjera unë
Mbi kokë të jam gdhi.

Ruej veten t'keqen nana
E thuej nuses së re
Nuk vijmë atje; Tirana
E dimë, nuk asht për ne.

Ne fshati na ka rritur
K'tu jetën do ta çojmë,
Veç ti të jesh i lumtur,
Pa, tjetër nuk t'kërkojmë.

Veç s'paku në kohë të lirë
Na shkruiej ndonjë fjalë
Ti gja s'shpenzon o bir,
E ne largojmë mall

Një palë çorape leshi
Kam thur' për ty, janë gati,
Por nusja do të qeshë
Se janë çorape fshati.

Qëndrojnë tani çorapet
Në qoshen tande bosh,
E zemra që zhuritet
Të thotë: "O bir i gëzofsh!"

Eh, s'paku në kohë t' lirë
Na merr në telefon
Ti gjë s'harxhon o bir,
Ne zemrën na shendon.

Një cigare

Njëzet vetë ne ishim
Njëzet vetë ushtarë,
Një cigare kishim
Kush ta ndezë më parë?

Dielli na përvëlonte,
Etja na kish tha,
Nga cigarja s' donte
Asnjeri m'u nda.

Me një za vendosëm
T' hedhim lotari
Nuk asht prrall' o njerëz
Mos t'u vijë çudi.

Në letër kush të shkruente
emnin ma hyjnor,
atij do t' ia linim
cigaren në dorë...

mua m'qeshi f'tyra
Gjeta emrin "nanë"
Mendova cigaren
Mua do t' ma lanë.

U lexuan letrat
Nuk kisha fitue
Nga njëzet, tetëmbëdhjetë
"Nanë" kishin shkruë.

Vërejtëm njëri – tjetrin
Fytyrat shprehnin mall
Cigaren e ndezëm
E thithëm me rradhë.

Dielli na përvëlonte
Etjen lame mënjane
Zemrat na i shendonte
Emri i dashtun NANË.

Paulin **SHTJEFNI**
(1946-2018)



E THËRRAS...

Ne bashkë s' shetitëm asnjëherë,
As n' kinema nuk t' kam shoqnie,
Ndoshta ti kishe miq të tjerë
E ku më vinte radha mue?

Por zemra m' iku e më la,
Mbas teje shkoi në fluturim,
Tashti e thërras, por nuk ban za,
Në gjoksin tand gjeti pushim?

UNË SHOH VETËM YJE

Thonë se qielli sonte
Qënka mbushur me re,
Thonë se qielli sonte
Dashka të lotojë,
Unë i ngrita sytë
Dhe shikova qiellin,
Ashtu i menduar
Thirra gjithë gëzim:
-Unë shoh vetëm yje,
Yje pa mbarim
Që në sytë e tu
Ndrisin plot shkëlqim.

Përmbi supet tona
Shiu na pikon,
Unë të pyes ty:
-A je lagur shumë?
Por ti më përgjigjesh:
-Pse bëhesh merak?
Shiu që po bie
Nuk na lag aspak.
Unë shoh vetëm yje,
Yje pa mbarim,
Që në sytë e tu
Ndrisin plot shkëlqim.

NJË ZARF ME KARAFILA...

Prej së largu vjen një letër
Bjen shumë mall e dashuni,
I shkruen djali nuses së vet
-Ma plotëso një porosi!
Karafilat që ka Shkodra
Askërkund nuk i kam gjetë,
Mbush një zarf me karafila
E m'i ço se m'japin jetë.

Fluturon si zogu letra
Një përgjigje shkon shumë larg,
I shkruan nana djalit t'vet:
-Biri im, më ndigjo pak!
Mbi gjithë lulet që ka shpia
Në oborr e në saksi,
Karafil mbi karafila
Të ka nana vetëm ty.

Karafilat që ka Shkodra
Kërkund n'botë s'ke me i gjetë,
Po ti nisi me shumë mall,
Midis tyne je ti vetë!

Nexhmi **BUSHATI**

FAQE BURGU



Shënim: Në arkivin e Qemalit, në mes dorëshkrimeve të paboruara, bën pjesë dhe një fletore 52 faqesh ku, me një shkrim-dore me pendë e të lexueshëm, janë hedhur gjatë pesë javësh, ditë për ditë ose disa herësh brenda ditës, brenga, dëshira, ëndrrime, zhgënjime e mbresa të një djaloshi 19-vjeçar, të një studenti të burgosur për herë të dytë, të pafajshëm, arrestuar, pikërisht, kur po jepte provimet e maturës.

Nuk ka shënime për datat 23-24 dhe 30 korrik si dhe 1-2 gusht. Data e fundit është e martë, 3 gusht: dy ditë nga dita e lirimit.

Botimi i këtyre shënimeve, krahas atij të ditarëve, do t'i vlejë njohjes më të thellë të jetës e të botës së autorit. Theksojmë se botimi i mësipërm, ashtu si dhe për ditarët, qe dëshira e të vëllait, të ndjerit Enver Draçini, sikur e dëshmojnë dhe vetë nënvizimet e tij. Është respektuar gjuha dhe drejtshkrimi i origjinalit, po ashtu dhe shenjat diakritike. Gjithashtu

është respektuar drejtëshkrimi i pjesëzës “s”, (ndaras, pa apostrof, Qemal Draçini, ndjek kriteret e Mjedës.) (N. B.)

Qemal Draçini

16 korrik 1941 (mëngjez)

Ajrija e freshtë e agimit ma nxori gjumin që memzi m’i mbylli qepallat kur mesnata pat kaluem. Gdhîn dita e bukur, por e nxehtë. Afritem tu dritarja me dy palë frangijja të kryqueme – e ndij zhurmët e rrugës së afërme. – Por nuk e shoh! Ah, ti nuk mundesh me e marrë me mend trishtimin që të pllakosë shpirtin e brengosun kur ndîn nepër ndjenja të fytyrimit ndamjen e shpresave e të uzdajve.

Shoh fytyra të zvetnueme, fytyra mbi të cillat ndahen gjurmët e mjerimit e të kimit, - fytyra që më shikojnë si t’ishin vetë vehtëja e njëj bote tjetër. E mendoj: - në pranî të tyne do të rrrhqasin pasktaj ditët e mija. Këto imazhe të përfrigueshme të mbrûme me krimin do të më urojnë mirë-mëngjezet e mirë-mbrâmjet e ardhëme. Mos me të pamë mâ, mos me t’ruem mâ në mëngjezet e herta, heshtëshëm, “nadjen e mire”, mos me të përcjellë ambël, dëshirueshë me sý, kur ti u zhdukshë në qoshen e rrugës... Mos me ndijmë dridhjen e dhimbtun të shpirtit në mirimin e azurrítive të pambarim të syve të tu... Kurrgjâ mâ!... Në vend t’argëtimit që do të kunorëzonte sosjen e njëj orvatjeje të mundëshme për të mbaruem studimet e mjesme, - qe: gjëj kundrimin e mjerimit e të gjakut që m’i kargatisë drejt e më trenon...

Në këto çaste të vështira vetë mendoj për ty: Jé për mue hylli i udhëhekjes për shtegtarin e hupun rruge për një shteg të pambarim. Jé për mue rrezja e diellit të shpresës që ende më mban lidhun me botën e jashtme. Jé për mue gjallnimi i uzdajës në t’ardhme... Ti, vetëm ti, jé për mue...

16, Mbasdreke, orë: 19h. 40min

Ma parndjente zemra. Ndeja, përtej mase, në dritate me hekura dyfish të kryquem, - pse e ndijshem pranî tande! Kur, qe! Ti kalon ngadalazi, ti kalon e heshtun, ti kalon e urtë si gjithmonë. Kalon në kambisorën e kundruelltë, - e shikimi i yt snaltohet as vjedhtazi kah dritaret e shpís së gjaksís e të kimit. Unë u drodha! Kuptova aty për aty se ti e dijshe pranî teme në dritare. Prandej prigjova në se sýt e tu po sjelleshin me më dhanë një përshëndetje që kushedin mund të jetë fundore, një përshëndetje lamtumire... Por sýt e tu zaptuesa, - sýt e

tu, çurgime të pashterruna hiri e magjije,- nuk zditne gjysaterrin e qelís së madhe... Ti kalove e heshtun, e ftohtë, enigmatike si perore. Oh, jo, s'ké të drejtë!... S'ké të drejtë me e shtymë perbuzëtas blatimin e dashunís seme, e dashunís seme, e dashunís seme të madhe, të pamasë, të pakufi... Ti e din se ç'veriga më lidhin mue me ty! Ti e din se vetë jam i vetëm, shqimit i vetëm në botë e se vetmitare e shoh prospektivën e ditve t'ardhme. Vetmitare e zezë si terri i qelive të këtij burgu ndrydhës... Ty s do të kushtonte kurrigjâ një përshëndetje e heshtun: vetëm unë do ta kuptojshem, kurrkush tjetër!!

Por ti, oh, ti jë e ftohtë si muri i qelíve të ndýta...

17 Korrik 1941, e ejte (Mjesnat' e kalueme)

Ndij gërrhatjen e shokëve të bashkburgosun. E shokëve?...

Në se të këtille mund të quhen njerëz që s kanë kurrigjâ të përbashkët me mue përveç rrezikut të njëllojtë që na bân me kqyrë me sý të terratisun në ardhmënin e megjullueme... Flejnë!... Disa kanë në gjûmë ankthe mundimtare q'i mundojnë e i trembin. Të tjerë kanë dridhje të shpeshta që ua dridhin gjymtyrët e trupit...

Nepër qetí, ndij zhurmën metalike të njëj arme që mbushet nën dritare; ndij rojet natore

që ndrohen e, pak mbrapa, çapi monoton i sogjes vetmitare njehson me kadencë të njëllojtë orët që pa prâ ikin tue afritë, ndoshta një çast te zí...

Ti s'dukesh mâ. Vetë kaloj orët e gjata e të pambarim të ditës aty prânë dritares së "qelís shkodrane" - si i thonë - me të pamë një herë, - edhe një herë - tue kaluem urtë, e pakujdesëshme, ftohtë si era e kësaj mbrâmjeje së pavend vere së vonueme. E si era e mbrâmjes së korrikut që, megjithëse gërmushëse n'atë gjâmën e vet vajmitare, përkdhelë ambël e dhimbshëm fytyrën time këtu përpara hekurave të pakalueshme, - njashtu, dashunisht por egër, pranija e jote engjëlllore përkundë shpirtin tim... E natën e tmerrshme mendoj tu ti e tu fytyra e jote e tu sýt e tu të kaltherë, tu ti, engjëllush'e vocërr!...

18, e Premte

Po treno! Kujdesi i njëj së ardhmeje që s'njof, kushtet e njëj jetese që më mbytë, dridhjet e njëj ndjesije së papërgjegjun më kruejnë(?) mët e krés...

Deri më sot kishem shpresë se do t'i a delshem me u liruem prei

këtyne prangave të shterngueshme burgu para se D. të martohesh. Ti s e din, por mue më gazmende tejet mendimi se në darsëm të D. do të mund të të takojshshem edhe tÿ. Me të pamë tÿ, me biseduem me tÿ, me folë e me pasë teje përgjigjen vendimtare, që shka ishte për mue gëzim e haré e andje e andrramênde shpirti... E dij se po të lexonte një i dytë rreshtaj e mij, - ndoshta do të buzëqeshte ironikisht. Ndoshta edhe ti do të bâjshe kësodore! Por unë jam vetëm! S kam kurrkend që me folë, skam njerîf që me i u rrfyem. Tue shkruem këto rreshta, vetë kam mashtrín se të kam prânë, se të marr dorën tande në të mijat, se, tue kqyrë thellë ndër sÿ, të pëshpëris ngadalazi, ultë:

- Të due, pse e ndij të plotfuqishëme në shpirt tim ndjesín fisnike, ndjesín e naltë njerëzore të dashnís. Të due pse ti je trendafill agimuer i rinís seme... Të due... Ka rasa kur më kcen trilli me të marrë, me të shqimë, me të bâ erë, me të shëndrrue n'eter e me të thithë, me të bâmë frymë e frymës seme, me të bâ shpirt i shpirtit tem

Alfred ÇAPALIKU

(Nga libri me poezi “Vjeshta ngarkuar me mollë”)



Shkallët

Ngjitëse, zbritëse njëherësh,
Shkallë granili, mermeri,
Palosëse, rrotulluese,
Lëvizëse, fikse, druri,
Metali, mëndafshi, litari-
Aventuseske mes erës...
Rrëshqitëse akull janë
Veç shkallët e karrierës.

Ulqini i veshur me dritëhije

Ja shkëmbi në port si anije,
I veshur me dritë e hije,
Me erën e jodit ,të kripës,
Në çastin e fundit të ditës.

Ja shkallët në gjirin e detit,
E fundit takohet me pashqit,
Blerimkaltërsisë në ikje,
Mes yjesh në sfond si stërpikje.

Ja degët me kokrra ullirit,
Fenerë i feksin Ulqinit,
Mbi ledhe-gravura mbrëmjes,
Mbi valë-sozia e hënës.

Pa titull

Emri im është ndryshe dhe mbiemri tjetër,
Vendlindja false, datëlindja e gabuar,
Firma jo e rregullt, as përmasa e shtatit.
Fotografia e rinisë në ikje
Shpejt u vjetrua kimikisht nga rrudhat,
Horizontalisht e vertikalisht,
Si rrugët e vendit me theksin romanjol,
Që duhet t'i çaj si tren mëngjes – darkë,
Në këmbim ca eurosh për gruan e largët,
E pra në pasaportë figuroj beqar...
Ngre murre, laj xhama, shes xhingla,
heq borë,
Spërkas pemë, pastroj plazhe : në të zezë
E veç me natën bie edhe unë...
Ç'e do se në ëndërr më del një polic,
U bën një kontroll dokumenteve të rreme,
M'i kthen sit ë sakta, pasi i sheh
Se balli më ka mbetur si dikur, i ndershëm.

Vajza

Të kesh një vajzë kurdo mund të shohësh,
Nën çdo ombrellë në shi pika lotësh.

(Një lule margaritë
I bëhet buçetë.)

Të kesh një vajzë të vetme dhe larg,
Profili I hollë dridhet në skajp.

(Dy zymbyla në gotë
Formojnë një V.)

Të kesh një vajzë të ndarë me det,
Në gjuhë të huaj me vete flet.

(Tri gonxhe trëndafili
I japin aromë.)

Të kesh një vajzë ke gjysmën e botës,
Atë që ende s'ke ditur ta njohësh.

(Dhe katër karafila
I kthehen kurorë.)

Shkodra

Veshur me rrobën firmato të artit,
Dekor me gurë të çmuar kështjelle,
Arkitekturë e mbirë mes ujërash.
Partiturë himnesh për vegla tunxhi,
Braktisur dhe dëshiruar nhëlloj,
Në mëngjes numëron pikat e shiut,
Kurse në mbrëmje me katrorë dritash
Skicon hartën memece të Evropës.

EDICIONI IV, VITI 2011

Lisandri KOLA

SAGA E NJI DITE

I këputun fuqish e i dërrmuem trupi, hapi sytë ma së mbрами dhe kërkuj për me ba të njohun mjedisin, që më rrethon. Dhe mbas gjithë atij shtegtimi kapitës, gjendem në dhomën time. Mbasi e marr veten, ve re krejt udha ime e bame, ishte diku tek trimetërshi; domethanë, nga dhoma e ndejës der' në dhomën e gjumit. Kurse mue, në fakt, m'u duk aq e gjatë sa s'ka ku shkon mâ.

“Unë të pagëzuj n'emën të Atit e të Birit e të Shpirtit të Shejtë”, -ia priti një njeri, i mbathun në zhgun të murrmë e i lidhun mesit në konop gungash, tue lëvizë njikohësisht edhe dorën në ajër.

Dhe përnjherësh më vetëtiu syve një kaligrafi e moçme ku thoshte:

Vnte' paghesont premenit Atit et birit et spertit senit, por gjithsesi arrita t'i flas.

“Po e ban për të dytën herë sel!”

“Po ti qofsh i Tënzonë mor bir, po ty t'paska pa' ikë krejt ftyra. Çfarë e lige të paska pa' zanë kështu?”

“Kush po e merr vesh?!”

“Ulu njiherë se ke nevojë m’e marrë veten.”

Unë u ula, por derisa e bana këtë, nuk e vuna re se frati ishte ulë në karrigen e kompjuterit tem. Ndërkohë ai ishte i ndezun dhe paraqiste disa dorëshkrime të një murgnaje, abacie a kuvendi - nuk di si ta përcaktoj - të cilat kurrë ma parë s’i kisha pasë të rrujtuna në memorien/ mbamendjen e kompjuterit tem. Gjithsesi isha tepër i lodhun e i paardhun në gjendje të plotë fizike, për t’u marrë edhe me këtë bari njerëzish.

Ma pas në ato mjedise, ku vendoseshin ato dorëshkrime, të cilat të linin mundësinë për me i pa që ishin të shkrueme në një shqipe të hershme, shumë të hershme madje, u ba e gjallë një dyndje kësulash me do pishakë të ndezun. Sëpari, mendova se do e bastisin vendin e dorëshkrimeve. Qëllimin nuk e merrja dot me mend. Por ato kësula jo të truellit tonë, çka do të thotë se nuk ishin të bardha, s’ngurrue e i vunë flakën asaj sasive dorëshkrimesh.

Qiellit u duk një tym i zi, ma i zi se mitra e natës, që përhapej dendshëm me shtëllunga. Sikur të mos kënaqeshin me këtë mizori, nëpër zjermet e ndezuna prej atyne kësulëtarëve të zeshkët fytyre, ndrinin kokat e atij urdhni të shejtë, të cilat nuk vonuen e u rrokullisën përtokë si shalqij përpjetës së një vetulle mali.

“Vërtet që e mora veten. Ta di për nder shumë”, - iu drejtova fratit.

Ai nuk asht se foli, por u krodh mendueshëm grushteve të mëdha të dorës së tij.

Unë atëherë, nisa të kruej ca mjekrën, apo edhe të shkul ndoj qime të saj. Dhe ashtu si isha, nisa të sjell ndërmend tanë ato sende, që më ngjanë. Ma e bukura ishte se po më baheshin rrokopujë që të gjitha. Megjithatë në tanë atë mishmash imazhezh, qafën e asaj femnës në korridorin tim, e dalloja përbukuri. Ishte po ashtu. E njejtja. Me atë forcë tërheqëse. Por, ç’e do! Frati, lëvizi së ndejuni. Tue ma copëzue këso mënyre imazhin e asaj grueje dhe tue më diktue me pa gishtat në sandalet e tij, ngase po qarkullonte nëpër dhomë.

“Të tana na i dogjën bir!”, - tha dhimbshëm frati.

“...”

“Gjithë çka kishim rrujtë me vite e vite, në ato dorëshkrime të vyeshme për kombin tonë.”

“...”

“As çereku i atyne që kemi pasë nuk janë sot. Kishte shumë dokumente. Libra artistikë. Përkthime. Studime. E gjithëçka u ba hi.

Punuem shumë me vëllaznit për me i trashiguar ato materiale. Aq sa gjysa u vërbuen tue shkruar e do tjerë vdiqën prej për bamësve kimikë, që përdornim me fshi rrotullat e lëkurës, në të cilat gjendeshin shkime, që i vlerësuan si të padobishëm ma. Ne që ngelëm gjallë na burguen.”

“Hm.”

“Na çuen në burgje, që kishin ngritë vetë shqiptarë. Si duket po bashkëpunonin. Gjatë krejt kohës na fyenin dhe thoshin se ardhja në pushtet e tyne kishte me na shfaruar. Na mbanin si e keqe e kombit, prejse ne përbanim forcën intelektuale. Për ironi do zhelemela u banë pushtetës mbi ne.

Do njerëz që thirrnin me të madhe atë çka u kishin mësuar. Mekanikisht.

Gjoku vraponte ershëm nëpër breshtë. I vetëm. Pa kalorës. E pa shalë. Kalorësi mbeti. I shigjetuem e i lamë në gjak, me kryqin rreth qafës.

Kulla e rrënueme. Nusja e tij një e mjerë, që e shkërdhuen mbarë e mbrapsht një dorë burrash. Djali i tij, një kërthi i lidhun djepit, që rrokulliset shkambit e i namet fara.

Ungjilli i shkelun. Altari i shkatërruem. Sh’Mria e gjymtueme. Ejllat e çaraveshun. Gjithçka e përdhosun.

“...”

E na, burgjesh. Në punë fizike. Të detyruem me pa vëllaznit tek vdisnin nëpër biruca torturash. Tinzash tue këndue ndoj libër a tue përkthye gjasend. Ne. Tue pa gishtat tonë të vizatun e të ngimë me dheun, që vorroi vëllaznit. Ishte dheu i ashteve të tyne në duert tona. Dhimbja e tyne. Zezona. Gjaku. Ne... Bijtë e të Naltit. Mëkatnorët. Tue fshâ, tue gjimue në këtë shekull plot me lot. Ne tradhtarët. Paditësit. Spiunët.

“Ashtu!?”

“U detyrova me u bâ. S’kisha kah ia mbaja. Torturat më detyruen. Pushtetësit. Ndryshe prej të tjerëve nuk e fshehi. Asht gjâ të cilën e kam ba dhe më vjen keq. Nuk jam rrahgjokës për vujtjet e mia. Sikur unë kishte mjaft të dënuem. Por me mue e kaluen kufinin e torturave. Dhe ditën me më ba për vete.

Në burg kishim ndie për gjithfarë metodash për m’e ba tynin të burgosunin. Nga ma të ndryshmet. Disa edhe i kisha kalue. Disa m’i kishin rrëfye bashkëvujtësit. Një ditë më morën. Dy fytyra të reja. Më zhveshën, e përpara banë një punë hipnotike, tue më thanë: ti do

të jesh i yni. Kishin një qetësi të përsosun. E gjatë tanë kohës kishin sy jokërcënues. Sakaq deri në mbathje më nxorën. Po përpiquesha - me gjithë uratët, që po thosha - ta kaloja këtë provë. Nuk vonuen e më futën në një fuçi, mbase diku tek 200 litërshi, dhe më zhytën mbrendë. Duert i kisha të lidhuna. Ishte janar. Kishte borë jashtë. Pyetjes nëse do të isha me ta, iu përgjigja me 'jo'. Vazhdoi kështu nja do herë. Kur... nga një enë xhami morën një gjarpën tue ma lëshue n'fuçi. E hodhën. I vunë kapakun fuçisë, gjâ që nuk e kishin ba ma herët. Gjarpni po përdridhej. Akullsinë e trupit e trupit e harrova. Nuk më bante përshtypje përpara frikës së zvarranikut. Këtij i shtuen edhe një tjetër. Por ndërkohë që hapën kapakun, ashtu gati tue dhanë shpirt i hetova ata sytë e qetë të dy burrave. Kësaj radhe nuk më pyetën në do isha me ta a jo. U banë dy gjarpinj. Dy herë ma shumë po më lëshonte zemra. Ata më preknin në tanë trupin. Frika se do më kafshonin ishte e papërballueshme. I ndieja tek më ciknin me gjuhën e tyne. Dikur nisa t'i bie tanë forcën me krye kapakut. E hapën kapakun e më kapën për flokësh. Tue m'u dridhë buza e me qyrrat që më shkonin bashkë me lotët, lëshova një 'po' me vonesa tingujsh. Me zor ma qitte goja atë fjalë. Por s'kisha ç'baja. Zemra më rrihte e rrihte. Shumë shpejt. Po mërdhija. Te vona dy burrat thirrën në emër një roje e i thanë: Vishe këtë laskar. Hëpërhë më hodhën përsipër një thes, që kishte trajtën e një cohe të trashë ngjyrë bezhë. Ma pas rrobat e mia.

Nëpër qeli shokët e vëllaznit, mbas ngjarjes së asaj dite, - me gjithë fshehtësinë që po tregoja, se tek unë asgja s'kishte ndryshue, se thjesht ishte një torturë e radhës, - ishin ma të mbledhun në bisedat tona. Dinin edhe si të më qëndronin larg. Kështu vazhdoi historia, der' ditën që u lirova. Kur më shpallën emnin si njeri që fitoja lirinë, askush nuk erdhi të më përshëndeste a përgëzonte. Veç më shihnin. Nën sy. Mesazhi nënkuptohej. I liruemi që nuk takohej, ishte në shërbim të atyne, që na kishin mbyllë atje mbrendë.

Ditët e mia jashtë: me pseudonimin e caktuem, e raportimin e diktuem simbas llojeve të mënyrave, që na kishin thanë.

Shkurt ata më banë me qenë një tjetër njeri. Një njeri, që i ishte true fesë e këndimeve tashma i shërbente sistemit. Marreveshja ishte e preme - po qe se nuk punon si duhet për ne, zhdukesh nga faqja e dheut. Krahas disave që padita në burg e jashtë, i erdh ora edhe tim vëllai. Ose ma saktë binjakut tim. Ai ishte një njeri, të cilën me burgosjen time e kishin degdisë mjaft. Së fundi po punonte si shitës bulmeti. Përpiquej si

gjithkush të siguronte jetesën, tekefundit. Dhe motivi për të ishte ky: në kohën kur vdiq udhëheqësi, ky gjendej në bajë tue urinue dhe ia kishte marrë një kange popullore. Krejt gëzueshëm. Me siguri që ai nuk e dinte se jashtë derës së bajës kishte ndodhë gjama. Mirëpo unë raportova për binjakun tim. Kur atë e dënuen me 7 vite burg, ndeja dy ditë pa dalë nga shtëpia tue më zanë dhimbja për çka kisha ba. Po mendoja nëse do ta kisha kalue atë gjâ, pa e raportue, që në fund të fundit nuk kishte gjâ për me raportue. Dhe mbërrita në përfundimin se nuk ishte e mundun, sepse unë isha i tyni, isha si ata. Atë ditë që më nxorrën nga ajo fuçi, tu' u dridhë si thupra n' ujë, më kishin injektue ADN – në e vet. Domethanë më kishin futë djallin në trup. Krejt natyrshëm. Me një palë sy jokërcënues, të qetë. Me një buzëqeshje mirëdashëse. Me një heshtje të përkryeme. Me një llogari të përsosun të gjanave. Më kishin dhanë lëkurën e tyne. Mishin. Palcën.”

Nata kishte ra mbas dritores sime, me një hanë të zhigatun.

Frati psherëtiu.

Unë fika dritën dhe u ula me fjetë.

Brikena SMAJLI

ISHULL

(Nga libri “Humbim tue u ba botë”)



DITË-NATË

Heshtja është brumë i ardhun për bukë,
tek çdo njeri është një prallë...
një motmot është që mbushet me zâ...
është ditë që nisë me zbardhë.

Një vjolinë prân bregut të detit,
ku dallga then krahët...
...harku coptohet në grimca shkume
e tingulli është rânë...

I zi bahet gzimi:
ma fort se nata e pagojë,
ma fort se dita, pa Zot...
Jehona nuk mbërrin me mbajtë asnjë tingull...
asnjë zâ heshtimin s'e then.
Pse dita që lindë pa sy,
pa humnerë që lindë mali i naltë,

Nata n'hânë ngjyrat i mbledh...
e zgjâhet pa prâ.

Atje ku çdo dritë mbruhet me natë
dhe gzim bahet gjama dhe vaji;
si n'andrra...
kambët nguten me mbetë në baltë...
pse ecja lum asht në theqafje.

Por nuk mbulon as qiellin një re
Pse yj' edhe diell përmbi prapë bajnë dritë
Teposhtja kështu kthehet në rrëke
e naltmja një pikë që s'e mbrrijmë.

Kambët e ujnave shtypin tokën...
Shputa deti lanë gjurmë dhe barishte...
Ajri merr frymë në guacka
dhe luen shkambijtë.

Deti asht një pllambë n'dorën që shkruen ajrit
e fundoset n'letër.
Plagë asht dhe sy që digjet në thellsi.
Forcë ka prej ku t'bahet
e frymë dallge që thehet n'shkamb.

Asht lot i njelmë pasionit që vonon me u ba andërr...
 Po edhe fjalë asht deti,
 që e bjen zanin humnerash,
 shok me erën, me u ba ...
 edhe akull asht deti për ku merr me pra...
 po edhe zog bahet,
 zog i madh e i bardhë.

Qarkue me valle e det'
 kërkuj qiellin e naltë prej gurit.
 Mbi male zjermi m'drejton për kah veriu.

Prej mjegullet e tymit bahem,
 në thellësi e dhimbje, e ujit jam.

Mos e lypni zogun me fluturue majë malesh...
 për ku ajri s'ka shenj qëndrimi.
 Lypni për te pak bar e pemë,
 lypni kodrat e pakthyeme në duna rane t'shkretë.
 Mos e merrni mni
 s'mujt me e kalue e krahu ju randue tek bregu...
 asht zog që lumit ka shetitë
 e acari tha ia ka krahët...
 Asht veç zog,
 n'frymë e ka fluturimin
 ase asht vetë fryma
 për çka mundet me fluturue...
 me u ba ajër.

Kur fjala ka me iu kthye tingullit, me mujtë hapsinën ka.
 At'herë qiellit zogjtë kanë me i kërkue falje:

për krahët e lodhun, për zanin e mekun
e për foletë e prishuna...

Përditë ndërtohet mbi gjurmë e krena njerëzish...
prandaj asnjë kala ngritë s'i ka muret,
shpi që shemben janë duert e sytë...
lule pa fryt janë pemët e bimët.
Pse asnjë Rozafë nuk len amanet tamblin që bekon jetë...
...zogjtë kndojnë n'kafaze nate...

Dallga copëton guralecë e shtyn tej ranen,
Dallga rrah shkambin me zhurmë edhe gjamë.
Dallga copëton kujtesat në mijëra grimca drite e rane...
ndër ne, një det i gjanë e i randë.

Kambët ngasin në natë tue ndjekë tinguj,
tinguj të sermtë hane, njomë me shi.
Toka asht lodër që kumbon me hapa hane,
pjano asht, mbushë me zâna që buisin si currila uji.
Pika e lotit dhe gëzimi jetojnë në një zemër ma të madhe se dhimbja...

Mehmet H. GUCIA
(1943-2018)



O Mendime

-Pleqëria është barrë e rëndë, por e mbajme mbi supe, nga dëshira për të jetuar.

-S`ka njeri që i gëzohet pleqërisë, përkundrazi, ai i trëmbet asaj.

-Po t`mos ishte e bukura, nuk do të lindte dashuria.

-Kush e përjeton pleqërinë me dhimbje, nuk e vlerëson kohën që i ka mbetur.

-Gruaja e mënçur, nuk ia mëson burrit vendin që i takon.

-Gruaja që nuk di të administrojë bukurinë, bëhet robinë e saj.

-Nuk ka pleqëri të bukur përderisa asnjëri nuk i vete nga pas!

-Çdo dyshim i burrit është fitore e gruas...

-
- Artit, asnjë epokë nuk ka mundur t`ia mohojë atdheun.
 - Mendjes nuk i duhet kohë të zërë kohën.
 - Portën e mbyllur të harresës e hapë çelësi i artë i kujtesës.
 - Dielli i atdheut ka ngrohtësinë e trupit tënd!
 - Koha e të menduarit është më e shkurtër se ajo e të vepruarit.
 - Dëshpërohu kur ke humbur mundësinë për të kontribuar për të tjeret.
 - Kush s`ngopet me dashuri vdes i uritur.
 - Mund të rrëzohesh në dashuri. Zotësi është të ringritesh përsëri në dashuri!
-
- Të pasurit i ndërtojnë vlerat e tyre me para...
 - Nëse do të shohësh punën e të tjerëve, s`do të kesh kohë të shohësh punën tënde...
 - Marrëzia është shpërdorimi i urtësisë.
 - Mosbindja për gjëra të vogla, i druhet bindjes për gjëra të mëdha.
 - Zjarri i dashurisë ka më shumë dritë se ai që ngrohemi.
 - Puna me pagesë është mjet shpërblimi. Ajo pa pagesë një formë skllavërimi...
 - Zjarrin e ndezur nga fjala nuk ka ujë që ta shuaj.
 - Intelekti bën dritë edhe në errësirë.
 - Të mendosh shkurt, duhet kohë e gjatë të ndreqësh gabimet.

Xhahid **BUSHATI**

**DEDË GAJTANI (KOLA) – MJESHTRI SHPIRTPOET I
PËRKTHIMIT...**

Shënime për librin “Përkthime, poezi dhe poema” të autorit Dedë
Gajtani (Kola), Filara, Tiranë, 2014



1.

E kam takuar shpesh rrugëve të qytetit tim. Vonë ia mësova emrin. Shumë vonë! Për këtë arsye shumë kohë mbeti “I panjohur”, për mua. “I panjohur” mbeti gjithashtu, sepse nuk e përsëhëdeta dhe nuk e takova asnjëherë, së paku disa minuta. E kam peng. Po kështu ndodhi, për të mos e njohur, edhe pse “jetuam në një qytet”, siç thotë vargu i një poeti shumë të njohur.

Njeriu ende “I panjohur” për mua, pothuajse shëtiste vetëm. Me një vështrim paksa të çuditshëm, shpesh humbës... Ai vështrim, në at’fytyrë të brengosur, i ngjante një hëne që nuk donte të perëndonte në qiellin e qytetit të tij, ku banonte. Sikur donte ta jetonte vetëm at’ shkëlqim hënor

vetmitar. Sikur e kërkonte dhe e donte vetminë dhe perandorinë e saj. Nuk e di se çfarë kërkonte nga ajo? Mbase gjurmën e tij të vlefshme në at' vetmi? Mbase kërkonte që ajo të ishte dëshmitare? Mbase kërkonte që ajo të ishte e vetmja që të dëshmonte për thesaret e tij. Ai diç kërkonte përmes përmes viteve, për halleve e derteve, përmes frymëzimeve dhe ëndrrave, për dinjitetit dhe fisnikërisë... Ecte dhe kërkonte... teksat shtrëngonte fort pranë zemrës së lodhur e të përvuajtur pasurinë e tij diturore si përkthyes.

Po e përsëris: Pothuajse shëtiste vetëm. Shpesh i përhumbur larg zhurmave, kotësive, proviancialitetit, zhargoneve, rëndomtësisë, thirrjeve me zë të lartë e thirrjeve hysterike, fjalëve bajate e të qeshurave pa shkak. Të gjitha ato nuk i pranonte kultura prej intelektualit të ditur, përkthyesit pothuajse të heshtur Dedë Gajtani.

“Ç’ ishte kjo vetmi e këtij njeriu, që ishte bashkëqytetari im ende i “panjohur”?! Ishte një pyetje që ia bëja vetes, po në heshtje, sa herë e “takoja”, dhe përsëri ishim: “të panjohur”. Si ndodhi, kështu kjo panjohësi?! Nuk di t’i jap dum. Ama kështu po ndodhte?!

Shumë vite kaluan dhe ai njeri mbeti *enigmë* për mua.

Një ditë ndodhi e papritura. Po hyja në librarinë “Ora e Shkodrës”. Më pëlqen të vëzhgoj. Më pëlqen, krahas librave që blej, të shkëmbej dhe biseda me librarin (tashmë të njohur), për të marrë informacion të ri për librat që dalin apo që presin të dalin në qarkullim. Teksa po bisedoja... sytë e mi kureshtarë shëtisnin rafteve ku qëndronin librat radahë-radhë. Në një cast ndala sytë dhe u befasova nga ajo që pashë. Një libër qëndronte disi mënjanë. U afrova. “Edhe këtu... sikur kërkon heshtjen?!” – thashë përsëri me vete. E mora në duar me nxitim sikur do ta humbja... E vështroja kopertinën, shfletova faqet... Sikur nuk i zija besë syve e librit që kisha në duar. Ai qëndronte para meje si thesar, tashmë i njohur. U gëzoja, sa nuk gëzohet njeri në botë. Autori i këtij libri të çmuar ishte ai, ‘*I panjohuri*’, ai që e *takoja shumë herë dhe nuk arrita ta përshëndesja e ta takoja, së paku një herë*. Libri titullohej “Përkthime, poezi dhe poema”. Autori: Dedë Gajtani (Kola). Brenda faqeve ishte dhe ky përkushtim: “... Ne, fëmijët e tu patëm fatin e madh që ishe babai ynë.” – Gjoni, Kristina, Rozina, Antonieta, Zefi, Davida-

Për ta shlyer sadopak pengun, e mbështeta librin pranë zemrës dhe e përqafova me mall. Kështu erdhi rasti, o Dedë Gajtani (Kola) përkthyes e poet, të të përqafoj përmes librit tënd. Nuk e lëshoja at’ përqaftim të më ikte aq lehtë! Më duket se e gjeta çelësin e asaj enigme që më

mundonte, pse Dedë Gajtani (Kola) shëtiste i heshtur dhe vetmitar(?!). Ai shëtiste dhe komunikonte vetëm në një realitet gjeografik përkthimor. Në librin e tij mund të numëroje më shumë 65 autorë të huaj, ku Deda si poliglote gjuhësh, me kulturën e tij admiruese e gegënishten e tij të dashtun i kishte përkthyer kujdesshëm, me kompetencë. Deda, me anë të këtij libri, me mjeshtërinë e tij të përkthimit na bëri të njohur autorë pak të njohur e shumë të njohur botërorë që lëvtronin gjininë e poezisë, duke rritur lavdinë e frymëmarrjen e gjuhës shqipe.

Tani i thërras kujtimit tim, se Ai, teksa ecte rrugëve të qytetit tim, nuk ishte i vetëm, Ai “bisedonte” me poetët e shquar botërorë të librit të tij të përkthyer. Mbase kjo ishte arsyeja që e kishte humbur bisedën me realitetin e tij të përditshëm... Në marrëdhënie me të, ngjante sikur ishte *I huaj*, por në fakt ishte i nderuar.

Për punën dhe vlerat e tij, më mirë se helenisti Gjon Shllaku nuk mund të fliste kush tjetër. Edhe përkthyesi i Homerit ishte bashkëqytetar i Dedës. Përkthyesi kësaj radhe flet për Përkthyesin... Pra, Profesor Shllaku, Profesori i “Iliadës” plot 22 vjet më parë do të shkruante kështu: “... , mësova në mënyrë të posaçme se Dedë Gajtani ishte shumë i avancuar në gjuhën latine dhe ishte në gjendje të zotëronte krejt fjalorin latinisht-shqip të Padër Aldigerit. Me kohë u informova se Deda, nga që kishte një përgatitje të jashtëzakonshme të gjuhës italiane, gjithashtu kuptohet edhe për gjuhën shqipe, kishte bërë përkthime të shumta nga letërsia latine: si nga Tibuli, disa prej elegjive të këndshme e të dhimbshme; nga Properti, lirika të shquara për pasuri, stil dhe ide të larmishme; ndonjë nga poemat elegante të Katulit dhe të tjera nga latinishtja. Nga letërsia italiane kishte përkthyer lirika të Aleksandër Manzoni, si: “Pesë maji” etj. Kishte përkthyer “Kisha e Polentos” dhe “Valët e Klitumnit” të Karduçit, etj., etj. ... Pas disa vitesh që kishte dalë në pension, më erdhi në shtëpinë time në Qafë-Hardhi. U gëzova pa masë që më erdhi në shtëpi, ai personalitet i ëmbël, modest, i thjeshtë, pensionist, por energjik. Kishte sjellë me vete një paketë të madhe me dorëshkrimet e veta. Mbaj mend që lexuem me kënaqësi të madhe përrallat e Fedrit me një gegnishte të pastër, të rrjedhshme, me fjalë të zgjedhuna e shprehje të larmishme origjinale shqipe, thuajse po lexon Fedrin në origjinal (shqip), por me të ardhë gjynah që ai përkthim, dhe shumë lirika, balada, poema të huaja: gjermane, italiane, latine; të përkthyer me aq elegancë dhe harmoni në gjuhën shqipe nga mendja e dora e mjeshtri poet Dedë Gajtani, nuk kishin parë dritën e botimit.”

2.

Dedë Gajtani lindi në Gajtan, Shkodër, më 07.06.1915. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Kolegjin Saverian (Jezuitëve) në Shkodër. Ndërsa studimet e larta i vazhdoi në Kolegjin “Propoganda Fide”, në Romë, Itali, të cilat i mbaroi në vitin 1941. Që në shkollë të mesme e më vonë kur ishte student filloi të shkruante poezi. Ishte i apasionuar pas letërsisë botërore dhe gjuhëve të huaja. Nga viti 1941-1945 punoi në Institutin e Studimeve (Bibliotekën “Dante Alighieri”) në Tiranë. Në vitin 1945 emërohet arsimtar në Fier. Këtu fillon edhe kalvari i vuajtjeve të tij. Në një ditë të vitit 1946, kur ishte duke shëtitur në Manastirin e Ardenicës, e arrestojnë. E mbajnë disa muaj në hetuesi, në burgun e Beratit. E akuzojnë si agjent të Vatikanit, të Amerikës, etj. ... Pasi del nga burgu në vitin 1947, atë dhe familjen e tij e dëbojnë nga Tirana për motive politike. Dedën e emërojnë arsimtar në Maqellarë të Peshkopisë. Më pas në Krujë. Pas një viti e pushojnë nga puna. Në vitin 1954-1958 emërohet përsëri mësues fillore në fshatin Orosh të Mirditës, më pas në malësitë e Dukagjinit, e më pas në fshatrat e Malësisë së Madhe. Në vitin 1965 e pushojnë përsëri nga puna. Punoi punëtor ndërtimi për 5 vjet, deri sa doli në pension. Ishte i apasionuar pas natyrës, pikturës, notit dhe shahut. Ndërroi jetë, më 07.12.1993, në moshën 78-vjeçare në Shkodër. Po të shikohen “udhëtimet” e jetës së Dedës e po të shënohen në kalendar, ai kalendar është gjithë vuajtje. Është ferr, tmerr, dhimbje e pafund!

3.

Libri “Përkthime, poezi dhe poema” më shumë se gjithçka, nga koncepti dhe struktura, i ngjan një antologjie të pasur poetike. Ndërsa vetë autori i ngjan një “Lundërtari” që shtegtoi qytet më qytet, shtet më shtet, kontinent më kontinent, duke kapërcyer dete dhe oqeanë; vetëm me një qëllim të vetëm e fisnik: të sjellë në gjuhën shqipe sa më shumë emra poetësh të huaj, sa më shumë botë përkthimore. Nuk u lodh së punuari! Ndaj kjo gjeografi poetike “e vizatuar” në këtë libër, ka vetëm dimensione të pasura kulturore. Të bie menjëherë në sy edhe kultura shumëgjuhësore e autorit. Me emrin e Dedë Gajtanit lidhen poezitë e përkthyer nga: A. Rossini, A. Manzoni, A. Aleardi, G. D’Annunzio, H. Heine, V. Hygo, L. Ariosto, G. Barsottini, Brunamonti, Carrer, G. Capparozzo, D. Guerrazzi, G. Chiarini, A. G. Cesareo, T.

Colonna, Chateaubriand, L. Pignotti, G. Mazzoni, G. Carducci, Delille, V. Da Filicaja, G. Deabato, Paul Deroulede, U. Foscolo, A. Fusinato, Longfellow, A. Fogazzara, T. Grossi, J. V. Goethe, A. Graf, G. Giusti, I. Kasandrie, Ada Negri, G. Prati, G. Leopardi, R. Fucini, V. Maro, G. Marradi, A. De Musset, B. Menzini, Mayo, A. Novaro, E. Nencioni, G. Pascoli, P. Parzanese, B. Prina, E. Praga, E. Panzacchi, G. Pastocchi, A. Poliziano, Ruskin, Rinaldi, G. Catullus, F. Schiller, Shelli, B. Sestini, T. Tasso, J. Da Todi, E. Von Bauerfeld, N. Tommaseo, Felic Uda, G. Zanella, A. Zardo, Hebel, C. Bertola; si dhe përshtatje poezish sipas L. Orsinit, A. Manzoni, G. Berchetit.

Çdo autor i përkthyer mbart shkollën dhe filozofinë e tij, konceptin estetik të poezisë, strukturën, figuracionin dhe shprehësitë poetike, etj. Me të gjitha këto “u përball” suksesshëm përkthyesi Dedë Gajtani. Vetë përkthyesi kishte parapëlqimet e veta në përkthime, parapëlqime që lidhen me natyrën e tij delikate, drithëruese e poetike. Përkthimet e tij “ndalojnë” në disa tematika si: motive të festave fetare, motive biblike, pastaj vazhdojnë, si: dashuria për dritën, zemrën, shpresën... etj.; pastaj vazhdojnë, si: balada, lirika dashurie, fabula e poezi kujtimore... etj.; pastaj vazhdojnë, si: stinët e pranverës dhe të vjeshtës... etj.; pastaj vazhdojnë konceptet filozofike e sublime, si: qiellorja, hyjnorja, përmallimi, bekimi... etj. E gjitha kjo rrokje e gjerë motivesh, problematikash e mesazhesh, flet edhe për një veçori tjetër të përkthyesit, Deda ishte njohës shumë i mirë i prozodisë dhe i ndërtimeve të larmishme të vargjeve, të theksave e të rrokjeve, etj., të cilat i *dashunoi me gegënishten e tij të zemrës dhe rrezatuan si përkthime mrekullidhënëse.*

4.

Dedë Gajtani shumë nga përkthimet e poezive të autorëve që përmendëm më sipër, si dhe të poezive autoriale, i botoi, nëpër vite, edhe në këto revista: “Kumbona e së Dieles”, “Rrezja jonë”, “Shkëndija” (Tiranë), “Mbas Teje”, “Jehona e së Dieles”; në gazetat: “Balli i Rinisë”, “Zani i Shna Ndout”, Bashkim i Kombit” (Tiranë), “Cirka”, “Familja e Krishterë”. Nga gjurmimet tona, na rezulton se plot përkthime e krijime janë botuar para vitin 1944. Ndërsa të tjera shkojnë edhe pas vitit 1992.

Në pjesën e dytë të librit, Deda kësaj here na shfaqet si krijues, ka përfshirë një cikël poezish, që në formimin e tij kulturor ndjek me besnikëri shumë shkolla poetike të autorëve të përkthyer e pse jo ata

kanë dhe ndikimin e tyre, veçanërisht në imazhin poetik. Gjithashtu në këto poezi reflektojnë dhe gjurmët e jetës së tij plot trazime, vuajtje e pabuzëqeshje. Kështu tek poezia “Malli” që i kushtohet Shkodrës, do të gjesh flade malli, brengash, kujtimesh, dashurie për qytetin e lindjes. Ndërsa tek poezitë “Kalasë së Rozafatit”, “Andërrime - Vegime”, “Kujtime” etj., në mes andërrimeve vërejmë edhe nota pesimizmi, të kuptueshme këto për një shpirti të lodhur e të raskapitur siç ishte ai i Dedës. Edhe pse në këtë gjendje nuk harron t’u kushtojë poezi Poetit t’ambël Shantojës me titull “Zogu pa çerdhe” e Mësuesit të tij Ndre Mjedjes, për të cilin thotë: “Atje në Mjedë vajtojnë bilbilat, / Përmbi gamba të njomë të fojletës. / E përsërisin lehtë currilat / Si tue kja andrrën e jetës.”

Në vazhdim të ciklit, po përmend një poezi e cila është shkruar italisht dhe ia kushton të shoqes Marijes, të cilën e quan Ave Maria. (Deda është në Romë. Është viti 1938.) Kurse tek poezia në formë ninulle që ia kushton “Vajzës sime”, spektri i gjerë i dashurisë atnore zë vend hijshëm në çdo fjalë e rrezaton në çdo figurë që për zgjedh me kujdes prindi. (Peshkopi, viti 1949). Në fund po lë ca rreshta për poezinë “Nanë, lamtumirë!” Meditimi përmes vargut refren: “Nanë, lamtumirë!” sikur shkrin përmallimet dhe dramën e poetit. Çdo fjalë është dhimbje. Vetë dhimbja është komunikim mes poetit dhe nënës së tij të shtrenjtë. Poezinë e mbyll me këto vargje dashurie e malli: “Më shterngo për zemër, të mbramen herë më puth në ballë, / Pse ndoshta bashkë nuk shifna ma për të gjallë, / Por gjithmonë në zemër ka me të pasë yt bir, / Nanë, lamtumirë!”

EDICIONI V, VITI 2012**Hajredin Kovaçi****Liria**

Liria s'është veç fjalë
Liria s'është as mall
S'është as fluturim mbi mal
As lundrim mbi valë

Liria s'është që hahet
S'është as që pihet
Herë vjen herët e herë vonë
Nuk i dihet

Liria s'është veç e imja
S'është as e jotja

Lirinë mos ma prekni
Se shumë e kam pritur
Ju kurrë nuk besuat
Se do të vijë kjo ditë.

Dua

Dua ta ndryshoj këtë botë
Të mbrapshtë e të kotë
Që fundin e ka në prag
Që qelbet që vjell vrer
Dua që ç'ke me të
Ta ndërrj ta bëj për vete
Këtë botë të fëlliqur
Këtë botë të mjerë
Ku fyerjet vuajtjet poshtërimet vrasjet
S'pushuan asnjëherë
Dua ta ndryshoj këtë botë
Sa çel e mbyll sytë
E unë të bëhem qiell
Të bëhem tokë.

Hija

Herë më del para
Herë më del prapa
Për çdo rast
Hijes sime i shkoj pas.

Zef ZORBA
(1920-1993)

(Kumtoi në Festival Elena Zorba)



Zalli i Kirit

Zallet e bardha pa dritë
ku natën zbresin yje
me mijëra
pa u ndi.

Mbase janë sytë,
sytë e fëmijëve
që vdiqën në habi.

Qokthi

“...il mio cuore
sospeso nel buio, una voce”
S. Quasimodo

Në dendësinëe murrme të çinarit
heshtjet qyqare shqetësohen
e në shtëpitë e mënjanuara ngashërimi
bën dritën m’u dridhe
e erë
e shi prapa.

Për ato netët e Prillit
rishtas po ngjallet kujtesa:
vazhdimësi,
zemër që heq të shkoqet
prej flakësh të pabesa,
por fjala ngrin në gojë.
Prap mbeta vetëm, e dashur,
me murmuritjen e përvuajtur
të rrëkeve nëpër vija.

Strukur në errësirë, përmbi pullaze
daca thatiqë e të kërleshur,
melankolikë kotullohen,
e nëper rrugë përhapet
erë kubule të fërguar;
teha që natën shporojnë,
e shfrime.

Por diç njëherë gufon në gji
e m’jepet një buzëqeshje me ia prirë
çdo drite motër
që shuhet.

Tjera blerime

-Terezës-

Si lule dyelli gjethet,
veshur me vapë e t'zberë

e nuk lëviznin...

e merrnin frymë me zor...

e...oh...

S'andejmi
ku paskeshin ngelur kujtesë brymore
zgjohen flauri
tjera blerime,
rinore.

(A të kujtohet? Atë verë
burimet heshtja na i trazonte.
këndoja vijat e fatit
në dorën tënde flakë.
Endeshim rrugësh të çuditshme,
pa folë.

Pastaj n'teatër: një Gjido
i larë në djersë
përpëlitej i falisur.
Ti shkuleshe n'gaz me të madhe,
por në sy të vetëtinte
stuhia e Shtatorit...
A të kujtohet?)

Arjeta FERLUSHKAJ

**LETËRSIA POSTMODERNE DHE LEXUESI.
DOMINANTJA POSTMODERNE E RIDVAN DIBRËS**



I. LETËRSIA POSTMODERNE DHE LEXUESI

Çfarë është letërsia postmoderne?

1. “Një ndjeshmëri e re në shkrimet e pasluftës”? (I. Hassan)
2. “Fundi i metanarracioneve dhe preferenca për rrëfimet e vogla (*petit récits*)”? (Jean-François Loytard)
4. “Një rishkrim kritik/ironik, jo një rikthim nostalgjik tek e kaluara (metafiksion historiografik)”? (Linda Hutcheon)
5. “Rindërtim dhe rivizionim i kulturës artistike”? (Alfred Uçi)
6. “Ligjërime të ironisë dhe të fragmenteve”? (Luan Topçiu)
7. “Humbje e realitetit...relativizim i gjithçkaje”? (Astrit Salihu)
8. “Një teori dhe praktikë krijuese që ka poetikën e vet”? (Agim Vinca)
9. “Një prirje që nuk mund të përshkruhet kronologjikisht; një kategori shpirtërore, një mënyrë veprimi...çdo epokë ka postmodernen e vet”? (Umberto Eco)

10. “Situatë, aspekt i sjelljes krijuese”? (Agron Tufa)

Duke u dakordësuar me studiuesin Tufa, përmendim që, ndër aspektet e sjelljes krijuese që ai nënkupton janë: double coding-u (kodifikimi i dyfishtë), ironia intertekstuale, citimi etj. Arti postmodern përfshin gjithçka, atij i lejohet gjithçka – duket sikur thonë studiuesit sipas këndvështrimeve të tyre të ndryshme. Ai veç shtron pyetje, nuk jep përgjigje. Prandaj edhe I. Hassan konstaton se: “Unë sot di më pak për postmodernizmin se para tridhjetë vjetësh, kur edhe fillova të shkruaj për të”.

Cili është roli i shkrimtarit postmodern?

Statusi i autorit në një vepër letrare ka qenë gjithnjë i diskutueshëm, por edhe më shumë u bë i tillë në letërsinë postmoderne. Ja pse shtrohen mjaft pyetje, si:

Çfarë e bën një shkrimtar të jetë postmodern? Çfarë roli merr autori në letërsinë postmoderne? Si përballen teoricienët/kritikët me figurën e autorit në këtë letërsi?

Nëse më parë jemi mësuar ta shohim figurën e autorit si një “gjeni” krijues, teoria dhe praktika letrare postmoderne krijon një koncept krejt tjetër mbi autorin. Autori nuk është më gjeniu-artist por “njeriu duarartë”. Tashmë autori individual fshihet pas autorëve-lojë (intertekstualiteti). I ndodhur në qendër të botës së teknologjisë së lartë dhe të internetit, artisti ndihet si *pixel*¹. Duke huazuar nga terminologjia teknologjike, mund të themi që ky *artist pixel* është vetëm një nga qelizat apo një nga mini-hapësirat individuale të veprës, bashkimi i të cilave formon terësinë e tekstit të vet letrar.

Për R. Barthes, autori është thjesht një *mbledhës* apo *selektues* që përziën shkrimet e kulturave të ndryshme. Ndërsa, për J.F. Loytard-in, “artisti apo shkrimtari postmodern është në pozitën e një filozofi: tekstet që ai shkruan, veprat që ai krijon, në parim, nuk janë të udhëhequra nga rregulla të parathemeluara...[...] Artisti dhe shkrimtari, si rrjedhojë, punojnë pa rregulla por me qëllimin për të vendosur rregullat”.² Ndërsa origjinaliteti i tij vjen nga shfrytëzimi dhe ripunimi i mjeteve të duhura, por njëkohësisht edhe nga reflektimi mbi krijimin e tij në mënyrë

¹ Klaus-Michael Bogdal: “*Wer darf sprechen? Schriftsteller als moralische Instanz-Überlegungen zu einem Ende und einem Anfang*”. (cituar nga: Martin Sexl (red.): *Literatur? 15 Skizzen*. “Studien”. Innsbruck-Wien, 1997, f. 102.

² Jean-François Loytard: “*Answering the question: what is the postmodern?*” në: http://www.marginalutility.org/wp-content/.../machete_reading_may1_c.pdf (dhjetor 2011)

“filozofike”.

Shkrimtari Ridvan Dibra konstaton: “...një shkrimtar serioz, para se të jetë modern apo postmodern, është para së gjithash një artist i përgjegjshëm dhe i vetëdijshëm për artin që bën: një alkimist që “përzien” e “moderon” lëndën e mëparshme, pa harruar esencën e tij të pangjashme e të papërsëritshme...Pikërisht, në këtë proces të ndërlikuar e të larmishëm “alkimie estetike”, shfaqet edhe origjinaliteti i autorit postmodern”.³

Si ta lexojmë një vepër postmoderne?

1. *Duke sfiduar supozimet e zakonshme*: kjo letërsi i kërkon lexuesit të vet të jetë një bashkëpunëtor në krijimin e veprës apo kuptimit të saj, më shumë sesa të jetë një konsumues/lexues pasiv.

2. *Përmes angazhimit (engagé)*: ndihet nevoja e një ‘superlexuesi’ (W.Iser) apo Lexuesi Model (U.Eco), që të jetë i ditur.

3. *Përmes njohjes*: të dekonstruksionit, intertekstualitetit, pastich-it, double coding-ut, ironisë intertekstuale, ars combinatoria-s etj.

4. *Duke bashkëpunuar dhe ndjekur lojën e autorit*: lexuesi të jetë i vëmendshëm në ‘ngatërrimin’ që i bëhet raportit autor-personazh-narrator, në parodizimin e autorit, në lojën me intertekstualitetin, etj.

Përpjekja për të nxjerrë kuptimin (apo kuptimet) e një vepre letrare, është pikërisht ai proces lëvizës leximi nga njëri tekst tek tjetri, për të hetuar lidhjet mes tyre. Nuk ka tekst pa intertekst deklaron studiuesja bullgare Julia Kristeva prandaj edhe këtu zë vend koncepti i *letërsisë së rimbushur* i John Barth-it.⁴ Kjo na shtyn ta përkufizojmë postmodernen (kupto edhe tekstin letrar postmodern) si një ndjeshmëri e veçantë me një sjellje prej ironie intertekstuale.

II. DOMINANTJA POSTMODERNE E RIDVAN DIBRËS

Konceptin e dominantes⁵ nga Roman Jakobson-i ne e kemi marrë dhe përshtatur këtu për të shprehur se një tekst letrar postmodern nuk i përmban të gjitha tiparet postmoderniste njëherësh dhe ne zgjedhim të hetojmë dhe analizojmë dominanten e saj, siç pretendon të bëjë ky punim. Ne sot do të ndjekim leximin që i është bërë pesë romaneve të R. Dibrës:

³ Ridvan Dibra: *Një lojë me emrin postmodernizëm*, “Albas”, Tiranë, 2007, f. 106.

⁴ John Barth: *The Friday Book. Essays and other nonfiction*, “Maryland Paperback Bookshelf”, New York, 1984, f. 193.


⁵ Shih: Ann Jefferson, David Robey: *Teoria letrare moderne. Një paraqitje krahasuese*, “Albas”, Tiranë, 2004, f.82.

Triumfi i Gjergj Elez Alisë & Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë (përmes intertekstualitetit).

Franc Kafka i shkruan të birit (përmes hipertekstualitetit)

Sexonic ose Sesilja & Stina e maceve (përmes paratekstualitetit)

Fillimisht, le t'i hedhim një sy skemës së transtekstualitetit:



Siç e shohim, skema është bërë për të pesë kategoritë e transtekstualitetit, sepse në të ardhmen mund t'i vlejë një lexuesi të specializuar. Mirëpo, në ndërtimin e kësaj skeme, në ndihmë të kategorive zhenetiane, na kanë ardhur edhe figurat si parodia&alegoria / teknikat si palimpsesti, ars combinatoria etj.

Transtekstualiteti është një koncept përmbledhës i lidhjeve ndërtekstuale në letërsi dhe Genette i ka përkufizuar kështu:

- 1- *Intertekstualiteti* që përkufizohet si një marrëdhënie bashkëpranë ndërmjet dy apo më shumë teksteve; prania aktuale e një teksti brenda një tjetri.
- 2- *Paratekstualiteti*, i cili shënon ato elemente që shtrihen në prag (si pragje konsiderohen: periteksti dhe epiteksti) të tekstit dhe që ndihmojnë në orientimin dhe kontrollin e receptimit të tekstit nga ana e lexuesve.
- 3- *Metatekstualiteti*: kur një tekst hyn në marrëdhënie komenti me një tekst tjetër, metatekstualiteti bashkon një tekst të caktuar me një tjetër tekst mbi të cilin flet, por pa domosdoshmërinë e citimit (thirrjes), madje edhe pa e përmendur atë.

- 4- *Hipertekstualiteti*, përfshin çdo marrëdhënie që lidh një tekst B (hiperteksti) me një tekst të mëparshëm A (hipoteksti), në të cilin është shartuar, por jo në mënyrën e komentit.
- 5- *Arkitekstualiteti*, i konsideruar si tërësia e kategorive të përgjithshme e trashedentale-tipet e diskurseve, mënyrat e shprehjes, zhanret letrare-nga të cilat del çdo tekst.

Edhe vetë Genette e pranon se kjo ndarje nuk është absolute, jo vetëm që ka ngjashmëri mes kategorive por edhe mund të kenë kontakt reciprok mes tyre. Ne e kemi përfillur këtë vështrim strukturor të transtekstualitetit prejse, siç e cekëm më lart, kemi hetuar tipe të ndryshme të lidhjeve ndërtekstuale tek romanet e Ridvan Dibrës.

TIPI 1: INTERTEKSTUALITETI

Triumfi i Gjergj Elez Alisë & Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë

- a. *Triumfi i Gjergj Elez Alisë* është lexuar përmes ironisë intertekstuale. Por, ka rëndësi të qartësojmë diçka: Umberto Eco thotë se ironia intertekstuale qëndron tek luajtja e syrit që i bën autori lexuesit për të kapur referimet intertekstuale në roman. Në rastin tonë kjo nuk ndodh sepse Dibra i jep referencat që në titull që ne kemi të bëjmë me epin shqiptar të Gjergj Elez Alisë. Atëherë, ajo shkelje syri në këtë roman qëndron tek e fshehta dialogjike e monologut të protagonistit me heroin shqiptar dhe epokën e tij legjendare. Për të pasur këtë diskurs, ndihmojnë figura si parodia, alegoria dhe format intertekstuale si citimi, me gjithë variantet e shfaqjes së tij. Tek ky roman, autori luan me mitin, rikomunikon me të, e çmitizon, i vesh atij një përmbajtje të re ideo-emocionale. Çmitizimin e kemi parë në pesë boshte kryesore:
- *Marrëdhënia e Gjergj Elez Alisë me heroin legjendar*: e kemi lexuar si raporti i historisë me të vërtetën (aspekti autobiografik). Të dyja kanë reference letërsinë: miti i letrarizuar dhe Gjergji shkrimtar. Tek kjo marrëdhënie shohim shpalosjen e unit autorial përmes mitit legjendar. Këtu autori ngre një kurth, që është tipik postmodern: na tundon ne si lexues në njëjtësimin e protagonistit me autorin (humbja e kufirit autor-protagonist është *kurth* postmodern).
 - *Marrëdhënia e Gjergj Elez Alisë me Egobokën*: e shohim tek ndërtimi i njëfarë lidhjeje me jetën, botën reale, me njerëzit, ku përgjithësisht mban qëndrim kritik e mohues. Ky është tipar karakteristik i

prozës moderne por bëhet tipar postmodern prej marrëdhënieve intertekstuale me të shkuarën (epi) përmes dikursit ironik.

- *Marrëdhënia e Gjergj Elez Alisë me motrën*: kjo marrëdhënie është në kuadër të personazhit të deformuar, që vjen ri rezultat i rivizitimi ironik të traditës (folklorit).
 - *Marrëdhënia e Gjergj Elez Alisë me femrat*: marrëdhënie e cila mungon në epos (përveç asaj motër-vëlla) dhe është në kuadër të stereotipit legjendar të përmbysur (Gjergj Elez Alia që ka një të fejuar që viziton shtëpi publike etj).
 - *Marrëdhënia e Gjergj Elez Alisë me Balozin*: një marrëdhënie katalizator, është në kuadër të transformimit përqeshës, i cili në fakt shtrihet në të gjithë romanin. Janë figura që çmistifikohen, që nuk kanë asgjë të mbinatyrshme. Ajo që dimë është se kemi dy figura heroike, dy trima, por rishikimi i tyre duhej bërë në mënyrë ironike (paraqiten si njerëz të zakonshëm). Ky është kushti postmodern.
- b. *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë* është një shkrim i rikontekstualizuar që parodizon personazhe apo situata qoftë të qëna apo duke shpikur të reja. Paradoksi postmodern krijohet jo vetëm me epin por edhe me romanin e parë. Leximi alegorik i këtij romani është përqëndruar në dy shtylla kryesore:
- Egoboka, me referencë Shqipërinë për të cilën kemi përgatitur këtë skemë si dimension alegorik:




- Balozin, me referencë diktatoriatin por kjo figurë është

shumëdimensionale dhe ne e kemi shpalosur në tre qëndrime përmes këtij grafiku:



Këto dy boshte grafiqesh (Egoboka dhe Balози) i kemi përafuar mes tyre përmes një përshtatjeje të mundshme, siç na duket se sugjerojnë teksti:



Alegorizimi i këtyre dy boshteve pra shkon edhe në një nivel tjetër: marrëdhënia prej aleatësh (afirmimi) me të kaluarën e largët- marrëdhënia prej tiranie (diktatura) me epokën komuniste dhe së fundi, marrëdhënia prej rivaliteti që karakterizon shoqërinë kapitaliste (demokracia).

TIPI 2: HIPERTEKSTUALITETI (PALIMPSESTI)

Franc Kafka i shkruan te birit është shkruar përmes praktikës hipertekstuale (palimpsestit). Për nga raporti me origjinalin, palimpsesti zgjedh mes: transformimit (konform origjinalit) dhe imitimit (përthyes i origjinalit). Ja si e paraqet Genette praktikën hipertekstuale:

Gjendja Marrëdhënia	Lozonjar	Satirik	Serioz
Transformimi	Parodia	Travestia	Transponimi (Zhvendosja)
Imitimi	Pastich-i	Karikatura	Falsifikimi

Ajo që ndodh tek romani “*Franc Kafka i shkruan të birit*” quhet *transmotivim*⁶ (Genette) sepse ky hipertekst na jep motive dhe karaktere që nuk i ka hipoteksti. Ne kemi paraqitur në një tabelë disa nga transformimet semantike që kanë ndodhur në roman përmes procesit të transmotivimit:

TRANSMOTIVIMI	
LETRA (hipoteksti)	ROMANI (hiperteksti)
(Biri aktiv-letërshkruesi)	(Ati aktiv-letërshkruesi)
Frika nga ati	Dashuria për birin
Ndjenja e fajit ndaj atit	Ndjenja e fajit ndaj birit
Ashpërsia atit ndaj birit	Mirëkuptimi i atit ndaj birit
Shtypja e papërballueshme nga ati	Krenaria për birin
Presioni ndëshkues i atit	Shtysa për vetëbesim (ndikimi ndërsjellë)
Ati, masa e gjithçkasë	Biri, masa e gjithçkasë
Epërsia e atit ndaj birit	Epërsia e birit ndaj atit
“Kolltuku i atit”-mbizotërimi i botës	“Kolltuku i atit”-ndjesia e hiçit
Mungesa e dialogut	Dialogu i vazhdueshëm
Pasiguria e birit para atit	Siguria e birit para atit
Suksesi i metodës edukative (diktati)	Çalimi i metodës edukative (standardi)
Kërcënimi nga pushteti atëror	Mungesa e pushtetit (të egër)atëror
Forca e atit, dobësia e birit	Forca e birit, dobësia e atit
Biri i paqëndrueshëm, dyshues	Biri i qëndrueshëm, pohues
Felicità- e dashura (personazh figurë)	Felicità-nënë (personazh katalizator)
Lufta e pashpallur atë-bir	Heshtja prej dashurisë atë-bir
Judaizmi	Budizmi
Rritja e mosbesimit tek biri	Rritja e vetëbesimit tek biri
Biri “shfryn” në art figurën e atit	Biri “hedh” në art modelin e atit(artist)
Poshtërimi nga ati	Vlerësimi nga ati
Zgjedhjet e detyruara në jetë	Zgjedhjet e pavarura në jetë
Mbyllja: nevoja e përmirësimit të marrëdhënies	Mbyllja: vazhdimi i kësaj marrëdhënieje

⁶ Graham Allen: *Intertextuality*, “Routledge”, London-New York, 2000, fq. 110.

Përmasa autoriale e dominon romanin ndaj dhe mund të themi se kufiri ndarës mes tyre bëhet vështirësisht i dallueshëm në pjesën më të madhe të veprës. Kjo shenjon arritjen e pikës kulmore të fuqisë krijuese ndaj hipotekstit, aq sa duket sikur janë “fshirë” gjurmët hipotekstuale, prejse krijimi i ri vjen tek lexuesi estetikisht i arrirë. Dibra e ndërton rrëfimin përmes një “dialogu fiksional” që shpërfaqet në dy linja semantike: a. *Dialogu mes brezave* dhe b. *Dialogu mes artistëve*. Sfida e brezave paraqitet në tekst si një mesazh që peshon, tek ai vetë dhe tek brezi i ri sepse në këtë roman, shohim të gërshetuara disa “mënyra komunikimi midis brezave, që bartin në vetvete kontraste të dy kohëve dhe dy botëve”⁷, nëse i referohemi edhe lidhjes me hipotekstin. Detaji i përzgjedhjes së këtij hipoteksti rrok dy motive që përputhen mjeshtërisht: statusi i privilegjuar i dorëshkrimit (letra) tek poetika e postmodernizmit dhe ndikimi nga shkrimtari Franz Kafka, i shpërfaqur në mjaft vepra të Dibrës, si shenjë nderimi dhe afirmimi. Prandaj edhe ne do ta quanim këtë roman një roman testament: testamenti që autoriteti letrar i Franz Kafka-s i ka lënë Ridvan Dibrës. Ky i fundit ia përcjell atë lexuesit të vet përmes linjës së goditur: ati që i flet të birit artist.

TIPI 3: PARATEKSTUALITETI. ARS COMBINATORIA

Sexonic ose Sesilja & Stina e maceve

Teknika e montazhit apo siç quhet përgjithësisht *ars combinatoria* “nënkupton mënyrën e ligjërimit në një tekst narrativ postmodern, kur bëhet një kombinim i një dokumenti, një teksti joletrar, me një tekst letrar, ku i pari futet në të dytin, duke u rikontekstualizuar në kuadër të tekstit të ri.”⁸ Përderisa jemi në postmodernizëm dhe në modelin e veprave të hapura, gjen përdorim *kolazhi* e *pastich-i* (përzierja e diskurseve, stileve, gjinive, fushave të ndryshme etj.), atëherë mund të themi se ky art i kombinimit është një ndër dukuritë më të rëndësishme të postmodernizmit letrar. Ne do t’i lexojmë këto vepra duke iu referuar dominantes së tyre, konkretisht: romanin *Sexonic ose Sesilja* përmes praktikës së paratekstualitetit dhe *Stina e maceve* përmes metodës së kombinimit (në kuadër të poetikës postmoderne *ars combinatoria*).

a. *Sexonic ose Sesilja* është një roman që na prezantohet përmes fragmentaritetit dhe përdorimit të elementeve peritekstuale.

⁷ Tefë Topalli: “Njëzet vjet letërsi të Ridvan Dibrës”, në: Kërkime gjuhësore 2, Lezhë, 2011, fq. 172.

⁸ Adil Olluri: *Romani postmodern shqiptar*, “AIKD’99”, Prishtinë, 2011, fq. 169-170.

Në përpjekje për të zbrëthyer kodin e paratekstit që hap romanin, mund të dallojmë aty çelësat që na jep në dorë autori për ta lexuar veprën:

“1. NJË HERË, vetëm njëherë i dorëzohesh frymëzimit të ashtuquajtur “hyjnor”. Mandej Letërsia kthehet në “lojë”, “lojë” me veten dhe me të tjerët. Kështu ndodh edhe me *Dashurinë*.

2. *GJITHÇKA në Universin tonë ekziston falë një simetrie të përkyer. Simetri që do ta kishte edhe trupi i njeriut, nëse diku në anën e majtë do t’i mungonte diçka e vogël. Është fjala për Zemrën.*

3. NDODH të rrëzohen e të bastardohen gjithë kultet e mitet, ashtu siç mund të ndodhë të vihet në dyshim gjithçka. Në raste të tilla është fort e rëndësishme t’i besosh dikujt. E pse jo, *Formës?*”⁹

Me këtë roman, Ridvan Dibra bën lojën me seriozitetin. Autori argëtohet (dhe argëton) jo vetëm me përmbajtjen, por edhe me formën, sepse eksperimenton në tekst me elemente si kolazhi, fragmentarizimi, citimi etj. Ironia e autorit tek loja me Sexonic-in dhe Sesiljen paraqet dilemën: të dukesh apo të jesh? Ky projekt moral, e jo vetëm, i rëndësishëm për epokën e thyerjeve dhe ndryshimeve të mëdha në shoqërinë e sotme njerëzore, vjen tek lexuesi përmes temës serioze siç është letërsia-krijimi.

b. *Stina e maceve* është një roman i poetikës kombinatorike (pastich-i) dhe si i tillë, ka elemente letrare e jo letrare. Shohim më poshtë si e ka strukturuar autori tekstin letrar:

1. HYRJE

-E shtunë, 7 mars. Mëngjes. Dhomë gjumi. Shtrat i shpupurishur bashkëshortor.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve” (pjesa e parë)

2. ORIGJINA E LLOJIT

-E shtunë, 7 mars. Mëngjes përsëri. Kthinë e çrregullt. Tryezë e shtruar vetëm për dy vetë.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve” (pjesa e dytë)

1. FIZIOLOGJIA

-E shtunë, 7 mars. Paradreke tashmë. Studio pune e mbyllur me çelës nga brenda.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e tretë)

2. SHQISAT

-E shtunë, 7 mars. Përsëri paradreke. Studio pune e çrregullt dhe e rrëmujshme.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e katërt)

3. RIPRODHIMI

-E shtunë, 7 mars. Kohë dreke. Tryezë e shtruar për dy vetë. Diku në qoshe të një restoranti përplot me njerëz.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e pestë)

4. RACAT

-E shtunë, pak pas drekës në restorant. Dhomë gjumi. Shtrat bashkëshortor thuasje i paprishur.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e gjashtë)

5. PËRKUJDESJA DHE USHQIMI

-E shtunë, 7 mars. Pasdreke. Vaskë banjoje me ujë dhe studio pune e mbyllur me çelës nga brenda.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e shtatë)

6. SËMUNDJET

-E shtunë, 7 mars. Prag muzgu. Dy karrige prej kashte e lëkundëse në të dy skajet e një verande të madhe e të bukur.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e tetë)

7. VAKSINIMI

-E shtunë, 7 mars. Pasmuzg. Në verandën e madhe e të bukur janë vendosur gjithandej karrige prej kashte e lëkundëse, në të cilat kanë zënë vend miqtë e ftuar.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e nëntë)

8. TRADITA E MITE

-E shtunë dhe e diel, 7- 8 mars. Mesnatë. Dhomë gjumi. Shtrat i shpupurishur bashkëshortor.

-Fragmente nga punimi shkencor: “Konflikti seksual mes vertebrorëve”
(pjesa e dhjetë dhe e fundit)

Siç mund të shihet, përmbajtja e këtij romani ngjan me pasqyrën e lëndës së një libri shkencor. Kemi praninë e modelit joletrar brenda një teksti letrar për nga paraqitja formale. Këtë parim të artit të kombinimit, Dibra këtu e përdor mjeshtërisht. Në këtë roman shohim pra se si “shtresimet e kuptimit vihen me sukses njëra mbi tjetrën, pa e cënuar asnjëherë shumëkuptimësinë e rrëfimit”¹⁰ dhe vazhdon me kujdes ironia e autorit edhe tek cilësia e përmbajtjes së punimit shkencor që po shkruan protagonist-linguist e sociobiolog. Kjo është merita e tekstit të hapur, që i përgjigjet estetikës pluraliste e kërkuar nga poetika postmoderne.

Me këto dy romane, Dibra tregon se fiksioni postmodern është një lojë. Lojën e gjejmë në ironinë, citatin, në fragmentarizimin që i bëhen teksteve, në kolazhin informativ, në polemika e teorizime, etj. Të gjitha këto shënjojnë karakterin eksperimental në letërsi.

* * *

Në trajtë përfundimi mund të themi se, letërsia tashmë po i ikën karakterit monologues duke i lënë vend dialogjizmit. Në rastin e shkrimtarit Dibra, autori “komunikon” me kodet popullore dhe elitare (“Triumfi i Gjergj Elez Alisë”, “Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë”), është praktikues i teorive intertekstuale (“Franc Kafka i shkruan të birit”) dhe përmes këtij kodifikimi të dyfishtë, letërsia përfton edhe tipare karnevaleske përmes *mesalliance*-ës, afrimit të të papajtueshmeve (“Stina e maceve”, “Sexonic ose Sesilja”). Dialogjizmi është tashmë konstantja e komunikimit mes veprës dhe lexuesit, të cilin e fton (semantikun) dhe e sfidon (semiotikun) njëherësh. Ky komunikim është një marrëveshje mes tyre. Autori dhe lexuesi, përmes kësaj njohjeje dialoguese (enciklopedia intertekstuale dhe double coding-u), realizojnë pritshmëritë respektive.

¹⁰ Ramadan Musliu, tek “*Stina e maceve*“, (fund-kopertina e librit), “Buzuku“, Prishtinë, 2006.

Literatura:

1. ALLEN, G., *Intertextuality*, "Routledge", London- New York, 2000.
2. APOLLONI, Ag: *Parabola postmoderne. Romanet e Rexhep Qosjes*. Instituti Albanologjik, Prishtinë, 2010.
3. ARAPI, Fatos: *Këngë të moçme shqiptare. Studime*. "Naim Frashëri", Tiranë, 1986.
4. BARTH, John Barth: *The Friday Book. Essays and other nonfiction*, "Maryland Paperback Bookshelf", New York, 1984.
5. CONNOR, Steven (red.): *Postmodernism*, "Cambridge University Press", New York, 2004.
6. DIBRA, Ridvan: *Triumfi i Gjergj Elez Alisë*, "Onufri", Tiranë, 1999.
7. DIBRA, Ridvan: *Triumfi i dytë i Gjergj Elez Alisë*, "Buzuku", Prishtinë, 2002.
8. DIBRA, Ridvan: *Sesonix ose Sesilja*, "Ombra GVG", Tiranë, 2005.
9. DIBRA, Ridvan: *Franc Kafka i shkruan të birit*, "Toena", Tiranë, 2006.
10. DIBRA, Ridvan: *Stina e maceve*, "Buzuku", Prishtinë, 2007.
11. DIBRA, Ridvan: *Një lojë me emrin postmodernizëm*, "Albas", Tiranë, 2007.
12. ECO, Umberto: *Lector in fabula*, "Bompiani", Milano, 2010.
13. *FOLKLORI SHQIPTAR II. Epika legjendare*, vëllimi I. Instituti i Folklorit, Tiranë, 1966.
14. GENETTE, Gérard: *Figure III. Discorso del racconto*, "Einaudi", Torino, 1976, 332 f.
15. HUTCHEON, Linda: *A poetics of postmodernism. History, theory, fiction*. "Routledge", New York-London, 1988.
16. JEFFERSON, Ann; ROBEY, David: *Teoria letrare moderne. Një paraqitje krahasuese*. "Albas", 2004.
17. KAFKA, Franz: *Letër babait*, "Phoenix", Tiranë, 2000.
18. LOYTARD, Jean- François: *Gjendja postmoderne: raport mbi dijen*, "Dukagjini", Pejë, 1996.
19. OLLURI, Adil: *Romani postmodern shqiptar*. "AIKD'99", Prishtinë, 2011.
20. PIÉGAY-GROS, Nathalie: *Poetika e intertekstualitetit*, "Parnas", Prishtinë, 2011.
21. TOPALLI, Tefë: *Kërkime gjuhësore 2*, Lezhë, 2011.
22. TUFA, Agron: *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX*, vëll.I, "SHBLU", Tiranë, 2008.
23. TUFA, Agron: *Letërsia dhe procesi letrar në shekullin XX*, vëll.II, "SHBLU", Tiranë, 2008.
24. VINCA, Agim: *Panteoni i ideve letrare*, "Camaj-Pipa", Shkodër, 2002.
25. WELLEK, René; WARREN, Austin: *Teoria e letërsisë*, "Shtëpia Botuese Enciklopedike", Tiranë, 1993.

EDICIONI VI, VITI 2013

Astrit FANI

**Asht' ba me drasht', ba me
dasht'**

Dashuninë po e bajmë me plasë.
E shkreta,
Nuk din ku me u m'sheh,
Asht' ba zhele.
Dikur ndër zemra,
E tash veç rrugëve,
N'shi e etun,
N'borë e s'trukun,
N'diell e vyshkun.
Asht' gjithkund,
E na, nuk dona me e pa.
Me za t' butë na lutet:
"Pash emnin tem,

A vi sonte me ty !?"
E përbuzim, i falim lekë.
E shkreta....
Hin n'vedi e bindun
Se e kena harrue.
Nuk jam lypëse, thotë,
Jam dashunia,
Unë veç fali...
A asht' me drasht', ba me dasht'!?
më kujtohen duart mbi bankë
jaka e bardhë mbi përparsen e zezë
zilja tek duart e plasarituna
të një gruaje t'vujtun e shpirt
t'qeshun
hokja
bishtagypi
letra terse
buzëqeshja
fjala e ambel e një gruaje
që zemra përjetësisht e therret
mësuese
çdo gja kujtoj
këpucët e reja
çanten e falun
a-në dhe zh-në
arifmetiken
bukurshkrimin
sytë e shoqes së bankes
ku ka si dita e pare e dijes....

o grue e dashtun
grue me sy t'mbuluem
me pëlhurë qielli
aspak e plakun
e vaditun me drit dielli
e buzqeshje hane

e te dyja kacafyten me njena tjetren
 kush me t' dasht ma fort
 ti mbete nje grue fine
 me mendime t'stivosuna prej
 dashnorëve tuej
 grue qe nuk u martove kurrë
 vec për hater të femijve
 grue që afshin e dashunisë
 e krenarinë e lindjeve
 i mbajte si medaljon jete
 o grue e virgjër me kambë n'tokë
 ti nuk ke me vdeke kurrë
 bekue qofshin ata që të thirrën
 n'përrjetsi,
 bekue ne
 që t'therrasim Loce
 Shkodër
 o grue e dashtun

kur të vish pas lojës me borë
 merre mallin e saj t'pashkrimë
 ruaje tek kujtimet e fminisë
 digju si eshkë
 e ktheja zemren krahorit si
 atëherë...

Kohë pandemie

Qyteti hesht
 Fladi pranveror hap siparin stinor
 Cicerimat e zogjve dirigjojnë
 thashethemet e çative që flasin
 nën zë. Nesër do të jetë ndryshe
 Pavarësisht se supet tona janë

ngrit në kufijt e absurdit. Bota do të sillet përsëri dhe hëna
në orbiten saj. Po, do të duhemi më fort
Nuk kemi arsye të shtiremi si sot
e si ngahera
Edhe pse pabarazia ka për t'u
zhytur në ujrat e vet
Shumëkush ka për t'u bindur
Se leku, s'mira, urretja, krimi,
babzia...nuk është fitim.
Fituesit do jemi ne, unë, ti dhe
pranvera e tokës.
Dashuria do ta njohë veten.

Sa i penduar jam që nuk ta fala
frymën time të dliërë në rininë e
hershme.....
Vonë nuk asht kurrë.
Merre...
Qëndise si din ti
E nese ta thotë zemra ma fal...
Dua ta ekpozoi në muzeun e
Gabimeve të pakta
Nëse don të ta vizitosh
Po ta thëm adresën.
"kopshti i shpirtit tim".

Albri **BRAHUSHA**

ATJE KU GJEHEN FJALËT



Asht mesi i verës dhe më kanë xanë ethet. Mërdhij si edhi i dimnit. Duhet të jem shumë i *smundun*. Mjeku jem i lagjes nuk më ka dhanë asnjë shpresë, nuk ia ka idenë se çfarë lloj diagnozet mundet me më shkruie në kartelë. E shoh se si vuen tuj më pa kah dridhem si qen. Më jep një letër për mikun e tij, mjek i famshëm, që punon në spitalin ushtarak. Nuk e di kah më vjen qetësia dhe humori, por më vjen me qeshë me të. Asht aq i mërzitun, sa më duket sikur po merr pjesë në vorrimin tem. Marr letrën dhe largohem pa trishtim tuj u dridhë si gjithnjë. Kujtohem për ethet e arit, dhe ato tropikale dhe kënaqem tuj u rrejtë se ndoshta mos më ka shkue në mend, o mu e ba i pasun, o me marrë pushimet në Afrikë. Por e di mirë nuk asht asnjena prej këtyne. Ethet janë të bezdisshme. Ma besoni, por jo gjithmonë, e rasti jem ban përjashtim. Ethet e mia më sjellin një lloj kënaqësie që ngjet shumë me orgazmën. Nuk asht hera e parë që më xanë këto lloj ethesh. Kajherë e shtyj vedin me mbërritë në gjendje të këtilla, sepse due me provue se sa arrij me mbajtë. Kurrkush ma mirë se unë nuk e din se çka kam. E shkyej letrën që kishte me marrë mjeku i famshëm në spitalin ushtarak. E di mirë se kur mjeku jem i lagjes nuk

ma gjen llojin e ethes, s' duhet me u shqetësue aspak.

Ky asht rasti me thanë se më kanë xanë ethet e fjalëve. Kam nevojë për doza fjalësh, pa të cilat ethet do të më vazhdojshin pa fund. Sa dal në rrugë e ndiej vedin ma mirë, temperatura bjen, dridhjet nuk janë aq të shpeshta sa ma parë. Në rrugë ka shumë fjalë, por jo të tana janë ato që më duhen mue. Gjej *ndoj* fjalë tek tuk, dhe nisem me shkue në klubin ku gjej miqtë e mij. Miqtë janë të rrallë, kjo nuk asht edhe aq e nevojshme me u kujtue, mandej me miqtë edhe duhet me ndërrue ndoj fjalë, se nuk shkohet me takue miqtë si *nusja në dasëm*. Rrin sa rrin me miqtë dhe nisesh prapë për rrugë, *edhe pse* ethet vazhdojnë. Biblioteka asht një vend jo i keq, gjen fjalë sa të dësh, mundesh me kërkue dhe ka boll prej tyne. Libra të tanë të rreshtuem për bukuri nëpër raftë janë të mbushun me fjalë, por e ve re se as këtu nuk gjenden fjalët që kërkuj, e kam provue edhe me lexue katër pesë libra në ditë, nuk asht se ethet më kalojnë. Me fjetë në bibliotekë as më shkon ndër mend. Ndoshta pluhni i bibliotekës asht arsyeja. Ndoshta gazetata, që më krijojnë alergji.

Fjalët e grave *kajherë* bajnë dobí, por më asht mësue trupi edhe me këto. Tash jam i ngopun dhe ethet nuk e hanë ma atë tek me u *ngi* me çdo gja. Ka raste që disa lloje fjalësh më kanë ba edhe reaksion të fortë. Edhe jam helmue. E kam hjekë të zitë e ullinit me e marrë vedin. Kështu e shoh se duhet me u *hallakatë*, me vjedhë ndoj fjalë të re, jo në kuptimin e fjalorit, por që xen vend në boshllëkun e krijuem prej të folunit të gjatë. Provoj çka të mundem, veç e veç me u ndie edhe një herë normal si të tanë. E ndiej se ethet nuk po duen me mu largue *kët* herë. Po *kaq* shumë thue ta kem teprue tuj folë, sa këto drej ethesh nuk nuk po më *dahen*? Nuk duhet me folë kaq shumë! Jo, jo me folë nuk ka asgja të keqe, por *kajherë* asht mirë mos me e teprue si me alkolin. Ban dam! E shof në trup temin, me të vërtetë në fillim asht e kandshme por mandej edhe orgazma që zgjat shumë fillon e bahet e zakonshme, në fund të fundit orgazma prandaj asht e kaq e bukur se kryen shpejt.

Kësaj here e kam teprue fort. E shof se nuk kam rrugë tjetër! E di se asht shumë e rrezikshme. Por jam randë! Nuk deshta me mbërritë deri këtu, por asht e detyrueshme. Duhet me ndejë vetëm, pa folë. Krejt vetëm. Unë nuk jam edhe ndoj tip asocial, por *kajherë* ma don trupi, vjen një pikë kur ethet e fjalëve bahen të padurueshme sa më vjen me shkye ndokend në rrugë. Kështu sa me u kthye në një kriminel të zakonshëm, ndryhem. Nuk e çili gojën me më mbytë. Derisa ethet të më lëshojnë. Vetmia asht i vetmi ilaç. Asht vendi ku gjeihen fjalët. Shof se si në vetmi

flalët më vijnë e të ulen në prehër si zogj të truem. Futen kadalë nën lëkurë dhe e ndiej se si ethet më dalin *pakepak*. Nuk ka gja ma të bukur, se sa me u ndie edhe një herë normal. Mbushem mirë e mirë me këto fjalë të bukura, të mrekullueshme dhe jam gati me marrë malet. Ethet po thuej më kanë lëshue krejt. Fjalët që kanë mbetë jashtë nuk dinë çka me ba, nuk ka ma vend, shohin mirë e mirë mos ka mbetë ndoj cep ku me e futë por të tjerat janë tregue ma të shkathta. I marr në dorë e i fus ndër flokë, nëpër xhepa, ku të mundem, vendi mbushet plot e përplot me fjalë. Shkoj poshtë ndër fqinjë dhe mundohem me i rrejtë me biseda të kota, nëse fjalët xanë vend, gjithkund ndër shtëpi të huej. Hajt se kanë me ju dashtë tham me vedi. Ka kaq shumë fjalë që o Zot, pa fund. Rri pa lëvizë. I heshtun, plot me fjalë që nuk mund t'ia tham kurrkujt. Çohem në kambë dhe shof se si *boshsia* që la mbushet *mejherë*. Jam i tmerruem, aq shumë fjalë më sillen rrotull. Filloj e flas! Për një çast pamja ndalet. Fjalët më shohin me dyshim nëse isha unë, apo hyni ndoj fjalë prej jashtë. Dhe fjalët e thanuna luftojnë kundër atyne të pathanuna, më kot. Lufta asht e pabarabartë. Prej frikës ia nisi me këndue me za të naltë, por prapë s'ka asnjë dobi. Prapë e kam teprue, kam tre vjet që rri vetëm pa folë dhe fjalët e pathanuna janë të panumërta. Dal me vrap jashtë në rrugë dhe gjej njeriun e parë e i tham njëmijë fjalë përiherë, fjalët e pathanuna mbysin qytetarët e shkretë që shkojnë në punët e tyne, e më shohin të tanë si të marrë, derisa pushoj, përfundimisht, pushoj. Shof kërdrinë që asht ba në piacë si me pasë kalue ndonjë tren me shtatëqind revolucione, gjak, të plagosun që thërrasin ndihmë, një fjalokaust, një fjalëhazuen, një ditë shën Fjalomeu e jashtëzanshme, e lodhshme, e përmortshme asht shtrí ne piacë. Një varr gjigand ku fjalët vrasin si plumbat...

Jo jo, asgja nuk ka ndodhë, mos u shqetësoni kot, nuk asht krejt kështu siç jua përshkruejta unë, unë gjithmonë e teproj, po deshët hidhni sytë në piacë, asgja nuk ka ndodhë të tanë vazhdojnë të shkojnë në punët e tyne, pa asnjë shqetësim. Si gjithmonë asht thjesht mesi i verës dhe njerëzit me çadra diellit shkojnë ndër shpia të veta, e fjalët nuk duken *kurrkund*.

Ilirjana STANKAJ



SA T'VEGJËL JEMI!

Jemi njerëz të vegjël,
aq të vegjël,
sa...
për lugë na mjafton një gjethe
(nuk e di pse gjethen e ngatërrojmë ndojherë
me mendimet e vyshkuna?!);
e ushqehemi me mendime t'vyshkuna!
Jemi njerëz të vegjël,
aq të vegjël,
sa etjen e shuejmë jo rrallë
me një pikë gjak,
që s'e di pse,
duket se ngin...barqe t'pangimuna shekujsh!
Vampirë postmodernizmi...NE!

Jemi njerëz të vegjël,
aq t'vegjël,
sa...
me u shpërta na mjaftojnë dy pika loti,
mjaft që t'jenë lot dhimbjesh,
me u shpërta humbjesh
(edhe kur ato janë vlera t'humbuna),
e koha numron shpërllamjet ...

Jemi njerëz të vegjël,
aq t'vegjël,
sa ...
flejmë qetë mbi andrra fëmijësh,
strukemi në to fshehtas bote,
e bota aty nuk na gjen,
s'na dallon kur ...
kur bahemi aq të vegjël
(na njeh vetëm të mëdhenj).
Losim andrrave ...
Sa bukur!

Kështu ne,
njerëz të vegjël,
skalitemi "muresh" si piktura t'Zotit!
Ai thuhet se sheh ...

* * *

Eh! Sa bukur kemi me vdekë!
Çfarë pikturë do t'jesh ti?!

Gjysma ...

Mbi gjysmën e botës
Zbrazet terr ...
As dritë nuk derdhet mbi gjysmën tjetër ...
Nji gjysëm-shpirtit njeriun merr,
Si rrob'n e vjetër ...

Me gjysm'n e shpirtit
Njeriu vuen ...
Nuk gjen dot strehë askush te dhimbja ...
Me qiell e shenjtën qeshet e luen,
Nji pjesë e imja ...

Mbi gjysmën teme
Kam var' nji shpresë ...
Dhimbjen luftoj me gjysmën tjetër ...
Gjysma e shpirtit bulon si vesë,
Plagën e vjetër ...

Me gjysmën tande ti po m'lexon,
Ndoshta m'gjykon me gjysmën tjetër ...
Si Nostradamus mbi natë kalon,
Shtron t'ardhmen n'letër ...

Dheut

Dy grushta dheu,
ia shkula tokës,
prej gjoksit...
Nji vend, thashë,
nji vend, thashë po ia baj,
në prehën tem!

Prehnit, si fëmijë i vogël,
m'u bâ se m'shihte dheu,
diçka donte me m'thanë,
s'po zinte vend!

Gjysmën e ditës,
me dheun kuvendova,
m'kallzoi gjithçka,
gjithçka që mbante mend!

Qante si fëmijë,
për plagët që i kish hapë dora,
m'u dhimbs, e lëshova,
se dheu s'gjen prehnit vend!

Sa iu shtru tokës,
do fjalë m'postoi prej shendit,
i vara n'vesh,
si vathë t'i kem përditë:
"Çka ke ma t'shtrenjtë,
kurrë mos ia beso prehnit,
gjanave t'shtrejta,
vendi u bahet n'shpirit"!

* * *

E në u plastë shpirti,
prej qiellit që mbart brenda,
do burojnë jashtë gjithë yjet,
që ngjajnë me mua e ty,
ndoshta...
dhe Dielli ka me dalë,
siç del prej syshë E Mira,
veç...
kurrë s'del shpirtit Shpresa
që mban krejt qiellin n'sy ...

Rozafa SHPUZA



Kthim

Në shpinë e vjetër
m'pret oborri
rrethue me mure t'nalta
mbulue me shermashekë
t'pastinë,
zbardhë prej luleborash naziqe
që nusërojnë në qoshe.
Grilat,
mpi prej shirash t'mërzitshëm
hapin krahët e pluhnosun
prej ernash t'hirta.

Shkallat,
lodhun prej hapash t'fikun
përkundin parmakët
e limuem
prej prekjesh t'harrueme
e sytë andërr-thyem t'fotografive
në muret e plasaritun
lotojnë prej mallit...

Rozafës

Ndër kambë të blerta
ujnash që vorbullojnë
frikshëm
e ngutshë vërshojnë
për kushedi se ku.
Ndër rrjeta t'imta peshatarësh
që hidhen ambëlsisht
e mblidhen ethshëm në lundrën
që përkundet valësh.
Naltohen
do mure t'moçme
blatue me tamël shekullor
që pikon pa prâ
prej gjinjsh të ngurosun
ndër legjenda.

Truma e Dugajve t'Reja

Pikon mirazhesh t'harrueme
n'pluhnin e kujtimeve,
kur currilat përmallin
nji sy gjygyimi,
e dugajt e stivueme
nën tjegullat e moçme
t'sajdisin me flirte
qepenash.

Nadja ulet ngeshëm
në nji kafe të vlueme,
grilat hapin krahët
tue rrokë parvaze
karajfilash
e qielli zbardhet vrithi
ndër krahë pëllumbash...

EDICIONI VII, VITI 2014Zija **VUKAJ****I FUNDMI I DISIDENTËVE.
PËR SKËNDER DRININ (JO REQUIEM)**

Duket pak paradoksale ekzistenca e disidentëve në ditët e sotme, gati dy dekada e gjysmë pas shembjes së murit të Berlinit, por këtu nuk ka asgjë figurative. Jemi në vazhden e çudirave dhe paradokseve që realiteti ynë vazhdon të prodhojë dhe këmbëngul t'i kalçifikojë deri në pafundësi me kokëfortësinë e vet absurde, a thua se do t'i përdorë si mjete konkretizimi për brezat që nuk kanë pasur rastin ta njohin fenomenin e disidencës. Dhe viktima e kësaj praktike është pjesë e realitetit tonë të përditshëm.

Jeton me ne, ecën përditë rrugëve të qytetit të Shkodrës, i zhytur në indiferencën dhe në mospërfilljen e vet “olimpike”, me një dinjitet që i kalon caqet e së zakonshmes, si për të na theksuar me qëndrimin e tij keqardhjen për padijeninë tonë të qëllimshme e njëkohëzisht djallëzore dhe mëkatore. Ky individ gati i vetmuar, është shkrimtari Skënder Drini, për të cilin lexuesit seriozë të letërsisë shqiptare dinë shumëçka.

Ai është një nga prozatorët më të veçantë dhe një nga zërat më origjinalë të letërsisë sonë.

Autor që e ka shtrirë veprimtarinë e tij krijuese në dy epoka. Në periudhën e socrealizmit krijimtaria e tij ka kulminacionet e veta, siç janë romanet “Vraje tradhtinë”, “Shqipja e kreshtave tona”, “Shembja e idhujve”, “Midis dy kohëve”, “Bajram Curri”, “Rruga e njeriut”, “Kirurgët”, “Njerëzit dhe deti” etj., vëllimet me tregime: “Tregimet e së shtunës”, “Tregimet e veriut”, “Kompania e katërt” (tregime për fëmijë, disa prej të cilave janë përdorur si librete filmash) etj. Pas viteve ’90 autori ka botuar romanet: “Eklipsi i hënës”, “Ishulli i qetë”, “Nata është grua”, “Korbi”, “Parajsa e gjenive”, “Planeti i lodhur” etj., disa vëllime me tregime ndër të cilët spikat “Klas”, libri mjaft interesant me aforizma “Përballje” dhe dy vëllime me shkrime publicistike. (Këto që u përmendën janë vetëm një e treta e krijimtarisë së tij). Vepra e tij ngërthen në vetvete një gamë të gjerë tematikash e motivesh, që kanë lidhje me njeriun e kohës, por edhe me individë dhe ngjarje historike, që përbëjnë elemente kombëtare nga më emblematiket. Siç ka ndodhur edhe me bashkëkohësit e tij, Agolli, Kadare, Xoxe, Arapi etj., etj., në krijimtarinë e tij natyrshëm gjejmë gjurmë të metodës së realizmit socialist. Por në veprat që cituam më lart ka pak të tilla, ose aspak, sidomos në romanet historike, të shkruara me një mjeshtëri të rrallë, që kanë ardhur si produkt i hulumtimeve të gjata në anale historike, i shfletimit të dyzinave libra në gjuhë të ndryshme dhe falë vëzhgimeve të thella në karakteret e personave historike të kthyer në personazhe, falë përshkrimeve plot jetë e kolorit të ngjarjeve dhe skenave masive, falë aftësisë për të depërtuar në shpirtrat dhe karakteret njerëzore dhe fantazisë, por edhe informacionit për të sjellë para lexuesit frymën dhe atmosferën e kohëve të largëta, duke mbajtur në ekuilibër të mahnitshëm faktin me trillimin. Nga gjithë këto, ka krijuar modele fundamentale të këtij zhanri në letërsinë shqipe, që rrinë me dinjitet përkrah veprave të Godos, Kadaresë etj. Romanet e shkruara pas viteve ’90, jo vetëm kanë konfirmuar përmasat ekzistuese të një romancierit të elitës sonë, por kanë ridimensionuar vlerat e opusit tonë letrar kombëtar. Këto vepra, me motivet, filozodinë që i përshkon, teknikat letrare dhe procedimet artistike janë arritje të një letërsie moderne, që ka në fokus individë dhe fenomene universale. Drini është nga autorët me një erudicion të rrallë, një mjeshtër nga më të shquarit e dialogut, përshkrimit, meditimit dhe digresioneve. Vëzhgues dhe zbulues i *underground* -ve të jetës njerëzore dhe shpirtit të personazheve, të dramave ekzistenciale të individit dhe të shoqërisë, veprat e tij provokojnë thellë intelektin dhe shpirtin e

ndjeshëm të çdo lexuesi.

Vepra që atij i sollli mallkimin, mallkim që po e ndjek nga pas edhe sot e kësaj dite, është romani “Shembja e idhujve”. Kaq i terrorizuar është autori nga kjo “krijesë e mallkuar”, sa pothuajse nuk e përmend fare, edhe pse ai dhe të gjithë e dinë që është një mga katër – pesë romanet më të mira të letërsisë shqiptare. Lukunia e komshinjve të letërsisë iu vërsul atij në anatemime të egra ekstraletrare, më zi se autorit të “Vargjeve satanike”. Ndëshkimi që iu bë, është “harresa”. Sepse morali i komshinjve të letërsisë është i kulluar dhe mjaft i kujdesshëm. Dhe kujdestarët e këtij lloj morali janë kujdesur me devocion e përkushtim jashtëletrar që t’i tregojnë vendin këtij heretiku dhe deri tani ia kanë dalë. Kanë realizuar braktisjen dhe humbjen e vëmendjes së njeriut, që u ngjan heronjve të vet dhe që nuk është si ekzekutorët e tij. Pragmatistëve nuk u pëlqejnë modelet njerëzore. Ata nuk kanë kohë të jenë të ndjeshëm dhe intelektualin e vërtetë nuk e honepsin dot. Sepse, duke mos e gjetur tek vetja, nuk e kanë takuar kurrë. “Le të rrijë ai aty ku e kemi hedhur.” Dhe nëse ndokush e përmend, mallkuar qoftë bashkë me të. Dikush guxoi ta nominonte për një titull “modest” “*Qytetar Nderi*”. Them modest në thonjëza, sepse e kanë kthyer në modest, duke ua dhënë jo vetëm individëve të zakonshëm shqiptarë, por edhe çdo sharlatani të huaj dhe pjesa më e madhe e korit të votuesve në komisionin e titujve e refuzoi. Fali, o Zot për këtë bindjen e tyre *en bloc*, që buron nga një devocion popullor i keqorientuar. Dhe kur kujtojmë se çfarë vendimesh antinjerëzore, antiqytetare, antihistorike, antilogjike dhe antihumane kanë pasur guximin të marrin komisionet e qeverisjes vendore. Po sa të kujdesshëm dhe “koprracë” në votimin e një titulli për një njeri të merituar, kur këtë titull ua kanë dhënë edhe samarxhinjve (edhe ata të respektuar).

Më vjen në mendje një dialog me mikun tim, të ndjerin Paulin Selimi, kur po më pyste:

-Sa vetë e kanë marrë titullin “Krenaria e qytetit?”

-Më duket se shumë.

- Sa, shumë? – këmbënguli ai.

- Po, them se dhjetëra, mbase edhe qindra.

- Gabim.

- Pse?

- Duhet t’ua japim të gjithëve. Të hapet një zyrë që të ketë një sportel, t’i thërrasë të gjithë qytetarët me rradhë dhe t’ia dorëzojë secilit titullin

“Krenaria e qytetit”.

- Po me ç’motiv?

- Me motivin “I qetë dhe korrekt”

Pas këtij dialogu, shikoj çdo minutë rrugët e qytetit tim të mbushura me “Qytetarë nderi”.

Duke kaluar nga sekuenca e humorit që më ngjalli kujtimi i mikut tim të vjetër, mendoj se

margjinalizmi i një artisti me përmasa të padiskutueshme kombëtare, si Skënder Drini mund të bëhet vetëm për dy arsye: e para, nga mosnjohja e veprës së tij; dhe padijenja nuk është argument dhe, e dyta, nga presioni i komshinjve të letërsisë, që janë gati të promovojnë para tij çdo figurë minore, qoftë edhe duke e kërkuar nëpër sepetet e mykura të periferisë së letërsisë sonë të traditës apo edhe moderne. Por, cilat janë kriteret që janë përdorur për autorët e futur në antologjitë shkollore, që ky shkrimtar nuk i plotëson? Ai mund të futet si mjeshtër i tregimit, i romanit historik, i romanit modern shqiptar, i publicistikës etj. Së fundi, me sa duket, jo çdo e keqe vjen për keq. Ai po “gëzon”, pa dashjen e tij atributin e desidentit modern. Dhe për këtë duhet t’u jetë mirënjohës komshinjve të letërsisë.

Asllan **BISHA**

NUSJA

(Nga vëllimi “Dritaren lëre hapur”)



E enjtja e vjeshtës së parë në qytetin e Ulqinit ishte përcëlluese. Gjethet e fiqve, portokajve dhe shegave gati nuk fërfërinin, megjithëse nga deti vinte një puhizë e hollë maistrali. Dielli dukej se ishte lëvarur mbi kepin e Sukës dhe nuk lëvizte, por digjte si furrë rrugët e ngushta të Kalasë.

Në shtëpinë dykatëshe të Lejlasë që kundronte me shekuj kaltrinë e detit dhe zgjohej nga gjumi me krrokamën e pulëbardhës, të enjtën erdhën dasmorët. Plaka bënte dasmë. I ishin skuqur faqet e vyshkura dhe i ishin shlyer vrragët e pleqërisë. Një hir ngazëllues kishte kishte shpërthyer në qënien e saj. Ajo para derës priste mikeshat e Kalasë që u prinin ngadalë nuseve të rënduara me florin, inxhi dhe unaza. Dukej se të gjitha stolitë i ruanin për dasmë dhe kjo e gëzonte edhe më shumë plakën Lejla. Nga sytë e saj të vegjël përvindheshin pikla lotësh gëzimi nën tendën e vogël ku kundërmonin trëndafilët, alberoizat, kaliperët, rucët e rastapacët që e kalojnë edhe dimrin pa u vyshkur.

Në oborr buçiste kënga e përcjellë me tingujt të violinës e dy dajreve. Meloditë ndërroheshin herëpashere nga zërat e dasmorëve. Kënga dëgjohej edhe jashtë Kalasë, në Ranë, në Bashbylyk dhe humbte dikund në kaltrinën e paskajshme të detit.

Në vlogën e gëzimit violinistit iu këput teli. Dajrexhinjtë e hetuan me vonesë çrregullimin. Ky pushim i papritur ishte i mirëseardhur për

plakën Lejla. Ajo iu drejtua dasmorëve:

-O miq, sot më sillni në shtëpinë time gëzimin më të madh, nusen nga Shkodra. E prita gjatë këtë ditë. Martoj Skënderin, detarin e nanës....

-T'u mbushtë shtëpia me nipa e mbesa! U trashëgofshin! – uronin dasmorët.

Pas pak, kënga jehoi përsëri. Dasmoret dhe dasmorët hodhën valle deri te bedeni i Nunit edhe kur "Kalaja" mori drejtimin e gurit të Gjeranave për të lundruar buzë brigjeve të Bunës, për në Shkodër.

Nënë e bir pritnin. Plaka nga gëzimi, ndërsa i biri rrinte në divan si i shqetësuar, herë vështronte turmën në molo dhe anijen që lundronte t'i sjellë gëzimin.

-Ç'ke të pastë nana? Pse rri i menduar?

Ai buzëqeshi, por ca ndjenja të çudishme i erdhën papritur detarit. Ata sikur i thoshin: "Gëzimet e detarit janë të shkurtëra moj nënë. Sa njih dikë kapiteni çon spirancen dhe mbetesh si peshku në zall. Çdo gjë të ikë, përveç ca kujtime si thërmi që s'të lënë të qeta dhe të sillen në kokë e të përcjellin si hije. I rrëfen ngjarjen shokut sa e sa herë. Ti fillon, ndërsa ai vazhdon rrëfimin.

Atëherë buzëqesh ai dhe ti, ndërsa bashi çan ujërat. E ty s'të mbetet tjetër përveç këngës: "Eja, eja s'mund të pres, jam e re e s'du të vdes..." S'bën të thellohem sot në mendime. Mirë e ka nëna, njëherë martohet njeriu,- mendonte Sënderi në këto çaste dhe fliste me unin e tij: "Më mirë ishte të parafytyrojë Nusen, të cilën e kishte parë vetëm një herë në Shkodër kur ishte fëmijë bile edhe kishin luajtur bashkë. Tezja i kishte folur shumë për të.

Anija s'dukej askund, prandaj ai shkoi te sofraxhinjtë që përgatitnin mezet për dasmorët dhe miqtë shkodranë. Fëmijë nga bedenat kundronin anijen sikur edhe vajzat kureshtarë e nuset e Kalasë pritnin me padurim.

Kur dielli, si një lëmsh i kuq, po futej në ujë, fëmijët brohoritnin: "Nusjaaa! "Nusjaaa!"

Syprina u përskuq. Kalaja trumbetonte nga rrëmuja dhe kënga, ndërsa Nusja me hapa të vegjël dhe plot elegance ngjitej shkallëve të Kalasë. Era e mbrëmjes i ledhatonte flokët e gjata, mbi ballë vezullonin floringjtë, ndërsa mbi gjoksin e gufuar shndritnin ixhitë.

Gratë pëshpëritnin: - Qenka perri! Shkodrane moj loce! Taman Shkodrane...

Plaka Lejla qante me lotë duke i lyerë dorën me mjaltë, ndërsa kënga buçiste. Ajo zgjati deri në mëngjes. Të gjithë pritnin të pushonin, si

mjeshtë Aliu dhe dajrexhinjtë.

Nusja u lodh shumë, - tha tezja. Të gjithë duhet të flejmë. Tezen e zuri gjumi me të shpejtë dhe si me saze po gërhiste. Pas pak fjeti edhe vjehrra. Nusja hapi qepallat e buta dhe fshehtas çeli syrin për të parë burrin. Shikimet u kryqëzuan. Ajo u befasua, sepse as Skënderi s'kishte fjetur. Nusja mendottedhe tash vështronte tavanin e skalitur me lule dhe anijet: veloret ulqinake në mur.

Gjumi i kishte ikur nga syri i saj. Ajo e lypte, por ai e gllabëroi kur rrezja e diellit puthi Kalanë.

Në drekë askush s'kishte apetit as fqinjë as dasmorët. Të gjithë prisnin natën me padurim.

Skënderit i dukej dita e gjatë, ndërsa dielli kishte mbetur mbi kepin e Madh dhe s'lëvizte fare.

Në mbrëmje shkuan në dhomë për të fjetur. Nuk di sa fjetën?

U zgjuan vonë me sy të enjtur dhe të dy ishin të përgjumshëm. Shikimet flisnin, ndërsa miqtë e mikeshat uronin çiftin e ri.

Në mesditë postieri solli telegramin, në të cilin shkruante: *“Anija Ulqini me 10 shtator niset në lundrim...Eja! Kapiten Liti”*.

Detari duke lexuar dridhej, si vala e detit dhe u mërrol si reja mbi Valdanos. Plaka e vërejtë shqetësimin e të birit dhe e pyeti:

- Ç'është?
- Lundrojmë.
- Kur?
- Pasnesër!
- Auuu! Sa keq.

Nëna e përcolli të birin në Molon e Kalasë. Ajo vështronte tërë habi për qafimin e tyre, lotët. Edhe nusja deshi të qajë në këto çaste, por i vinte turp nga turma. Kur i dha dorën i shoqi u dridh i tëri, ndërsa nusja shtrëngoi pëllëmbën e tij të fortë sikur donte t'i thotë: “Mos u merakos, unë të pres. Na qëlloj keq. Por, do të kënaqemi...”

Anija duke trumbetuar përshëndeste ulqinakët në Molo, ndërsa detarët bënin me dorë derisa shikimet e të dy palëve tretnin në det dhe s'kishin fare domethënie.

Anija s'dukej më, ndërsa vjehërra i priu nuses për në shtëpi.

Për një javë nusja pa në det dhjetë anije, por asnjëra s'u afrua Molos së Ulqinit.

Ishte pasdite. Nusja po pastronte dhomën. Zëri i burisë binte pa rreshtur. Ajo la fshisën dhe doli në ballkon. U gëzua kur vërtetoi se

buria vinte nga deti. Zbriti me nxitim shkallëve pë t' i lajmëruar sihariqin vjehrrës dhe tha:

- Nënë erdhi anija.

Plaka e vërejtë shqetësimin e nuses dhe me zë të butë, duke u ruajtur befasisë, tha:

“Ulqini” s’kthehet tash. Ai tash lundron në oqean. Sigurisht se është ndonjë detar ulqinak që përshëndet vendlindjen. Është përmalluar, ai përshëndet të gjithë, posaçërisht familjet detare...

Nusja e skuqur si gaforre, e zënë në befasi, mori guxim dhe pyeti vjehrrën se kur kthehet Skënderi?

-Eh, moj nuse, burri im kthehej nga deti pas gjashtë vjetësh.

-Si?- foli nusja e ngurruar.

-Pas gjashtë vjetësh e më shumë,- fliste plaka ngadalë..., kurse tash shyqyr zotit detarët kthehen pas një viti, e më shumë dy vjetë..., -sqaronte plaka.

Nusja deshi të flasë, por habia, befasia dhe turpi si dhe naiviteti i saj s’e lanë të hapë gojën. Ca mornica rrëqethëse i kapluan trupin, i turbulluan shpirtin. Një vello ftohtësie e gllabëroi. Plaka e vërejtë këtë, por këto çaste mendoj dhe tha; “S’vlen të them asgjë. i qëlloi keq djalit. U rranoftë deti. Eh deti-gametiii...”.

-Hajde moj bijë. Do të mësohesh. Viti i parë është i rëndë, pastaj numëron ditët dhe qe burri. Të sjellë pasuri. Puna e detarit kështu, moj nuse. Por paraja te detari dhe tregtari rri.

Nusja uli kokën. U vrenjtë si reja mbi Tarabosh. Shkoi në dhomën e saj. U plandos mbi shtrat. Lotët i shkonin rrëke. Hapi dritaren dhe të parën herë në jetën e saj mallkoi kaltrinë detare dhe me inat vështroi valët që nxitonin një nxitonin njëra pas tjetrës. Me hapa të ngadaltë iu afrua pasqyrës ku ishte fotografia e burrit. Sytë e tij të zinj e shikonin dhimbshëm si dy yje mbi Kala. E puthi me afsh, e futi në gji, por ndjeu ftohtësi të madhe. Ajo herë e shikonte afër e më afër fotografinë, ndërsa vjeshta e vonë dhe krrokama e pulëbardhave te Guri i Madh e shqetësonin edhe më shumë. Grilat rropateshin.

“Unë dua të bëj diçka? S’mund të rri. Jo, si të pres. “Paraja te detari është’, thotë vjehërra. Ç’më duhet paraja? Asgjë s’dua. Të gjitha këto verdhake do t’i jepja për Skënderin. Ç’më bëre moj nënë? Pse më dhe more baba në Ulqin? Këtu këndojnë pulëbardhat. Oh, s’ka pa Shkodër, pa Parrucë. E Buna e Kalaja jonë, - fliste nusja me qenien e saj. Dua të gëzoj nusërinë. Oh, ç’të bëra o perëndi?! - lutej e qante nusja dhe nuk

dinte si të veprojnë. I lutej zotit, ndërsa kulla e Lejlasë i zinte frymën. “Më duhet të ik nga kjo kështjellë me gurë dhe bedena. Unë kujtova se deti është si liqeni ynë. Shkojnë njerëzit e peshkojnë, lundërojnë dy tri ditë, më shumë një javë. Ah Liqen”!...

Veç llamba me vajguri atë natë i dëgjoi dhe i kuptoi fjalët e nuses. Ajo vezulloi deri në mëngjes. Mbeti e pafikur. Shkodranja me sy të përlotur dhe duke nxituar tatpjetës së Kalasë la shtëpinë e burrit dhe vjehrrën.

Kur arriti te qafa e Kalabrezit, vështroi edhe një herë Kalanë, por ajo s’dukej. Qau padashje, por lotët i dhanë disi më shumë kurajo për të shpejtuar hapin drejt fushës së butë të Zogajve. Rrezet e përflakura i ledhatuan faqen dhe i uruan mirëmëngjes, ndërsa nga deti bashkat e reve të mjegullës ishin qepur pllajave.

Pas dy orësh nusja mbërriti në brigjet e gërryera të Bunës.

Shpërlau fytyrën me ujë të lumit dhe iu duk se vendlindjen e kishte një bërçik. U përpoq të gjejë Rozafën, por ajo s’dukej gjëkund.

Sa shtegtonte përpjet Bunës fytyra e Skënderit i delte përpara. Ajo nxorri fotografinë: “Më fal o burrë, o detar nëse je burrë. Unë të dua po ku të marr. Mos më qorto. Do të thuash: -Shkodranja e pa besë. Ç’më bëre moj teze. Pse më lidhe me të. S’të kam faj kupto. Si të duash..., - fliste me unin e saj nusja dhe diçka e tmerrshme i vriste shpirtin.

Mbi lumë dy lejlekë fluturonin shumë afër njëri-tjetrit. Nusja në ato çaste dëshironte të ishte edhe ajo lejlek, por jo nuse e detarit.

Në mbrëmje kur dielli iku nga kreshta e Rumisë, nusja arriti te Kalaja e Shkodrës. Ishte e molisur nga rruga. Sytë ishin enjtur, kurse fytyra ishte mbushur me pluhur. Parruca iu duk si dhe çatia e shtëpisë. Shpërtheu papritmas në vaj.

Kur e pa e ëma briti si në ankth:

- Ç’më shohin sytë?! Ç’të gjeti bijë?!

- Ika.

- Vjehrra?

- Burri, nanë dee-tar-r-r.

- Të rrahu ulqinakuuu?

- Jo, nanë, por...

- Fol, moj, se ma bane gjakun ujë!

- Eh, moj nanë. Ulqinak, burrë aspak. Iku në det më la.

Nënë e bijë qanin, ndërsa nata lëshohej ngadalë mbi Shkodër.

Dashamir **CACAJ**



Dekor me kolor

Me gishta prej mjegulle
Delmerja e siti ditën,
Unë habitem edhe sot
Si nuk e nëmi sitën!

Shtigjet janë fisnikë
Shportat plot me fruta,
Koha struket prej lodhjes
Matanë kodrinave të buta.

Unë e ti, me kupa të mëdha
E pijmë sit ë ishte lëng pjeshke,
Këtë dekor me kolor
Trazuar me mjaltë vjeshte.

Dhe i them La Fontenit
Pjergulla po pikon...
Të lutem thuaj dhelprës
-Ti veç mashtron!

Anipse

-Pohim në vetë të parë i Tatjana Fortuzit!-

Anipse haptas dal me Ty
E ndjej magjinë e flijimit,
Në rrahjet e zemrës ndoshta
Kur bien në kurthin e ngujimit.

Anipse pa drojë më puth
Në buzë, gushë a diku tjetër,
Spazmat e shpirtit bien në ujdi
Me akordin e një ëndrre të vjetër.

Anipse hiret e shtatit tim
Përfshij buzët, cicat, shalët...
Të tuat janë ndaj lodro me to
Ashtu siç lodron bregu me valët.

Anipse etja tund vithet
Në shilarësin e kënaqësive pa fre,
Pejëzat e hoveve të mia notojnë
Në hirin e magmës përmbi re!

I kam marrë inat ikjet

Djemtë rrallohen përditë
Atje ku krojet buzët e plasura i kanë,
Siç bëhen të rrallë yjet
Në heshtimin e qiejve të paanë.

Ikjet i kam marrë inat
Këtë hutim ti ma lexon në retinë,
Qyshkur gjethja e fujndme u rrëzua tepër vonë
E makthi i delirit ma gjeti shtëpinë.

Ikja e djemve për larg
Një Gur Sizifi mbetet dhe për ty,
Për sa kohë si një vuv pozon,
Një dimër idiot si ky!

Mbi thepat e përm gris bluzën gjelbërimi
Rrisku i ditës mbetet në dietë...
Ne të dy nuk e dimë sa kohë gjogu i ikjeve
Stekën e mban vetëm përpjetë.

Sytë e vajzave errësohen nga ikjet
Në hije shndërrohen djemtë e katundit,
Komedia e rëdhës në mos dhëntë shpirt
Të printojë të paktën puntatën e fundit.

Tonin ÇOBANI

ËSHTË GRUA



Mësuesi i letërsisë, me çantën e ngarkuar me hartime e asaj dite, doli nga shkolla i fundit. Pak i kërrusur përpara dhe me kokë të ulur, ai nuk vuri re se dikush po e priste për ta përshëndetur. U përmend vetëm kur dëgjoji se po e thërrisnin me emër. Nga lodhja nuk e shquajti menjëherë personin që iu afrua me ndrojtje.

- O, më fal! S'të vura re fare. Qenke bërë e hijshme... Me fëmijë?

- Po, profesor. Kam dy. Të madhin në shkollë, të voglin në kopësht.

- Të paskan zbukuruar, - tha nëpër mend solli ish-nxënësen e tij çapkëne me vështrim romantik, që ndoshta, ishte i vetmi që ia kishte venë re. I erdhi keq që atëherë nuk e kishte përfytyruar si grua. Si do t'i ketë shkuar jeta? - mendoi me vetën e tij. Sa me ndjenjë i shkruante hartimet! Në dorëshkrimet e veta ruante disa poezi të saj, që ia kishte dhënë në mbrëmjen e fundit të matures, me një mënyrë të pazakontë, gati si dhuratë. Sa herë i lexonte ndiente mall për çapkënen romantike.

- I ruaj disa poezi tuat, - vazhdoi me një zë të emocionuar.
 - Edhe sot ju kam sjellë një si tregim, profesor... Shkruaj sa herë nuk kam me ke të komunikoj shpirtërisht. Sot u frymëzova nga tema e juaj e hartimit, që e mora vesh rastësisht: Një ngjarje që s'më lë të qetë.
 - Fliste pa e parë më në sy dhe i zgjati disa fletë format të palosura me kujdes.

- Mos më gjykoni keq! - vazhdoi ajo dhe e pau në sy si atëherë, në atë mbrëmje maturës. - Kushdo e ka një ngjarje të vetën, që se lë të qetë. Ndoshta nuk do isha ulur për ta shkruar ndonjëherë. Vetëm për ju e bëra. Nuk do të më gjykoni keq! Fundja unë jam një grua.

Mësuesi u turbullua nga ato fjalë. Në vështrimin e tij nuk ishte më çapkënia, sytë romantikë, por buzëqeshja joshëse e një gruaje të vërtetë, me ëmbëlsinë dhe misterin femror, që rrallë dhurohet. Kjo e turbulloi edhe më shumë dhe shtangu pa ditur ç'të thoshte. Kur u përmend, ndjeu se po sodiste hijen e një gruaje, të dalë nga ëndrrat e tij të harruara. Ndiante tërheqje prej saj, sa më tepër largohej, por s'bënte dot asnjë lëvizje.

U kujtua se në dorë kishte diçka nga ajo grua dhe filloi menjëherë leximin.

Gjithçka, që dua t'ju tregoj, ndodhi në një ditë kur unë ndihesha e çorientuar. Që ta kuptoni më mirë gjendjen time, përfytyroni një njeri që hipën për herë të parë në një anije kozmike.

Ndihesha në një vakum. Një zbrazëti, aty ku duhej të ishte stomaku, rrahje të forta e të shpeshta të zemrës, një dridhje e lehtë e herëpashershme e duarve, më bënë të parandieja se atë ditë do të ndodhte diçka.

Sigurisht, nuk ishte hera e parë që ndihesha kështu. Në çdo njerën prej ditëve të tjera kisha përjetuar diçka në ekstremin e vet. Koshiente për këtë, gati i paraprija vetë asaj diçkaje që më ndodhte.

Edhe atë ditë, ndërsa bëhesha gati të shkoja te shoqja ime e ngushtë, Debora, në një orë të cilën e kishim lënë më parë, provova gati të gjithë garderobën time, gjë të cilën e bëja vetëm kur ndihesha ngusht, e gozhduar nga një dashuri e re. Më në fund vendosa të vesh një fustan, minifund i të cilit lejonte të dukeshin kofshët e mia të mbushura, ndërsa dekolteja zbulonte një pjesë nga masa e fryrë dhe e kërcyer e gjoksit. Nuk provova asnjë nga bizhuteritë. Flokët i ngrita të gjitha përpjetë

duke lëshuar disa kaçurrela në ballë e mbi veshë.

Debora, si gjithmonë në orët e takimeve që linim, ishte vetëm. Kështu kënaqeshim më shumë. Ajo po shikonde një videokasetë.

- Debora! - i tërhoqa vëmendjen për t'u bërë e pranishme te ajo, më shumë ngaqë nuk i duroja dot sekuencat e atij filmi me homoseks. Lakuriqësia e atyre femrave, që ushtronin lezbizëm, më ngjalli neveri në çast.

- Ledi! Gati harrova për ardhjen tënde. - më tha pa e hequr vështrimin nga ekrani.

Mora pultin dhe e fika televizorin. Ajo u kthye nga unë. Sytë i ishin zmadhuar dhe ndihej e përhumbur.

- Sa e bukur dhe joshëse qenke bërë sot! Ke lënë ndonjë takim?

Debora nuk priti të merrte përgjigjen time. Ndezi përsëri vidion dhe u shushat në të.

E harrova krejt emocionin që përjetova para ardhjes te Debra, edhe parandjenjën se do të më ndodhte diçka. Ndihesha e acaruar, e cimbrisur në nerva nga reagimet e Deborës përballë ekranit. Vura re se asaj kishte filluar t'i shpeshtohej frymëmarrja. S'durova dot më. Fika edhe një herë monitorin; e ngrita Debrën peshë para krahëve të mi dhe e përplasa para vetës duke e shkundur për supesh.

- Ti s'mund të kënaqesh duke parë ato!

Ajo filloi të qeshte. M'i hoqi duart nga supet e saj dhe u ul në kolltuk duke më ftuar të ulesa edhe unë pranë saj.

U ula ku më tha pa më lënë zëmërimi. Debra filloi të përdridhte kaçurrelat e mi të mbetur pa u mbledhur.

- Ledi, - më foli me atë zërin e saj tërësisht femëror, - të dyja ndihemi të përkëdhelura nga seksei tjetër. Sa shumë tërhiqemi prej tij, sa shumë kënaqemi me të! Do të doja të ndieja një herë, një herë të vetme, kënaqësinë që mund të më japë një tjetër, një seksit tim. Kjo s'është çmenduri. Është thjeshtë një dëshirë, një kureshtje që mua më josh.

Fillova t'i trembëm Debrës. Sytë e aj mbi kofshët e mia më bënë që instiktivisht të vë duart në lëvizje për të ulur fustanin, që për drej ishte aq i shkurtë.

Ajo nisi të qeshte përsëri.

- Sa kohë kemi që njihemi, - më pyeti seriozisht.

- Më duket se që në klasë të parë, - ia ktheva pa i përcaktuar vitet.

- Po, kemi qënë vazhdimisht në një bankë. Mësonim dhe shpesh

hanim vetëm bashkë. Bashkë mësuam notin, mësuam të kërcejmë, kënduam e recituam.

Po prisja me padurim ku donte të dilte me shpresë se e kishte harruar një fakt që s'doja kurrësesi të ma kujtonte në atë cast, ndonëse shpesh kishim qeshur të shpenguara me të.

- Bile, së bashku kemi shkuar edhe në takimet tona të para. Lakuriqësinë tonë asnjë herë s'ia kemi fshehur njëra-tjetrës. Sa herë kemi admiruar apo venë në lojë njëerën apo tjetrën linjë tonën. Dhe, duhet të kujtosh, puthjen e parë e shkëmbyem pikërisht bashkë duke u munduar të imitonim Alen Delon me partneren e tij në një kopertinë reviste.

Tashmë nuk arrita të qesh me këtë fakt.

- Ne, - vazhdonte Debra e pamëshirshme, - i mbanim buzët mbyllur dhe kishim afruar vetëm kokat me njëra-tjetrën. Ti u kujtove, se buzët duhet të hapeshin e trupat tonë të bashkoheshin... Mos më thuaj se ishte thjesht një lojë fëmijësh! Ne u kënaqëm.

- Debra! - thirra, pa mundur si ta kundërshtoj tjetër.

- Pse të mos kënaqemi edhe tani, Ledi?

Dora e saj, që rrëshqiti nga masa e fryer dhe kërcitur e gjoksit që kishte mbetur zbuluar nga dekolteja, më bëri të dridheshja e të kujtoja të njëjtën dridhje, vite të tëra të shkuara, kur buzët tona u hapen për të mësuar një sekret, për të ndier një kënaqësi.

U ndjeva për herë të parë brenda asaj dite vërtetë e çorientuar, në vakum, tamam si ai njeriu, që ndien boshllëkun e shkëputjes së parë nga toka kur nis një fluturim. Më duket se unë vetë afrova buzët e mia te ato të Debrës dhe i lashë të hapeshin. Po, unë vetë desha të ndiej zhveshjen nga duart e saj. E paduruar zhvesha atë trup, lakuriq e të cilit e njihja.

Dhe... O Zot, provuam një kënaqësi që s'e kishim provuar kurrë. E ëmbël për sa zgjati, rrënoqethëse në masën e saj, triumfuese mbi të tjerat.

- Kaq ishte, - tha Debra pa më parë në sy.

- Ndiej një pështirosje, - thashë.

- Unë aty afër. Shkojmë të lahem!

Nëse çdo gjë deri atë ditë e kisha përjetuar në ekstremim e vet, përjetim që akoma s'po më lëshon, i ngjarjes së asaj dite, është shumë përtej një ekstremi. Vakumi në të cilin lëviz parreshtur, këtë herë s'më bën të mendoj se do të më ndodh diçka. Para syve ajo ditë më del e shfytyruar. Sa herë ndihem e vetmuar, mendoj: ndoshta s'duhej të

ndodhte kurrësesi.

Mësuesi instiktivisht i palosi fletët dhe i futi në xhepin e brendshëm të xhakëtës. U kujtova se kishte shtangur në mes të oborrit të shkollës dhe nisi të ecë.

Lezbizëm, tha me vete. Gjithminë e kishte paragjykuar si degjenerim të rracës njerëzore. Por u kujtua se, sa herë kishte kometuar poezitë e Safosë, asnjë fjalë nuk kishte thënë kundër lezbizmit të saj.

Poezia e Safosë ishte modeli i përkryer i ndjenjës femërore. Më këtë gjykim përfytyroi edhe ish-nxënësen e tij dhe ndjeu një si dëshirë për ato pjesë të trupit të saj, të eksituara, që përshkruheshin në tregim.

Lezbizëm, masturbim apo...

Disi turbullt i vinte një zë si “unë jam grua... grua”. Ndaloj në vend si të kishte zbuluar një të fshehtë që e kërkonte prej vitesh. U kthye papritmas, me një pamje të lumturuar, thua se po shkonte në një takim të ëndërruar, por u fut në kafenenë më të afërt dhe porositi një dopjo ponç portokalli, që e ngriti me fund. Kamarierja shkyu sytë, sepse kishte krjuar bindjen se ky profesor nuk kishte provuar asnjëherë pije alkoolike. Kur filloi të dytën, diçka tha me zë të brëndshëm. Ishte një si urim apo vendim që mori me vetën e tij e që do të dëshironte ta shpërndante në eter.

- Ajo është grua... grua... grua.

EDICIONI VIII, VITI 2015

Lazer STANI

KORBAT

Kur në pyll ka një ujku, në qiellin aty rrotull, sigurisht sillen korbat. Ujku, i shtrirë në strofkën e vet, përpiqet të dremisë, e bezdis boshatisja e rropullive, ndjen se barku poi ngjitej pas kurrizit e kjo e ligështon, ia shterron guximin, ia kllapit forcat. Ndoshta është më mirë për të të presë ta përballojë siç i ka hije sojit të tij edhe këtë ditë të mbrapshtë urie, ta shohë se ç’do të sjellë nata që duket ende e largët dhe e paarritshme.

Por korbat që e kanë nuhatur këtë plogështi të ujkut, sillen rrotull në qiellin e plumbtë sipër kokës së tij, krokasin me zërat e tyre të çjerrët e ndjellakëqij, e kuptojnë se ai është ujku. Ujku, i lënduar nga kjo sjellje e tyre e pacipë, humbet durimin, ngrihet në dy këmbët e para, shtriqet disa herë për të shpirë muskujt, mbledhë të gjitha forcat e niset për udhë në kërkim të presë.

Korbat përplasin krahët, bëjnë laradashë në qiell dhe e ndjekin pas. Kur, më së fundi, ujku ja ngulë dhëmbët presë së tij dhe zë ta shqyejë egërsisht, korbat i ulen rreth e rrotull e, duke e soditur me lakmi, lusin zotin që atij t’i mbetet ndonjë kockë në fyt. Ky është fati i tyre.

Vonesa

Bredh këtej-andej me cigare të pa ndezur në buzë. Dua ta ndez diku, të ndalem me dikë që ndodhet aty rastësisht e të shkëmbej dy fjalë, t'i tregoj diçka që gjerë më sot gjithnjë kam dashur ta fsheh, nga që mua ashtu më dukej më e drejtë, por vendi është krejt i shkretë, nuk duket kund gjurmë njeriu, nuk dëgjohet asgjë e gjallë, sikur jeta të jetë shuar përfundimisht. Unë i vij rreth e rrotull grumbullit të hirit vërej se mos dalloj pak shpuzë të fshehur, por zjarri, sa do i madh të ketë qënë (legjenda thotë se ish një zjarr i madh, i hatashëm) është shuar që kur, unë kam arritur tepër vonë e s'më mbetet tjetër veç ta flekë cigaren në këtë varrezë të madhe, ku edhe vetë vdekja do të ndjehej e dëshpëruar, e braktisur. E kuptoj se nuk ia vlen të vrasësh mendjen; është e qartë se asgjë nuk fiton duke shpjeguar shkaqet e këtij zjarri, gjurmët prehistorike të të cilit i përgjoj me trishtim. Por natyra ime e keqe nuk mund të rrij pa e vështuar pasqyrën e thyer të mallit, copëzat e saj të çrregullta që, sipas një marrëveshjeje të veçantë, kanë realizuar eksperimentin e Arkimedit, fokusimin e rrezeve përvëluese në atë pikë, ku unë duhet të kasha arritur shumë me përpara seç arrita në të vërtet dhe ku gjeta këtë grumbull hiri dhe këtë shkretim të pa ndreqshëm. E flak cigaren e pandezur nga buza (hiri e gëlltit atë me një kokëfortësi të keqe) dhe nisem për në një tjetër vend ku, me siguri, do të arrij edhe atje me shumë vonesë.

Dimitrov **POPOVIÇ**



HESHTJE

Ne rrimë, Dëgjojmë.
Dhe nuk dimë ç'thuhet.
E në heshtje bluajmë me mijëra ëndrra.
Mbi shpinën tonë një dramë po shkruhet
Dhe s'e kuptojmë.
Ç'ka drama brenda...

TEK BURIMI I DRINIT

Atje ti i plakur e unë krejt fëmijë.
Këtu ti i ri dhe unë i zbardhur...
Nuk di si të gjeta. O Dri! O Dri!
Me ndrojtje shumë
Apo i mirëseardhur?

Nuk di si të gjeta. Nuk di si as si vija...
 Një gjysmë jete pranë t'i pata brigjet.
 Me ty më duket më e pasur fëmijëria,
 Ndaj malli ma rreh
 Zemrën që më digjet .

Eh, sa kam për të folur për vete...
 Për vitet që shkuan e s'vijne më.
 Derën që lashë hapur e tund era lehtë,
 Veriu thyen heshtjen,
 Çatisë i jep zë.

Atje ti i lodhur e unë krejt fëmijë.
 Këtu ti i lindur e unë krejt i zbardhur.
 Nuk di si të gjeta, O Dri, O Dri,
 Me ndrojtje shumë
 Apo i mirëseardhur!?

THIRRJA

Çudi sin a zuri malkimi i plakave.
 -Fol, he folsh me gishta!
 Me folë me gishta ...
 Me u nda me gishta...

Erdh kjo kohë kështu.
 Dikush me një gisht kërcënon një jetë.
 Me dy gishta të tjerët duan jetë.
 Me tre gishta disa janë në jetë.

Jetë, o jetë!
 Këtu çdo gjë ka nevojë për një fjalë,
 Për një fjalë "zdravo"
 Për një fjalë "t u n g".

Eh, mallkimi i plakave me shpirt si errësira
 Duhet dhe ti ta kesh një fund.
 Fol pra, he folsh me gishta!
 Gjuha jonë the nuk ka.

Mustafa TUKAJ

**FRAGMENT NGA ROMANI “ AJO DHE TË TJERËT”,
NËNTOR 2020**



Ona jetonte në qiellin e shtatë! Kurrë nuk e kishte menduar se tërheqja pas një njeriu të huaj, siç ishte Keleri, do të ishte kaq e madhe. Nuk i vinte dot një emër, por çdo minutë me të, çdo prekje e dorës, çdo fjalë që i thoshte ai e lumtu- ronte pa masë...

Kur vinte në shkollë me shokët, mezi ç’priste sa ta da-llonte në cepin, ku ai rrinte zakonisht, që të sigurohej se kishte ardhur; në pushimin e madh të dy gjenin rastin të lëviznin në një drejtim të përbashkët e t’i thonin dy tre fjalë njëri tjetrit... Kohët e fundit si shumë shpesh po i ndodhte të shkëputej nga shoqëria e saj, pse kishte harruar diçka në klasë apo do të ta-konte një mësues dhe në koridore pastaj apo shkallë, gjith-monë do të gjendej “rastësisht” edhe Keleri!

Po jo vetëm në shkollë.

Pas mësimit jo rrallë i shmangej shoqërisë së vjetër, duke sajuar lloj- lloj arsyesh nga më të çuditshmet, që pastaj rrugën ta bënte me Kelerin...

Pasdrekeve fantazia e saj qe shfrenuar aq shumë, sa arrinte të sajonte në çast një shkak për të dalë, kur ai i çonte ndonjë mesazh. Sa projekte, mbledhje në shkollë, aktivitete, datëlindje! Herë mungonte një libër e duhej ta blinte, herë ishte mbaruar fletorja e detyrave, herë e kërkonte

një shoqe! Fredi e shihte i merakosur dhe i fliste butë që të mos vonohej. Ajo merrte biçikletën dhe kriste me ngut...

Tanimë edhe Keleri, megjithëse “i ngarkuar deri në grykë”, sikur po gjente më shumë kohë të dilte. Sigurisht, kjo për hir të Onës dhe dashurisë për të... Ai stërvitej rregullisht e fort me ekipin e atletikës, se shpresonte që do merrte pjesë në një takim ndërkombtar të atletikës... Ai e kishte pasion sportin. Kuptohet, atletika nuk ishte përparësia e tij kryesore, por gjithsesi ndihmonte. Ku i dihej!... Shumë shpesh, kur dilte nga stërvitja, i çonte mesazh dhe Ona në shumicën e rasteve e priste aty, ku i thoshte ai. Hanin një akulllore, hipnin te *karuseli*, shëtisnin në park. Madje, lidhja e tyre që vulosur edhe me një nyjë tjetër shumë të fortë, puthjen e parë! Atë pasdreke Ona ish kthyer në shtëpi si e dehur, e përhumbur, ëndërrimtare...

Kur nuk e thërriste ai, ajo ngulej në dhomën e saj, se kishte “për të mësuar” dhe në fakt shumicën e kohës e kalonte në instagram duke chatuar me Kelerin, apo duke parë filma, kryesisht telenovela...Ajo vajza e qetë, e heshtur dhe e matur kishte humbur tashmë!..Vendin e saj e kishte zënë një tjetër, pak më e hequr në fytyrë, por që rrezëllente lumturi...Sytë e saj të zinj qenë ndezur nga dëshira të panumurta, ndërsa gjoksën e saj rinor e kishte pushtuar tërësisht një vrundull ndjenjash të bukura, që ajo nuk i kishte njohur kurrë më parë, pa të cilat ajo do të ndjehej bosh dhe nuk do të mund të jetonte... Ato sikur e kishin gjallëruar, i kishin shtuar energjitë dhe i kishin dhënë flatra... Dukej sikur ajo nuk ecte si më parë, duke hedhur hapat njërin pas tjetrit, por sikur fluturonte, me vështrimin e ngulur drejt qiejve të paanë të lumturisë, që ajo donte të pushtonte...

* * *

Atë pasdreke nuk po e zinte vendi. Sillej nepër dhomë, dilte në oborr, ulej në verandë, hynte prap në dhomë, merrte librin për të mësuar, e hidhte mbi shtrat, kapte celularin, turfullonte... Shkaku i vetëm ishte se ende nuk e kishte marrë Keleri në telefon! Kurse ajo nuk kishte mundësi t'i telefononte. Kish mbaruar oferta! Dhe ajo, budallaqja, nuk që kujtuar ta mbushte përsëri! Hapi laptopin, me shpresë se mos ai ishte i kyçur në instagram, por jo...

Nuk kishte asgjë konkrete për t'i thënë, vetëm sa t'i dëgjonte zërin dhe t'i tregonte, se më vonë, nuk do të mund të lidhej në instagram, sepse, për dreq, ishin të ftuar famil-jarisht për një darkë... Prandaj donte

të shfytëzonte kohën, sa pa ardhur mamaja dhe Fredi nga puna. Po nuk qe e thënë!...

Erdhi Fredi. Ajo i doli para dhe e pyeti në ishte lodhur në punë. Pastaj i bëri një kafe.

Fredi, i ulur në verandë, nuk ia ndante sytë tek lëvizte nepër korridor si një gazelë me trupin e saj të derdhur, kur hyri dhe doli nga kuzhina me tabakanë në dorë...

“ U rrit, shumë shpejt u rrit! Nuk më besohet. Më duket se deri dje e mbaja kaliqafë dhe pastaj e hidhja përpjetë në ajër... Ajo thërriste nga qejfi e frika njëkohësisht dhe më shtrëngonte fort pas qafe, kur e prisja me duart e mia, të ngri-tura lart!...”

- Si ia kalove sot në shkollë? – e pyeti, kur i solli kafënë.

- Mirë, ja, si përditë! – u përgjegj ajo dhe zuri vënd në karrigen tjetër.

Ashtu, me biseda kote, rutinë, ndenjën bashkë për disa minuta. Onës i lindi një ide.

- A mund të ma japësh pak telefonin tënd, se më ishte mbaruar oferta? Dua të marr një shoqe ta pyes për detyrat...

- Po si jo!

Ai ia zgjati. Ajo u ngrit, formoi numrin e tij që e dinte përmendësh dhe, si u fut në korridor e pastaj në dhomë, priti sa në anën tjetër të telefonit Keleri, që nuk e njihte këtë numër të përgjigjej ftohtë.

- Jam unë, Ona! Ia mora hua Fredit.. – i shpjegoi – Më ishte mbaruar oferta. U bëra merak, se nuk më telefonove. Si, nuk do të shihemi sot? Pse, nuk ke mundësi? Aaa, do të shkosh me të tutë në teatër! E, po mirë, futu në internet në darkë, kur të kthehesh nga teatri... Puç!

Ia ktheu telefonin Fredit dhe u mat të mirrte filxhanin e kafesë.

- Prit! – i tha Fredi, që e zuri lehtë përdore dhe i zgjati ca para. – Mos ke ndroje të më kërkosh para, se ne edhe mund të harrojmë ndonjëherë nga punët e shumta! Nuk është mirë që telefoni të mos jetë në rregull, se ti mund të kesh nevojë për diçka, kur je në shkollë, rrugë apo shtëpi...

E pa në sy dhe i përkëdheli flokët.

Ajo çoi tabakanë dhe filxhanin në kuzhinë dhe u mat të kthehej edhe njëherë në dhomën e saj, t'i hidhte një sy historisë, që kishte për të nesërmen, se kush e duronte pastaj mësuese Elën, e cila do ta vazhdonte moralin një gjysmë ore... “E, po helebete, na u rritën çupat! Nuk kanë shumë kohë për të mësuar!” e tërcievërci...

Trokiti porta. Ajo doli me të shpejtë, se Fredi kishte hyrë në dhomën e tij. Nxitoi ta hapte, edhe pse ajo nuk qe e mbyllur me kyç, më tepër për

të shkarkuar krejtësisht atë tension të kotë që e kishte kapluar të tërën, para se të fliste me Kelerin...

Ishte Ami dhe...Jada!

Mirë Ami, se ajo ishte shoqja e ngushtë dhe vinte kur t'i tekej, po Jada ç'donte?!

- Përcolla Amin, – foli ajo, a thua se i kishte lexuar mendimet. – Sapo u kthyem nga provat e thashë të të mësoj shtëpinë...

Dhe hodhi sytë rreth e përqark oborrit, e shtangur nga ajo larmi dhe bukuri e rrallë lulësh shumëngjyrëshe, që të dehnin me aromat e tyre...

- Pse s'thoni, se ju të dyja jetoni në parajsë!.. Ne, të pallateve, kyçemi brenda...Lumsi ju! Edhe oborri i shtëpisë tënde ishte i bukur, Ami, po ky i Onës, mos të të vijë keq, qenka një mrekulli!...

E habitur disi për këtë vizitë papritur të Jadës, i ftoi brenda.

- Jo, nuk kam kohë! Duhet të kthehem në shtëpi. Kam gjithë atë rrugë për të bërë...

- Po eja, pesë minuta, sa të të qeras me një shurup trëndafili!...

Ona nguli këmbë, jo dhe aq pse i pëlqente prania e saj, por më tepër për të bërë detyrën e “zonjës” të shtëpisë...

Pastaj, për çudinë e Onës, ajo i vuri dorën në sup, gjë nuk e kishte bërë ndonjëherë më parë.

- Te faleminderit, Ona! Po mos u bëj merak, se do të vij një herë tjetër...Nuk ma kishte marrë mendja të ishte kaq buku këtur!

Dhe doli. Ami shkoi me të.

Këto ditët e fundit Ami sikur ishte ftohur paksa me Onën... Shkaku ishte se Ona e kishte gënjyer para dy ditësh...

Donte të dilte për të blerë një kanotjere të hollë ngjyrë rozë të çelur, që ajo kishte parë në një butique pranë Kullës së Orës, kështu që i kërkoi Onës të shkonte me të... Ona i kishte lypur të falur, sepse, sipas saj, atë pasdreke e kishte të pamundur të dilte, kështu që Ami shkoi vetëm. Deri këtu asgjë për të të mbetur qejfi. Mirëpo, kur u kthye në shtëpi e shkoi tek Ona për t'ia treguar ç'kishte blerë, Fredi i kishte thënë: “Sapo doli. E kërkoi një shoqe në telefon.” Ajo nuk e dinte se ajo “shoqja e telefonit” ishte Keleri, por u prek në sedër, pse e kishte gënjyer...

Të nesërmen prap e bënë rrugën bashkë, por pothuajse gjatë gjithë kohës Ami nuk e çeli gojën... Ndërsa në pushimin e madh filloi të dyshojë në diçka, kur pa Onën që u takua me Kelerin te dera kryesore e shkollës dhe të dy, njëri pas tjetrit hynë brenda në korridor...Nejse,

puna e saj!

Po Jada, vërtetë rastësisht kishte ardhur?!

Jo, Jada nuk i besonte shumë rastësisë. Mllefë pse Ona, sipas saj, i “kishte rrëmbyer Kelerin” vlonte si kazan në shpirtin e saj idhnak dhe gjipnerët e cmirës e hakmarrjes sapo kishin nisur të thurnin intrigat... Taktika e saj tashmë do të ndryshonte... T’i rrinte sa më afër dhe ta bënte mike, sepse, siç kishte lexuar diku, në do të dëmtosh dikë më fort, rriji sa më afër...

Nikolin **GURAKUQI**



APOKALIPS

Në vatrën e durimit digjen dru të lagur,
që nuk ndezin lehtë.
Toka shtrydh mishrat e saj të mbetur pa kocka,
e rrjedh qelb.
Horizontet e ngrira në vetminë e tyre kockore,
heshtin krejt.
Ujvarat vajtonjëse ulurinë nga dhimbjet,
me kokë ulur qajnë si pleqtë.
Digjen shirat e rrëmbyer të shpresës,
e bëhen shkrumb rrufetë.
Në pavijonin e dëshirës,
e nesermja më kthehet në llum,
diejt më kthehen në akullnaja shkretëtirash pa fund.
Nga hundët e botës rrjedhin polibe magmash blu,
që shkojnë askund.
Apokalipsi, ndalur në stacione hapsinore,
rri varur si shpata e Damokleut,
mbi kryet e tragjedive të botës,
që me paterica ecën gjithkund.
Në djepin e ndryshkur të hapësirës,
bota një fëmijë përkund.

Marçel HILA

NË AMERIKË APO NË QAF TË BARIT?



Xhaxha i Sokol Mulës, Kadri Mula, kishte vite që qe arratisur. Jetonte në Amerikë. Familja e Deli Mulës u dërgua në internim. Pastaj tre viteve u lirua. Fëmijët e vëllezërve të Kadriut nuk morën shkollë të lartë, edhe pse shkëlqyen në mësim. Ishin nga fshati N i Tropojës. Për shkak të kësaj biografie, bashkë me djalin e xhaxhait të tij, Dritanin, Sokoli u dërgua ushtar në repartin e xhenios. Bënin bunkerë. Xhaxhai larg, Kadriu, i punës e i leximeve, atje, bëri, po themi, 'karrierë': figurë e rëndësishme e organizatës Vatra. Publikonte, fliste në zërin e Amerikës e mbante kontakte me krerët e rëndësishëm të diasporës politike kudo.

Një ditë, oficeri i repartit, komandanti, i thirri e u tha të dyve, Sokolit e Dritanit, se mund të shkonin me leje treditore në shtëpi. Ata u çuditën, sepse nuk kishin kërkuar. Ua mbushi letrat e i nisi. Të rinjtë u habitën. U duhej tani të shkonin deri te agjencia e kamionëve të gjenin makinë e të iknin. U ra ky gëzim si prej qielli. U nisën. Nuk ishte larg, pak kilometra. Të rinj ishin, e hanin rrugën.

Sapo morën një kthesë, kur dy burra, të veshur e të mbathur, i dolën para dy ushtarëve.

- *Ju, hyni në makinë!* - i urdhëruan. Një si ambulancë gjendej e

parkuar pranë kanalit, buzë rrugës.

Të dy kushërinjtë i kapi frika. Edhe pamja e atyre dy njerëzve, që flisnin me ton kërcënues, i terrorizoi. Hipën. Brenda kishte perde të trasha, të lëshuara e që nuk lejonin të hynte drita. Mjeti u nis. Të rinjtë nuk e dinin se për ku i nisën. I kapi paniku. Udhëtuan kështu rreth një orë. Pastaj, ambulanca ndaloi.

- *Zbrisni!* - i urdhëruan. Djemtë zbritën. E panë veten në një oborr. Nuk kishin qenë kurrë më parë këtu. Ku gjendeshin? I futën në dy dhoma të ndryshme që kishin nga një krevat, një tryezë, por pa dritare. Ndriçimin e bënte një llambë në tavan.

Dera u mbyll. Pas rreth dy orësh, që nuk kalonin kurrë, dikush e mori Sokolin. U çuan diku, në një ambjent të mobiluar, me kolltuqe, me një tryezë të madhe. Zyra kishte dritë, që hynte nga dritaret. Ai, si i tromaksuar, nuk po e merrte veten.

- *Hë, djalë, si je?* - ia bëri njëri, që dukej se ishte i rëndësishëm, por që nuk u prezantua.

- *Mirë!* - u përgjigj fakiri i tulatur e me ndrojtje.

- *Çfarë do të hash?*

- *Ë? Asgjë! Veç më tregoni ku jam e pse më keni sjellë këtu?*

Dy burrat nuk treguan. Filluan gjoja të bënin shaka, por edhe papritur zymtësoheshin e mrrulleshin. Herë bënin si hokatarë e herë rrinin seriozë e kërcënues. Nuk iu përgjigjen pyetjes së tij. Djali u frikësua pa masë. Donte të dinte ku gjendej. Edhe rrëmbyesit, duke deshifruar ankthin që i lexohej nga sytë, sepse orbitat e kokërdhokët nuk po i gjenin qetësi, si dhe nga lëvizjet e pakontrolluara, e kuptuan se ai po përjetonte ankth.

- *Qetësohu!* - i tha ai që dukej se ishte më i rëndësishmi, sepse bënte poza e përpieqej të përdorte një mënyrë autoritare komunikimi. - *Dëgjo! Je këtu se do Partia. Ju njohim mirë. Vërtetë që jeni të dekluar, si familje keni qenë në internim, por Partia mendon edhe për ju, ju edukon, ju mbron, dhe ... edhe ju duhet t'i përgjigjeni asaj, kur ju kërkon apo ju beson një detyrë.*

Sokoli ishte i tromaksur. Dëgjonte, por nuk po dinte të kapte thelbin e fjalëve të atij që i fliste shtruar dhe me pak kërcënim brenda.

- *Ti e do partinë?* - i erdhi pyetja, si për ta sjellë në vete.

- *Po!* - u përgjigj ai instiktivisht dhe krejt konfuz.

- *Ashtu, shumë mirë. Je këtu se të pret një detyrë e rëndësishme.*

Partia beson se ti mund ta kryesh, e mirë madje. - Sokoli shihej lehtë se vazhdonte të ishte i tronditur.

- Mos kij frikë. Do të kesh ndihmën tonë për çdo gjë. - Dhe pyetja bombë: - ti ke një xhaxha në Amerikë?

- Po! - përgjigj automatikisht, pa menduar dy herë Sokoli.

- Kadri Mula, xhaxhahi i jot, është anëtar i një organizate të rëndësishme atje ... ti, domethënë ne, të dërgojmë atje, dhe ti, duke qenë pranë tij e ... përkrah dhe - Sokoli vazhdonte të mos kuptonte gjë. Burri hijerëndë vazhdoi: - duke qenë i nipi i tij e duke i qëndruar pranë, edhe ti bëhesh i rëndësishëm.

- Çfarë duhet të bëj? - i doli pyetja dhe ua lëshoi para.

- Ti? Asgjë! Veç do të marrësh pjesë në mbledhjet e organizatës, në diskutime, se ... mbledhjet ata i bëjnë në salla të mbyllura, ku marrin pjesë shumë pak veta. Dokumentet që do të hartosh, do t'i bësh në dy kopje. Për shembull proces-verbalin e mbledhjeje, atë që tregon se çfarë është biseduar e kush ka diskutuar ... - dhe demoni autoritar po e shikonte ngulazi - njëren kopje ia dorëzon Partisë ... kemi njerëzit tanë atje. Ua jep atyre. Vijnë ata e të kërkojnë ... do t'i njohësh, nuk është aspak e vështirë ...

Ushtari i shkretë po rrinte i ngrirë, pa fjalë, në heshtje, plot frikë. U tmerrua kur mendoi se sigurimi i shtetit kishte njerëz që vepronin lirisht në Amerikë dheurvejonin xhaxhanë e tij. Sokoli s'kishte pasur rast ta njihnte axhën e vet, por nga diskutimet në shtëpi, kishte formuar një ide shumë të mirë për të.

- Këta janë masakrej! - i edhi në mendje. - Unë të jem spiuni i axhës tim? Deri këtu ta uli veten? Jo, jo, punë që nuk bëhet. As që bëhet fjalë.

- Hë? - i erdhi si çekan pyetja e njërit prej tyre - pranon?

- Ti - ia mori fjalën tjetri - do të firmosësh këto letrat dhe për të fituar besueshmërinë tonë, do t'i dalësh dëshmiar kushëririn tand, atij që erdhe këtu me të.

- Pse?

- Sikur ka bërë agjitacion e propagandë. Ai do të hyjë në burg e do të bëjë ca vite, ndërsa ti mbërrin drejt e në Amerikë ...

- T'i dal dëshmitar kushëririn?

- Po, dhe të të hapen rrugët e jetës e shkon në Amerikë ...

- Jo, punë që nuk bëhet! - përgjigji me vendosmëri Sokoli.

Dy burrat u egërsuan, u tërbuan, u nxinë. Njëri e kapi seriozisht

situatën e ia nisi me metoda bindëse:

- *Pse nuk pranon?*

- *Si të pranoj? - foli i trimëruar Sokoli - Të tradhëtoj xhaxhain? Nuk bëhet! T'i dal kushëririt tim dëshmitar për gjëra që nuk i ka bërë? As që më shkon në mendje.*

Ai seriozi, që bënte kompetentin e që ndoshta ishte i rëndësishëm, por që nuk u prezantua, tha:

- *Mendo mirë, se nuk i lutemi kujt. Mendo. Ke rast, shkon në Amerikë, ... por - dhe bëri një pauzë, - po nuk pranove, të pret burgu.*

Një ndjënjë ankthi dhe terrori e pushtoi të riun. Reagoi pafajësisht:

- *Nuk kam bërë asgjë, pse të hyj në burg?*

- *Atë e dimë ne. Por, shko në dhomën tënde e mendohu. Jep përgjigje nesër. Zgjidh burgun apo Amerikën.*

E çuan te dhoma. U hap dera përballë, U dëgjua zëri i kushëririt, që plot frikë, bënte edhe ai pyetje, por që nuk merrte përgjigje. E çuan te dhoma ku kishte qenë pak më parë Sokoli.

Sokoli pësoi një dalldi mendimesh. T'i dilte kushëririt dëshmitar? Punë që s'bëhej. Turp i madh. Qenë rritur bashkë! Skandal. As që bëhet fjalë. Nata qe e gjatë, e pafund, s'mbaronte kurrë.

Të nesërmën në mëngjes e morën lart. Ishin po këta të dy. Në fillim u zgërdhinë, pastaj u bënë seriozë.

- *Ke ndërruar mendim apo jo?*

- *Jo, punë që nuk bëhet! - foli me vendosmëri ushtari i bunkerave.*

- *Shiko, kushëri yt është dakord që të të dalë ty dëshmitar e të shkojë ai në Amerikë ...*

Sokolit iu duk trillim i pabesueshëm. "Seriozi po gënjen trashë!" - mendoi.

- *A do të shkosh në burg apo në Amerikë? Ne e kemi zgjidhur! Je ti që nuk po vendos si duhet.*

Kur thanë këtë, Sokoli mendoi se qe gënjeshtër. "Pra as kushëri nuk paska pranuar!" - mendoi.

- *Jo, nuk mund t'ia bëj një gjë të tillë kushëririt tim dhe as xhaxhait. Bëni si të doni!*

- *Shiko, shko edhe njëherë e mendohu, pastaj, nesër flasim për herë të fundit! More vesh? Kur të mbërrish me autoburg në Qafë të Bari, atëherë do ta kuptosh se ke humbur rastin! Po humbet Amerikën. Ik*

mendohu!

E çuan përsëri në dhomë. Një trazim i madh e kapi. Të lozte rolin e nipit të mirë e të tradhëtonte xhaxhain? Apo të bënte tradhtarin e t'ia shkatërronte jetën kushëririt? Po familja? Po e mori vesh se kishte pranuar të hynte në këtë ndyrësirash? Amerika e joshte keqaz, me gjithë forcën e saj tunduese. Frika e Qafë Barit e masakronte. I silleshin të gjitha këto në mendje, i pështjelloheshin, e goditnin.

U hap dera. Po e merrnin përsëri. Kjo duhet të ishte e fundta.

- *Hë - i thanë - a ke bërë mendim?*

- *Nuk mundem as axhës t'ia bëj këtë ë as kushëririt. Bëni ç'të doni!*

Dy veta të tjerë e morën Sokolin e shkretë. Një makinë e mbyllur e sorollati disa herë diku, gjatë e pastaj, ... pastaj i vunë hekurat. E çuan në Kukës. Aty i dolën tre veta dëshmitarë se kishte kryer krimin e agjitacionit e të propagandës. Mes tyre edhe kushëiri i tij, Dritani. E dënuan shtatë vite burg. E dëgjoi vendimin nga goja e gjykatësit. Pastaj, një ditë, një makinë e çoi në burgun e Qafë Barit.

* * *

- *Sokol Mulaj - thirri roja i burgut.*

- *Urdhëro!*

- *Të kanë ardhur njerëzit e shtëpisë.*

Sokoli doli. Eci e shkoi deri tek vendi ku bëheshin takimet me familjarët.

Pa nënën, babanë dhe vëllanë e vogël. E pyetën. Pastaj edhe ky pyeti për njerëzit e tjerë të familjes, për motrat e xhaxhallarët. Edhe për kushërinjtë. Pyeti edhe për Dritanin, që ia bëri atë turp, i doli dëshmitar. Nuk kishte lojë. Por donte të dinte sesi përfundoi puna e tij. I kishte mbetur enigmë: A përfundoi edhe ai në burg si ai apo jo?

- *Po Dritani si është?*

Me një shenjë me dorë, i ati i tregoi se ai ishte arratisur. Kishte mbërritur në Amerikë

- *Ashtu?*

- *Po, Hamdija ka marrë letër që thotë se është atje shëndosh e mirë!*

EDICIONI IX, VITI 2016**Haxhi SHABANI****Amerika më merr me të mirë**

Amerika më jep vizë rreptë të paguar, Amerika
Më jep mundësi të punoj dy punë njëkohësisht,
Ta bëj gjumin një cope, pa ëndrra, Amerika m'i
ndan fjalët me gruan, sepse me gruan flej rrallë
e përmallë. Amerika s'më lë t'iu prish rehatinë
fëmijëve fëmijët e mi të cilët i shoh vetëm
kur ata flejnë. Amerika më merr me të mirë.
Amerika nuk më ndalon të përdor flamurin tim, ajo
vetë thotë se flamujt lecka janë, Amerika nuk
më pengon që të flas gjuhën time të cilën
me vetëdëshirë në pazar nuk e qes e ruaj për
në banesë për ta ngrënë ngapak përditë.

Amerika më në fund më lejon të vdes, Amerika
më merr me të mirë me ligjet e saj, parasheh
kryerjen e formaliteteve ndaj kufomës nga përfaqësues i shtetit
që s'e kam,
Ajo vetëm dheun për t'u mbuluar përgjithmonë nuk
ma jep ai duhet paguar shumë shtrenjtë.

Drurët e stogjeve për djegie

Kemi formuar njëtrajtshmëri
në patrajtshmërinë e gjinisë, familjes, fisit,
aksidentalisht jeni vendosur në këtë stacion.
Mund të mos ishit prerë
edhe pse jeni të drejta, të shtrembëra
mund të ishit bërë djepa,
mund të kishit shfryrë las mbi rroba,
tash keni rënë në shtratin e vdekjes.
I humbët shumë funksione që kishit
në ndonjë prej jush,
mund të bënte çerdhe një zog,
mund të hidhej litari për varje,
tash jeni me një këmbë në varr,
tash, a vlen paqeja e pashpallur në stok?
Dora e njeriu shpejt mund të vijë
për t'ju shpënë në të përjetshmen shtëpi.

Kolec **TRABOINI**



ODE PËR SHKODREN

Qytet dy mijëvjeçar
që zgjohet
me ninulla e vaje
nga lashtësia,
nën hijen e një kështjelle
të rame në gjunjë,
që u falet ujnave
të Drinit e të Bunës.

Dhe Taraboshit,
vllait të zhveshun,
përvëlu nga dielli,
i rrahun nga shiu,
si çadra ciganësh
nën mjegull.

Qytet i stërlashtë,
hija e moçme e vetvetes,
sendërzu prej shekujsh.
Panteoni i Ilirëve,
mbretëreshë hyjnore
mes malesh e detit,
veshun me parzmore
trimnie.

E pathyeme në luftra,
metamorfu prej absurdit
si nanmadhe kocëdalë,
mbështjellë me të zeza

që mjerueshëm merr
Fushëm e Rrmajit,
vajton e çjerr fytyrën
nën çinarin e Zorbës
për kohët që nuk kthehen
e njerëzit që ikën.

Aty ku një korb
me krra-krra përshëndet
qefinët e rinj, përcjellë
nga karvanët
e gjakut të shpagimit.

Ndërsa ma nalt,
në katakombet e errëta
të kështjellës me emnin
Rozafë
fshihet ende fantazma
e nuses së murosun,
besnike e mjerueshme
e fjalës së dhanë.

Lakuriqësi e mermertë
e gjinjve të bardhë,
që pikëllueshëm ende
(fantazish) pikojnë
tamlin e hidhun
të nusërisë së mohume.
Tamli i jetë - vdekjes
pikon prej guri,
si makth i moçëm
i një legjende të vrame
në thellësi të mureve
të heshtuna të kujtesës,
në shtëpitë e përhime
të qytetit verior
që kërrusun, vajtueshëm,
pikëllojnë dhe ato.

Pikëllimin e udhëve
të qytetit e shton:
imazhi i një nane plakë
që hiqet kambëzvarrë,
si Rozafë e ringjallun
që me gjoksin e mardhun,
me frymën e pakët
përpiqet të ngrohë
sqepin e bardhë
të një pëllumbi
të vdekun.

SIMBIOZË SHKODRANE

Kur na zë gjumi me gratë
Rozafat që fati na i ka dhanë,
ne i ndjejmë ninullat
që zbresin prej kalasë.

Në një djep druni,
premë prej pyjesh paganë.

E lumejt e tamlit,
dallgëmbytun prej andrrave,
harbuem si të ishin Kiri,
Drini e Buna.

Dashnija
e dhimbja
e mali
e halli,
drita
e errësina,
kanga
e vaji,
plumbi e pëllumbi
e gjarpni nën gur,
nën hijen tragjike
të harkadave.

Nuk ka pse t'i ankohen
as Zotit e as dreqit
për rrëmetet që lashtësia
ne, bijve të Teutës
na i përcjell.

As për fatin që na vuni
këtë rrisk biblik,
ne, shkodranëve.

Të rrojmë si në legjenda
e t'i mëkojmë fëmijët
me tamël prej guri
edhe sot
mbas dymijë vjetësh...

Qyshkur vumë themelet
e qytetit mbi gjinin e bardhë
të një gruaje,
me këtë simbiozë sizmike
kemi lindun.

Adrian PACI

SIMONE WEIL
MENDITIME MBI NËNSHTRIMIN E MBI LIRINË

(Përkthim, pjesë nga libri “Bulëzat”)



Nënshtirimi i shumicës ndaj pakicës, ky fakt themelor në pothuajse të gjitha organizimet shoqërore, nuk ka reshtur së trondituri të gjithë ata që kanë aftësinë të reflektojnë qoftë edhe pak. Në natyrë ne asistojmë në faktin se pesha më e rëndë fiton ndaj peshës më të lehtë, në faktin se racat më pjellore ia marrin frymën të tjerave. Në fushën njerëzore këto raporte kaq të qarta duket sikur shfaqen të përmbysura. E dime sigurisht, në bazë të një eksperience të përditshme, që njeriu nuk është thjesht një fragment i natyrës, e ajo që konsiderohet si më lartësuese për njeriun, vullneti, inteligjenca, besimi, prodhon çdo ditë mrekullira të shumëllojshme. Por nuk është kjo për të cilën po flasim këtu. Nevoja e pamëshirshme që ka mbajtur e mban në gjunjë masat e skllëvërve, masat e të varfërve, masat e të nënshtuarve, nuk ka asgjë të përshpirtshme; ajo shkon krah për krah me atë që në natyrë është brutale. Gjithsesi, një nevojë e tillë ushtrohet, të paktën në dukje, si pasojë e ligjeve të kundërta me ligjet e natyrës. Duket sikur, në peshoren shoqërore, grami ia ka dalë të fitojë mbi kilogramin.

Rreth katër shekuj më parë, djaloshi La Boétie, në shkrimin *Nënshtirimi vullnetar*, shtronte pyetjen pa marrë ndonjë përgjigje. Me çfarë shembujsh emocionues do të mund të mbushnim sot librin e tij ne, që shohim në një vend i cili mbulon një të gjashtën e globit, një njeri të

vetëm që gjakos një brez të tërë njerëzish. Kur harliset vdekja, mrekullia e bindjes shfaqet haptazi. Fakti që shumë njerëz i nënshtrohen një njeriu të vetëm nga frika se ku mund t'i vrasë nuk është pak tronditës; por që ata të jenë kaq të nështruar deri në pikën që të japin jetën nën urdhërat e tij, kjo si mund të përliqet? Në çastin kur bindja sjell me vete rreziqe jo më pak të vogla se rebelimi, si ka mundësi që ajo mbetet e pandryshueshme?

Njohja e botës materiale në të cilën jetojmë ka mundur të zhvillohet qysh kur Firenze, përtej shumë mrekullive, i ka dhuruar njerëzimit, falë Galilei-t, nocionin e forcës. Vetëm atëherë u bë e mundur të kuptohet shfrytëzimi racional i ambientit natyror nga ana e industrisë. E ne që pretendojmë të administrojmë ambientin shoqëror, nuk do të kishim as njohurinë më të përgjithshme nëse nuk do të zotëronim në mënyrë të qartë nocionin e forcës shoqërore. Asnjë shoqëri nuk mund të ketë inxhinierët e saj pa patur mbas krahëve Galilei-n e saj. A ka vallë në këtë çast mbi fytyrë të botës një mendje që të jetë e aftë të kuptojë, qoftë edhe në mënyrë të turbullt, se si është e mundur që një njeri i vetëm në Kremlin të ketë aftësinë të rrëzojë çdo kokë në gjithë hapësirën mbrenda kufinjve të Ruisë?

Marksistët nuk na kanë dhënë një sqarim të problemit duke zgjedhur ekonominë si çelësin e enigmës shoqërore. Nëse e konsiderojmë shoqërinë si një qenie kolektive, atëherë kjo kafshë e madhe, si çdo kafshë tjetër, mund të identifikohet kryesisht mbi bazën e mënyrave përmes të cilave siguron ushqimin, gjumin, mbrojtjen ndaj të papriturave, me një fjalë, jetën. Shoqëria e konsideruar në marrëdhënie me individin, gjithsesi, nuk mund të përcaktohet vetëm mbi bazën e mënyrave të prodhimit. Mund edhe të kapemi mbas të gjitha sfumaturave të holla për ta konsideruar luftën një dukuri me profil ekonomik: por kërcet para syve fakti që lufta është shkatërrim e jo prodhim. Bindja dhe komandimi janë po ashtu dukuri ndaj të cilave nuk mund të ndërtohet një ide bazuar te kushtet e prodhimit. Kur një i moshuar i papunë e i pandihmë vdes në heshtje në një rrugë o në një hendek, ky nënshttrim që zgjatet deri te vdekja, nuk mund të shpjegohet duke iu drejtuar lojës së nevojave jetësore. Shkatërrimi masiv i grurit apo i kafes në kohën e një krize ekonomike ofron një shembull jo më pak të qartë. Nocioni i forcës, e jo ai i nevojës, përbën çelësin që na lejon të interpretojmë dukuritë shoqërore.

Galilei pat pak mundësi për të korrur lavdet e veta mbi gjenialitetin

dhe korrektësinë e treguar në deshifrimin e natyrës; atij të paktën iu desh të ndeshesh vetëm me një grusht njerëzish të fuqishëm, të specializuar në interpretimin e shkrimeve të shenjta. Por studimi i mekanizmit shoqëror është mburrje pasionesh që mund t'i hasësh edhe te çdo individ i marrë veçmas. Nuk ka pothuajse asnjë njeri që nuk dëshiron, sa të përmbysë, aq edhe të ruajë marrëdhëniet aktuale të sundimit e të nënshtrimit. Të dyja dëshirat ta turbullojnë mendjen dhe pengojnë perceptimin e leksioneve të historisë, e cila na tregon se gjithmonë masat qëndrojnë poshtë zgjedhës së dikujt që mban në dorë një kamxhik.

Nga ana e atyre që i bëjnë thirrje masave kërkohet të demonstronhet që një situatë e tillë është jo vetëm unike, por deri edhe e pamundur, të paktën në një të ardhme të afërt a të largët.

Nga ana e atyre që synojnë ruajtjen e rendit e të privilegjeve kërkohet të demonstronhet që kjo lojë nuk ka edhe aq peshë, ose të paktën, është e pranuar në mënyrë konsensuale. Nga të dyja palët mbulohet me një perde absurditeti radikal i mekanizmit shoqëror, në vend që të shihet mirë në sy e të analizohet ky absurditet i dukshëm, për t'ia zbuluar të fshehtë e mekanizmave të tij. Në çfarëdo fushe kërkimi nuk ka një metodë tjetër reflektimi. Habia është nëna e urtësisë, thoshte Platoni.

Nga çasti që numri i madh bindet, dhe bindet deri në imponimin e vuajtjes e të vdekjes, ndërsa numri i vogël ushtron pushtetin e tij të komandimit, kjo vërteton se nuk është e vërtetë se numri përbën forcën. Përtej faktit se imagjinata jonë na shtyn mos ta pranojmë, numri është një dobësi. Dobësia është aty ku ka uri, ku je i rraskapitur, ku lutesh e dridhesh e jo aty ku jetohet mirë, ku bëhen lëshime apo formulohen kërcënime. Populli nuk është i nënshtruar pavarësisht nga numri, por është i nënshtruar pikërisht se është ai numër.

Nëse në rrugë një njeri i vetëm ndeshet me njëzet të tjerë, ai do të mbetet pa dyshim përtokë i vdekur. Por me shenjën e vetme të një të bardhi, njëzet argatë anamitë mund të zhdëpen në hu njëri mbas tjetrit nga njëri prej kapove të skuadrës.

Kontradikta është vetëm në dukje. Pa dyshim, në çdo rrethanë, ato që janë në pozicionin e komandimit janë më pak se ata që binden. E pikërisht sepse janë më të pakët në numër formojnë një grup kompakt. Të tjerët, pikërisht sepse janë tepër të shumtë, janë njëri e mandej tjetri, e kështu me rradhë. Aq më tepër që forca e një minorance të vogël bazohet, përtej të gjithave, në forcën e numrit. Kjo pakicë kapërcen numerikisht shumë e shumë herë secilin prej atyre që përbëjnë masën

e shumicës. Nuk na lejohet të arrijmë në përfundimin se organizimi i masave do të mund të përmbyste këtë raport, meqë ky organizim është i pamundur. Nuk mund të ketë vend bashkërendimi, përveç se në mes të një komuniteti të vogël njerëzish. Përtej këtij kufiri kemi vetëm mbivendosje individësh, pra dobësi.

Ka patur gjithsesi, momente në të cilat gjërat nuk kanë shkuar krejt kështu. Në disa momente të historisë, një frymëzim i madh vë në lëvizje masat: frymëmarrja e tyre, fjalët e tyre, lëvizjet e tyre shkrihen e bëhen një. Atëherë asgjë nuk mundet t'i rezistojë. Të fuqishmit e kuptojnë se çka do të thotë të ndihesh i vetmuar e i çarmatosur: e dridhen.

Taciti, në disa faqe të pavdekshme ku përshkruan një mision ushtarak, ka ditur të analizojë në mënyrë perfekte këtë gjendje: "Sinjali kryesor i një lëvizjeje të thellë, të pandrydhshme, qëndronte në faktin se ato nuk ishin të shpërbërë apo të manovruar prej dikujt, por merrnin zjarr së bashku, së bashku heshtnin, me një unanimitet e me një bindje që të bënte të besojë se vepronin nën një komandë të vetme". Kemi asistuar në një mrekulli të tillë në qershorin e 1936-ës dhe jemi ende të prekur.

Momente të ngjashme kanë një kohëzgjatje të shkurtë, edhe pse ata që e përjetojnë këtë përvojë shpresojnë me gjithë zemër që ajo të zgjatet drejt pambarimit. Nuk munden të zgjatet, sepse ky unanimitet, që prodhohet vetëm nën shtysën e një emocioni të fortë e të përgjithshëm me çfarëdolloj nisme metodike. Një unanimitet i tillë ka gjithmonë efektin e një pezullimi të çdo veprimi dhe pezullimin e rrjedhës së përditshme të jetës. Kohëzgjatja e kësaj ndërprerjeje nuk mund të shtrihet në kohë; rrjedha e jetës së përditshme duhet rimarrë, nevojat e përditshme duhen plotësuar. Masa shpërbëhet rishtas në individë, kujtimi i fitores së saj turbullohet, gjendja fillestare apo një gjendje e ngjashme ristabilizohet pak nga pak; e për aq kohë sa në këtë interval padronët kanë arritur të ndërrohen, janë gjithmonë të njëjtët njerëz që vijnë të binden.

Të fuqishmit nuk kanë asnjë interes që të jetë më vital se ai i pengimit të këtij kompaktimi të masave të nënshtruara, o së paku, në rast se nuk ia dalin t'i pengojnë, ta bëjnë sa më të rrallë që të jetë e mundur. Që i njëjti emocion të arrijë të zgjojë në të njëjtën kohë një numër të madh të pashpresësh, është diçka që ndodhë shpesh për shkak të rrjedhës së natyrshme të gjërave; por rëndom ky emocion, sapo zgjohet, mbytet nga perceptimi i një pafuqie të pashmangshme. Të ushqesh një ndjenjë pafuqie të këtij lloji përbën artikullin e parë të një politike të efektshme nga ana e padronëve.

Shpirti njerëzor është çuditërisht i thyeshëm, i gatshëm të imitojë, i gatshëm të përkulet nën peshën e rrethanave të jashtme. Ai që bindet, ai, lëvizjet e të cilit, vuajtjet e të cilit, kënaqësitë e të cilit janë të përcaktuara nga komanda e njerëzve të tjerë, ndihet inferior jo në mënyrë aksidentale, por si rrjedhojë e natyrës. Në ekstremim tjetër të shkallës ndihen jo më pak superiorë e këta dy iluzione rrijnë duke ushqyer njëri-tjetrin. Është e pamundur edhe për shpirtin më heroik, të ndërgjegjësohet mbi vlerë të brendshme, kur ky ndërgjegjësim nuk mbështetet në asnjë fakt të jashtëm. Vetë Krishti kur e pa veten të braktisur prej të gjithëve, të tallur, të shpërfillur, kur e pa jetën e vet të gjykuar në asgjë, humbi për një çast kuptimin e misionit të tij; e çfarë tjetër do të thotë thirrja: “O Atë, pse më ke braktisur?”. Duket, për të gjithë ata që binden, sikur një inferioritet misterioz i ka paracaktuar të binden në përjetësi: e çdo përçmim, qoftë edhe të vogël, që pësojnë nga superiorët apo nga të ngjashmit e vet, çdo urdhër që marrin, mbi të gjitha çdo akt nënshtrimi që vetë aplikojnë, nuk bën gjë tjetër veçse ua konfirmon këtë bindje.

E gjithë ajo që kontribuon për krijimin e idesë së të pasurit e ndonjë vlere nga ata që zënë një nivel të ulët në shkallën shoqërore, është, në një farë mënyre, subversive. Miti i Rusisë sovjetike është subversiv në masën që mund të ushqejë në punëtorin e krahut, komunist, të pushuar nga puna nga kapo reparti, ndjenjën se përtej gjithçkaje, mbas shpatullave të tij qëndron Armata e kuqe e Magnitogorsk-it, e për rrjedhojë, do ta ndihmojë ta mbajë gjallë krenarinë e tij. Miti historikisht i pakundërshtueshëm i revolucionit luan të njëjtin rol, qoftë edhe në mënyrë abstrakte; është, gjithsesi, diçka, kur je mjerman dhe i vetmuar, të kesh historinë në krahun tënd. Krishtërimi, në fillimet e veta, ishte po ashtu i rrezikshëm për rendin. Nuk frymëzonte tek të varfërit, skllëverit, grykësinë e të mirave materiale dhe të pushtetit, përkundrazi; gjithsesi ai u ushqente atyre ndjenjën e një vlere të brendshme, që i vendoste në të njëjtin plan apo edhe më lart se të pasurit, e kjo ishte e mjaftueshme për të vënë në rrezik hierarkinë shoqërore. Shumë shpejt veçse, i korrigjuar, mësoi të bëjë dallimin e nevojshëm mes martesës dhe varrimit të të pasurve me martesën dhe varfërinë e të varfërve e filloi t’i rreshtojë ndër vendet e fundit të pashpresët.

Forca shoqërore nuk ekziston pa gënjeshtren. Aq më tepër që gjithçka që përbën pjesën më të lartë të jetës njerëzore, çdo përpjekje mendimi, çdo përpjekje dashurie, janë gërryese për rendin. Në të njëjtën mënyrë, edhe mendimi mund të përçmohet si revolucionar, simbas një pikëpamjeje e

kundër revolucionar, simbas një tjetre. Sado që ndërton papushim një shkallë vlerash “që nuk i përkasin kësaj bote”, mendimi është armik i forcave që dominojnë shoqërinë. E, megjithatë, nuk është mbështetës i nismave që rreken ta përmbysin apo transformojnë shoqërinë, të cilat para se të përmbushen, duhet të implikojnë domosdoshmërisht nga ata që janë përfshirë, nënshtrimin e numrit më të madh ndaj numrit më të vogël, përçmimin e privilegjeve për masën anonime e rendjen pas gënjeshtërisë. Gjenialiteti, dashuria, shenjtëria meritojnë plotësisht qortimin që shpesh u bëhet, pra se çojnë në shkatërrimin e asaj që ekziston, pa ndërtuar asgjë në vend të saj. Përsa i takon atyre që duan të mendojnë, dashurojnë dhe të transferojnë në veprim politik atë që iu frymëzon shpirtin e zemrën, ata janë të destinuar të përfundojnë kokëprerë, të braktisur edhe nga miqtë, të përçmuar nga historia pas vdekjes, siç ndodhi me Gracchi-n.

Nga një situatë e ngjashme rrjedh, për çdo individ dashnor të së mirës publike, një çarje e egër dhe e pashërueshme. Pjesëmarrja, edhe nga larg, në lojën e forcave që lëvizin shoqërinë, nuk është e mundur pa u bërë pis o pa rënë në dështim. Strukja në indiferencë a në një kullë të fildishtë nuk është e mundur, përveç se nëpërmjet një pavetëdijeje të plotë. Formula e “të keqes më të vogël”, aq e përbuzur nga socialdemokratët, mbetet atëherë e vetmja që mund të aplikohet nga një mendje e ftohtë.

Sido që të jetë, rendi shoqëror është sa i nevojshëm, aq edhe thelbësisht i lig. Nuk mund të qortohen ata që janë të shtypur se duan të çlirohen me aq sa munden; fakti që dorëzohen nuk është ndonjë virtyt, përkundrazi, përfaqëson efektin e një poshtërimiti që fik ndër to virtytet e burrërisë. Nuk mund të qortohen se i dalin zot as ata që e organizojnë këtë rend, e as të prezantohen si aktor të një komploti ndaj të mirës së përbashkët. Luftërat mes bashkëqytetarëve nuk lindin nga mungesa e mirëkuptimit apo e vullnetit të mirë; ato rrjedhin nga natyra e gjërave e nuk mund të zbuten, por vetëm të shtypen nëpërmjet ndëshkimit. Për këdo që do lirinë nuk është e dëshirueshme që ata të zhduken, por vetëm të mbesin mbrenda një farë kufiri të përdorimit të dhunës.

Shpëtim SELMANI

* * *

Historia mbi të gjitha është përvojë.
Ajo është shkenca e njohjes ndaj vetes.
Sipas saj barbarizmi është esencial.
Që nga kohëra të mëhershme
ushtritë krishtere marshuan kundër asaj myslimane.
Vuajtja njerëzore e ka në natyrën e saj, të jetë e pamjaftueshme.
Pastaj Fuqitë e Mëdha të Boshtit u bënë copë e grimë
ndaj asaj aleate, muzika ishte bërë gjak.
Gjermanët pushtuan polakët, belgët, holandezët,
çekët, grekët, imagjino pushtuan Francën e Volterit dhe
shumë popuj tjerë të vegjël,
hebrenjtë dhe romët nuk llogariteshin.
Teoria europiane mbi lumturinë njerëzore
është mësim i ashpër drejt përkufizimit të paqes.
Rusia gjatë tërë kohës rri gatitu, në pritje
të urdhërit për të pushtuar, ajo ndjen
nostalgji për urinë e ashpër ukrainase.

Dhe të gjithat librat e famshëm sovjetik mbi psikologjinë
 njerëzore më rrinë në raft, unë i shoh me dyshim.
 Gjenocidi është përtej çdo letërsie.
 9 milionë vitima, gjatë Luftës së Parë Botërore.
 A ka diçka më të turpshme në moralin njerëzore se sa statistikat?
 Pra, kinezët kundër japonezëve, japonezët kundër kinezëve.
 Njerëzit me lëkurë të qëruar nga thikat e shteteve
 që adhurojnë lulet, perëndimin e diellit dhe artet marciale.
 Latino-amerikanët e shkretë kundër racës supreme
 europiane e pastaj kundër hajvanëve të tyre.
 Afrikanët, kush janë këta?
 Dhe çdo formë e barbarisë vazhdon, ajo provokon
 dijen njerëzore, ajo shkëlqen mbi arritjet.
 Është kulmi ynë i përbashkët.
 Dhe koha kur një fjalë e mirë është e nevojshme
 të dëgjohet në njërin prej secilit bulevard kudo në botë,
 ka ardhur.
 Kush dreqin do ta thotë?

* * *

Ai tha;
 - Nuk dua asgjë në këtë botë.
 Ajo qeshi;
 - As trupin tim.
 Burri piu pak birra
 dhe u çua nga shtrati.
 Nisi të shihte jashtë.
 Gruaja u çua pas tij.
 Ta dini, gjithmonë është gruaja
 ajo që shkon pas burrit në
 çastet, kur pikëllimi pushton çdo gjë.
 Një qytet dritash shtrihej para tyre.
 Jeta ishte një shumësi fragmentesh brutale,
 që shpesh nuk kishin një pikëtakim.
 Ai i tha;
 - Nuk duroj dot më.
 Ajo i tha;
 - Çfarë?

Burri e pa në sy gruan dhe pastaj
duke parë nga dritarja, tha;
- Mjerimin madhështor të qenies njerëzore.
Më pas fiku dritat.
Në mënyrë që të nesërmën
të ishte i freskët
për ta ja përsëritur vetes.
Derisa të ia lejonin fatet.

* * *

Kam harruar të shkruaj për
shishe të thyera parfumesh
nëpër korridore të errëta
që strehojnë dashnorët idhnakë.
Nuk bie më shiu i mallëngjimit,
nuk më ka shkuar në mendje
se dita me diell do të jetë
njëra ndër nevojat e mia.
Dashuria është një artefakt
në këtë muze të detyrimeve.
Trupi ngjitet si kërmilli
në pemën e mbijetesës,
ku të gjithë tregojnë
shenjat në fytyrë.
Të gjithë hamë
lulet që i dhurojmë.
Hy e dal në dyer
pa u futur fare,
duke admiruar mprehtësinë
e ujkut në male.
Sall e vetmja kënaqësi sublime është
kur më merr gjumi
para psikodelikës së
TV Baby.

EDICIONI X, VITI 2017

Arjola **ZADRIMA**



1. HUKATJE

Prej gjumit zgjohen të parat shqisat,
ndigjimi
nuhatja
trishtimi akut i qënies.
Ora ka një tik-tak të vazhdueshëm,
mendja e ndjek pa kuptim
në këtë vrapim drejt agut.
Truni fillon me dhanë
shenjat e ç'mpimjes.
Ndihem krejtësisht e vetëdijshme
se qielli kur zhytet në liqen
pasqyron kaq pastër
shpirtin tem,
e sa herë pulbardhat

përshkojnë këtë pasqyrim
 një shigjetë pa nishan
 ngulet në muskul.
 Mandej dita merr frymë.
 Asht ende dimër,
 sado i kuqërremtë të jetë qielli
 dashnia e hukatun ngrin.
 Tash, dhimbjen jam mësue me ia
 ngjitë jastekut
 ku prehen ende andrrat
 që pashë,
 e prej gjumit m'asht çue vetëdija,
 ajo që fle trishtë
 ende pa u zbardh,
 tuj më këshillue pa bzâ,
 mbështille mirë zemrën,
 asht ftohtë jashtë.

A po t'bjën n'mend për mu ?

Me ndje mungesën e një përqaqimi,
 e mos me e kërku,
 me ndje dëshirë me folë
 e mos me bzâ,
 me ndje një ofshamë në gji,
 e mos me kja,
 me ndje një mall prej larg,
 pa mujtë me e shu ,
 me ndje tue rrjedh një plagë,
 pa gjakue,
 me ndje kohën tue shku
 e mos me ju vu mbas,
 me ndje kaos
 pa zhurmue,
 me ndje stuhi,
 ortek në shpirt e mos me u ndi,
 me ndje një kputje pa çilë sytë

e kurrë mos me u anku,
me ndje një frikë të thellë
me të lanë pa frymu,
me ndje një dashni të naltë
e mos me e kallzu,
me ndje, me të ndje
me të dashtë e në gjys të natës
me u zgjue sa më të lshue za
veç pak,
tash qi trishtimin e kam në prag
a po të bjen në mend për mue?

Mos ki frikë BIR

Jeta asht ma e bukur se ndonji ditë
kur bjen shi,
e stuhia të ka zanë pritë.
Mëso me i jetu edhe ditët
gri,
mëso me i fshi lotët e nanës,
mëso me ja lidh flokët e thinjun,
ani pse shpirti ka plasë,
kur para një rrase prej mermeri
ke ofsha.
Mos ki dert me kja,
burrat e fortë e bajnë
e malet oshëtijnë,
lulet ulin kryet
e Zotit i vjen marre
për çka asht ba.
Mos ki frikë me vujtë, bir,
as me kujtue kur në biçikletë
të babës
ke shëtitë Shkodrën marë,
se kjo asht jeta,
nji dritë që shkëputet nga vdekja

nji andërr e bukur,
 nji dashni e thellë,
 e tash qi më pyt, nanë a je e lumtun,
 shihu në sytë e mi,
 shpirti më qesh anë e përtej,
 veç kur ti më merr në gji,
 Bir!

Bijës

Më paska marrë malli
 majegishtash
 me ti largu kaçurrelat,
 me të puth në ball.
 Më paska marrë malli
 për buçitje të hareshme në shtëpi,
 për dyer që hapen vrullshëm
 e symbyllë e di kur je Ti.
 Më paska marrë malli
 me të ndi,
 më t' i pa andrrat në sy tuj flakëru,
 me të dhanë krahë të lehtë,
 që ti me fluturu
 gzimesh rinore.
 Më paska marrë malli për diell,
 për aromën tande,
 për Ty,
 o frymë,
 o syth,
 o sy,
 o jetë,
 o e mira jeme!
 Më paska kputë malli
 me të shtrëngu në gji,
 e amla,
 Bijë.

Vinçens MARKU

(Përkthim)



JOHN C. McGALLIARD¹

University of Iowa

Hyrje mbi Letërsinë e Mesjetës evropiane

Periudha e Mesjetës, përafërsisht 500-1500 pas Krishtit, përfshin njëmijë vjet të historisë evropiane, që dallohet nga shkrirja në një e shoqërisë së Periudhës Heroike me kulturë greko-romake dhe e fesë së krishterë. Kjo erë vihet re mjaft mirë me daljen dhe zhdukjen e disa forcave masive. Ajo fillon me rënien e Perandorisë Romake në Evropën Perëndimore, një zhvillim që përputhet dhe pjesërisht shkaktohet nga vendosja e popujve gjermanë në territorin e perandorisë. Ajo përfundon me zbulimin e hemisferës perëndimore, me shpikjen e makinës së shtypit, me forcimin e shteteve kombëtare, thyerjen e unitetit fetar që solli Reformën Protestante, dhe ripërtëritjen, pas një hapësire rreth njëmijë vjeçare, të lidhjes së drejtpërdrejtë me artin, mendimin dhe letërsinë greke. Shekujt mesjetarë krijuan, ose të paktën ritrajtësuan, dhe na lanë trashëgim modele të tilla institucionale si Kishën e krishterë; shtetin

¹ McGalliard, John C. "Masterpieces of the Middle Ages *World masterpieces*. W. W. Norton & Company, Inc. New York, 1965. f.725-8

monarkik; qytetin dhe fshatin; rendin shoqëror evropian tradicional, “udhëheqës shpirtëror”, “udhëheqës laik”, me hierarkinë e fisnikërisë dhe shtresës së lartë, duke u radhitur nga duka tek kalorësi, dhe klasën e tretë ose ndryshe borgjezinë; universitetin; sistemin dhe metodën logjike të filozofisë skolastike; arkitekturën romanike dhe gotike; dhe një larmi të pasur të formave letrare.

Letërsia e Mesjetës së hershme pasqyron drejtpërdrejt dhe qartë jetën dhe qytetërimin e Periudhës Heroike. Figura kryesore është mbreti ose prijësi luftëtar; mjeshtëri e pëlqyer është lufta; qëllimet karakteristike janë pushteti, pasuria dhe lavdia; dhe virtytet parësore, si rrjedhim, janë trimëria dhe besnikëria. Krijimi letrar mbështetet mbi aktualitetin, nga i cili ai paraqet një lloj idealizimi. Në shoqëritë e hershme gjermane dhe kelte, mbreti sundonte një komb të vogël dhe kryesisht fisnor; ai dhe shoqëruesit e tij në luftë përbënin një klasë fisnike zyrtare ose jozyrtare, që kontrollonte jetën e popullit. Poemat e një shoqërie të tillë natyrisht tregonin në përgjithësi për luftimet e heronjve të mëdhenj, por edhe për profetët dhe këshilltarët e tjerë, të cilët i jepnin mendim atyre dhe për rapsodët që i argëtonin.

Përmasa dhe rëndësia janë pothuajse të njëjta në letërsinë irlandeze, skandinave dhe franceze të shekullit dymbëdhjetë. Pa dyshim, tregimet irlandeze dhe skandinave u formuan përpara se të ndihej ndikimi i krishterimit ose larg tij. Ato portretizojnë etikën dhe mënyrën e jetesës së vjetër pagane. Sagat e familjes islandeze tregojnë Periudhën Heroike në aspektet e saj më pak spektakolare: heroi është ende një luftëtar, si Hrafnkel, por ai gjithashtu merret me veprimtaritë më të rëndomta të bujqësisë dhe të tregtisë. Dhe ai nuk është vetëm, sepse ka shumë njerëz me ambicie të njëjta dhe jo pak me aftësi të barabarta, Thorgeir dhe Thorkel, për shembull. Në Islandën e shekullit të dhjetë çdo njeri i lirë mund të bëhej teorikisht një figurë e Periudhës Heroike. Heroi i *Këngës së Rolandit*, një vepër franceze e shekullit të dymbëdhjetë, ndërthur prijësin luftëtar, që i shërben mbretit të tij, me kryqëzatësin e devotshëm; edhe kryepeshkëvi Turpin është gjithashtu këshilltar shpirtëror dhe shembull si luftëtar.

Në letërsinë e shekullit katërmëdhjetë, luftëtari luan një rol më të vogël dhe asimilohet prej modelit më të përhapur të qytetërimit të mëvonshëm mesjetar. Kështu që tek qielli i Dantes vetëm njëri nga dhjetë qiejt hyjnorë - Marsi - zihet nga burrat e mëdhenj të armëve, të gjithë të krishterë të devotshëm, natyrisht. Kalorësi dhe shqytari i Çoserit janë vetëm dy, mes 29 pelegrinëve në rrugën e tyre për në Kantërbëri. Kalorësi i kushtohet

të vërtetës dhe nderit, fisnikërisë dhe qëndrimit të mirësjellshëm, ndërsa i biri, bashkë me virtytet përkatëse të një ushtari të ri, zotëron edhe ato të një dashnori fjalë bukur. Heroi luftëtar i Periudhës Heroike është bërë “nëpunës dhe aristokrat” i botës moderne.

Ky asimilim shkallë-shkallë i heroit kelt dhe gjerman në një qytetërim, në të cilin krishterimi drejtonte kulturën greko-romake tek qëllimet e reja, u bë i mundshëm nga uniteti dhe autoriteti fetar i Evropës Perëndimore. Njëmijëvjeçari mesjetar ishte në të vërtetë një epokë e besimit, edhe pse ishte larg nga të qenit një epokë e pasivitetit ose e plogëshisë fetare. Pjesa e parë e kësaj periudhe ishte e zënë me nënshtrimin e popujve të rinj të Evropës ndaj Krishterimit. Kur u krye kjo, kryqëzatat filluan një varg luftash të shenjta me qëllim për të çliruar Palestinën nga pushtimi pagan dhe, në përgjithësi, të mposhtin ose të shkatërrojnë ose t’iu ndërrojnë fenë paganëve ose muhamedanëve. Por mësimi i greqishtes dhe arabishtes dhe filozofia të cilën këta popuj jo të krishterë futën në Evropë në shekullin dymbëdhjetë dhe trembëdhjetë kërkon një vëmendje të madhe intelektuale. Mprehtësia e shpatës së kryqëzatësve duhet të krahasohet me mendjehollësinë e filozofit skolastik; një nga veprat kryesore të Shën Tomas Aquinit është një përmbledhje e parimeve në mbrojtje të Krishterimit “*kundër paganëve*” (*Summa contra Gentiles*). Krishterimi mesjetar nuk arriti kurrë të quhej i sigurt. Për katër shekujt e parë pas Kr., feja e re ishte agresive në mbrojtje; pas kësaj ajo do të ishte aktive në sulm si në sferën praktike ashtu edhe ideologjike. Megjithatë, në vetë Evropën Perëndimore ndërthurja e unitetit teologjik dhe autoritetit kishtar ishte një dukuri e pandeshur as para as pas Mesjetës. Perandoria romake kishte siguruar unitetin, ligjin dhe rendin politik për të arritur suksesin në veprimtaritë laike. Përveç kësaj, kishte lënë probleme morale dhe shpirtërore për t’u përballuar nga individit vetëm ose në grupe vullnetare ose etnike. Në Evropën mesjetare shpërbërja politike ishte në kulm; por nën udhëheqjen dhe drejtimin e Kishës u arrit një njësim mjaft i madh i qëndrimeve dhe idealeve shpirtërore, morale dhe intelektuale.

Komuniteti i kulturës evropiane në këtë periudhë ishte i tillë sa që prodhimet e vendeve të veçanta dukeshin si manifestime rajonale të një force bërthamore qendrore. Në përgjithësi, studentët dhe dijetarët lëviznin nga një vend tek një vend tjetër; murgj, abatë dhe ipeshkëv mund të dërgoheshin nga vendi i tyre i lindjes për të shërbyer ose drejtuar në vende të largëta; artistët dhe poetët endeshin në shumicën e rasteve në shpurën

e një padroni ose në kërkim të tij. Përveç gjuhës amtare, njeriu i edukuar mund të pritej të fliste dhe të shkruante gjuhën “standard” të përbashkët të Evropës, latinishten. Në një epokë kur shteti politik ishte relativisht i dobët, besnikëria më e fortë e një njeriu ishte për një individ, një sundues feudal, për shembull; ndaj një kodi, si ai i kalorësisë; ndaj një urdhri, murgjish ose fretërisht ose kalorësisht; ose thjesht ndaj vetë Kishës, nëse, si shumë njerëz mesjetarë me interesa intelektuale ai ishte një klerik i ndonjë lloji.

Këto lidhje, përveç feudalit, e ngandonjëherë duke e përfshirë edhe atë gjithashtu, ishin *ndërkombëtare* në natyrë. Në një atmosferë të tillë kulturore temat, subjektet dhe teknikat e artit e të letërsisë qarkullonin lirshëm nëpër Evropë. Arkitektura *gotike* e një ndërtese është aspekti më i rëndësishëm i saj sesa fakti që ajo u projektua dhe u ndërtua nga një shkollë ndërtuesish anglezë, francezë, gjermanë apo italianë. Vetë Krishterimi siguronte një subjekt të përbashkët për piktorët, skulptorët e të tjerë të panumërt, të aftë në artet grafike dhe plastike; historitë dhe skenat biblike kishin të njëjtin kuptim në çdo vend. Historitë e Karlit të Madh, Rolandit dhe Arturit, e Eneas, e Trojës dhe Tebës, ishin pasuri letrare evropiane. Ato janë përdorur dhe ripërdorur, kopjuar, përkthyer, përshtatur, zgjeruar, përmbledhur dhe në përgjithësi përvetësuar nga autorë të panumërt, që shkruanin në gjuhë të ndryshme, duke mos pyetur për të drejtën e pronësisë dhe druajtjet për plagjiaturë. Nuk kishte ligje për të drejtën e autorit dhe të shpërblimit të tij për të motivuar këmbëngulje mbi individualitetin e autorësisë; kishte krahasimisht pak interes për identitetin e artistit. Shumë poema dhe tregime mesjetare janë anonime, duke përfshirë disa nga më të mëdhatë.

Fshehja e artistit në veprën e tij shpjegohet pjesërisht, të paktën, nga sistemi mesjetar i vlerave njerëzore. Hierarkia mbisunduese e vlerave, siç kemi parë ajo nuk mbisundon universalisht, veçanërisht në letërsinë e Evropës Veriore, mbështetet mbi pikëpamjen e krishterë të njeriut. Njeriu, në këtë koncept, është një krijesë e Zotit, ndaj të cilit ai drejtohet në mënyrë të pashmangshme, por nga i cili ai ndahej nga kjo botë, në të cilën ai duhet patjetër të kalojë jetën tokësore, vdekatore. Qytetërimi njerëzor nën drejtimin e krishterë mund të shikohet si i projektuar në mënyrë ideale, edhe pse vërtet jo aq funksionues, për të ndihmuar njeriun në rrugën e tij në bashkimin me Zotin. Ky është kriteri për vlerësimin përfundimtar për të gjitha institucionet e shoqërisë dhe të gjitha modelet e kulturës. Prej këtu rrjedhin shkalla, rendi, kategoritë hierarkike të jetës dhe të mendimit mesjetar. Përderisa ana shpirtërore e njeriut del mbi

materialen, Shenjti bëhet ideal. Shenjti është një njeri, jeta e të cilit i nënshtrohet, asimilohet dhe i dorëzohet plotësisht shpirtërores. Mbi tokë ai mund të jetë një eremit, si Cuthbert-i; një reformator manastiresh, si Bernardi; një filozof dhe një teolog si Akuini; një mbret, si Luigji i IX i Francës; ose një njeri i thjeshtë me jetën private, si akrobati tek tregimi “Akrobati i zonjës sonë”. Përderisa bashkimi me Zotin, aspekti thelbësor i lumturisë në qiell, është një përvojë e shpirtit, jeta soditëse, e cila të përgatit për bashkim mistik, është më e lartë se çdo lloj forme e jetës aktive. Pra murgu, me anën e vokacionit të tij, ka një epërsi mbi priftin shekullor, meqë është edhe prift, në kushte të barabarta, në një pozicion shpirtërisht më të dëshirueshëm sesa ai i laikut. Në tërësi, letërsia mesjetare është një studim në jetën e njeriut, e gjykuar sipas kësaj shkalle vlerash. Kjo shkallë është paraqitur qartësisht tek *Komedia hyjnore* e Dantes. Modelet e vlerave shekullore asimilohen në të për shembull, te *Kënga e Rolandit*; ose mund të merret si e vërtetë pa e theksuar shumë, si në veprën e Çoserit. Por është gjithmonë atje, ose poshtë ose lart sipërfaqes. Për lexuesin modern ajo jep një fokus për leximin dhe kuptimin e mjaftueshëm të pjesës më të madhe të letërsisë së Mesjetës.

Erion **TEMALI**

DASMA PËRVËLUESE



Gjyshi nga nëna thoshte shpesh me një buzëqeshje të hidhur dhe melankolike: Çfarë ulqinakut jam unë kur nuk kam kenë asnjherë në Ulqin?! Dhe vdiq me këtë peng. Kurse nanadaja historinë e kishte edhe më dramatike: Jetonin në Krajë, krahinë shqiptare që kishte mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë nga pjesa e liqenit, në Mal të Zi. Meqë i kishte vdekur i ati, i ri, duke lënë gruan me katër vajza pa mbështetje, vinin dhe kalonin një pjesë të vitit në Shkodër tek xhaxhai. Dhe kështu, erdhi komunizmi dhe u mbyllën kufijtë, ajo me të motrën mbetën në Shqipëri. Nënë dhe një të motër nuk i pa më kurrë, kurse motrën tjetër e takoi vetëm dy herë gjatë gjithë jetës. Shkurt, ajo kaloi gjithë jetën me mall.

* * *

Ishte viti 2007. Një vajzë tezeje e nënës sime martonte të bijën dhe na kishte ftuar të gjithëve në dasëm. Bënte një i nxehtë i paparë atë korrik dhe dita e dasmës parashikohej të ishte shumë e nxehtë. Nisja do bëhej që herët për të evituar sadopak të nxehtin. E kështu u bëmë gati, me teze e me daja... dasmorë për në Tivar.

Mbërritëm në kufirin e Muriqanit në orën 7:00, të veshur e të zbukuruar si për dasëm. Dogana ishte e bllokuar nga rreshti pafund i makinave që donin kryesisht të hynin në Shqipëri. Zbritëm nga makinat

për të dorëzuar dokumentet. Bënte një i nxehtë i paimagjinueshëm: nuk lëvizte gjethi, gjinkallat këndonin ose qanin me zell, pas pak minutash e ndjeva djersën që më rrëshqiste përgjatë shpinës dhe nuk ndalej... nuk dëgjohej shprehje tjetër nga të pranishmit, vetëm “Çfarë të nxehti”. Për fat burri i njëjës teze i njihte doganierët malazezë, dhe na i kryen procedurat shpejt. Gjysmë ore pritje në të dy anët e kufirit na doli e teproi për të na paralajmëruar se do bënte një i nxehtë ferri, por të gjithëve na ngushëllonte mendimi se vendi ku do bëhej dasma do ishte një lokal i madh me ajër të kondicionuar...

Rrugët e Tivarit ishin gati të shkretuara, megjithëse ishte paradite. Shpresa jonë që dasma do zhvillohej në një lokal me kondicionerë të mëdhenj, ku do të bënte aq fresk sa do detyroheshim të dilnim here pas here jashtë për t'u ngrohur pak, filloi të venitej kur na thanë se do shkonim tek shtëpia e nuses... Por mendonim: do takonim miqtë e shtëpisë dhe pastaj do shkonim tek lokali me emrin Alaska ose Himalaja, ose, ose... Iu futëm rrugëve dytësore që ngushtoheshin vazhdimisht, deri sa dolëm diku në periferi të Tivarit në një zonë me shtëpi njëkatëshe me kopshte dhe fruta, por që karakterizoheshin nga mungesa e theksuar e hijeve... mbërritëm tek shtëpia e miqve. Kishim ardhur të parët ndër dasmorë. Shkuam dhe takuam njerëzit e shtëpisë dhe të fundit, nusen. Të gjithë dukeshin të lodhur dhe të shterruar, përveç birit që i shpërthente adoleshenca ngado: një shpërqendrim i qëndrueshëm dhe i gëzueshëm, shtatëmbëdhjetëvjeçar. Më e lodhura dhe e shterruara dukej nusja. Mora vesh se kishte kaluar një sëmundje dhe sapo kishte filluar të përmirësohej. Disa të afërm që flisnin gjysmë sllavisht dhe gjysmë shqip, na ftonin të uleshim në tavolina që i kishin vendosur në mes të oborrit në pishë të diellit, neve, dasmorëve që kishin ardhur nga larg. Na sollën pije freskuese, por të gjithë kërkonin: ujë, ujë, vetëm ujë. Mbasi u zhdëpëm në ujë, filluam të pinim dhe pije freskuese. Nuk kishte shenjë gëzimi dhe hareje, as muzikë nga magnetofonët, as orkestër ose aheng-xhi. Nuk vonoi shumë dhe erdhën edhe disa të ftuar të tjerë. Ishin shqiptarë të Malit të Zi. Edhe ata të djersitun, me frymëmarrje të vështirë dhe të deprimuar, por të përgatitur për atë që i priste, pra rrinin më serbes dhe natyrshëm. Pas çerek ore, dikush dha mendimin që të sponstonim tavolinat aty ku disa hardhia të lodhura, gjysmë të thara bënë një hije sa për bé. Ashtu bëmë. Filluan të shërbenin miqtë kamarierë: Pjata të bollshme, pilaf me mish, pure dhe disa gjellë të tjera që lëshonin avull si në mes të acarit... duhej të ngroheshim ngaqë

kishim ftohtë dhe të shuanim urinë që të shkaktonte dimri i egër... Çdo pjatë që sillnin, i shoqëronin me fjalët: “Hani! Nginiu! Dhe ca fjalë të tjera sllavisht. Tortura kishte filluar! Isha në merak për nënën që vuante nga tensioni i lartë.

Zhvendosja e tavolinave pranë hijeve të lodhura, vetëm sa kishte krijuar një iluzion freskie, aq sa zgjasin zakonisht iluzionet. Dalëngadalë kishte kaluar mesdita. Unë shkëputesha ndonjëherë nga dasmorët dhe bisedat e tyre apatike dhe të fjetura dhe dilja nëpër kopshtet që ishin të mbjella me mollë. Këputja ndonjë mollë akoma të papjekur, ashtu të ngrohtë prej të nxehtit përvëlues. Rrap – çap, ishte krijuar një atmosferë zhegu. Të gjithë të rraskapitur nga i nxehti, dukeshin si të fjetur, herë pas here ndokush lëshonte ndonjë batutë sporadike, por që shuhej pa krijuar hare. Avash – avash, si pa e kuptuar, të gjithë u ishin afruar gardhiqeve anësore të oborrit, aty ku kishte hije, duke lënë kështu tavolinat vetëm. Po torturoheshim si më të mirët dhe kjo gjë më acaronte. Por nuk kisha çfarë të bëja, në kushte normale do ia kisha mbathur me kohë nga kjo situatë absurd, por kishte shumë njerëz, që kush e di se kur do i takonim përsëri? U duhej bërë respekti për hir të të parëve tanë! Problemi është se kur je në moment vuajtjeje, duket sikur ato moment nuk kalojnë kurrë, dhe për mua gjithë ai të nxehtë zhuritës më dukej sikur nuk do kalonte kurrë. Shikoja të afërmit e mi, nënën (më qëndrestarja!), tezet dhe burrat e tyre, dajat me gratë e tyre, të gjithë të deprimuar, të rrasur nëpër gardhiqe si delet në zheg, me kollare të zgjidhura e tesha gjysmë të shkopsitura për t’u ajrosur sado pak. Kisha edhe nerva edhe më kapte gazi... por ndjeja edhe lodhje, ndizja cigare se më dukej sikur harroja gjithë atë komedi të nxehtë përvëlím, por ishte më zi! Aty nga ora një e gjysmë, u dëgjua një zë: Po vij në krushqit! Dhe ja, avash – avash, në marsh për dy, burra e gra që priheshin nga një djalosh me flamur në dorë dhe një burrë që i binte firzamonikës dhe këndonte një këngë të avashtë në sllavisht, taman këngë zhegu! Më thanë që flamuri ishte boshnjak, sepse dhëndrri i cili ishte nga mesi i rreshtit, ishte boshnjak. Erdhën aty, u rrotulluan nëpër oborr, në rresht për dy, duke kënduar atë këngën e tyre tradicionale, ndërkohë që ne po i këqyrnim për seri! Më jepej të këpusja një mollë dhe ta ngulja në majë të shkopit të flamurit që ishte si heshtë... nuk kisha dëshirë tjetër përveç dëshirës që të mos isha fare aty. U ndalën. Ata që ishin prindërit e dhëndrit, u takuan, u rrokën dhe u puthën me prindërit e nuses. Mandej erdhën dhe u përshëndetën me ne. Nuk u ulën ndër tavolina, por vazhduan ta këndonin atë këngën

e fjetur të zhegut me fizarmonicistin që u printe në fillim të rreshtit bashkë me flamurtarin. Mandej doli nusja e shoqëruar nga prindërit dhe vëllai. U takua me dhëndrin dhe bënë një gjysmë përqaftim të çuditshëm. Para shkallëve të shtëpisë ishte tryeza me pajën e nuses dhe në anë të saj një turrë me peshqir të mëshenj me ngjyra të ndryshme. Njerëzit e nuses filluan t'i vendosnin nga një peshqir çdo krushku ndër supe, kurse një peshqir që simbolizonte dhëndrin e lidhën tek shtiza e flamurit; fill poshtë tij, lidhën peshqirin tjetër që ishte i nuses. Pyeta tezen time të preferuar (njeri që gjithmonë reflekton freski në pamje dhe mendime) që e kisha në krah: “Ç’u duhen gjithë këta peshqirë, vallë?” më tha duke buzëqeshur: “Me fshi djersën, për ça tjetër!”. Të gjithë po prisnin me padurim që dasma të mbaronte e t’ia mbathnin ndokund në hije. Dëgjova një fërkim të njohur metalik, thashë me vete: Jo-jo-jo, jo me pistoletë tash! Kur ja, një djalosh gjuajti me pistoletë të madhe të kromuar, disa herë në ajër. Nuk pati asnjë farë përfilljeje nga askush. Bëmë disa foto me çiftin dhe të afërmit përtej liqenit.. krushqit u nisën mandej me nusen me makina, kurse ne u përshëndetëm me miqtë dhe u nisëm në drejtim të kundërt me krushqit. Ndihehim të gjithë të çliruar, por një parandjenjë më thoshte që marrëzia akoma nuk kishte përfunduar. Rrugës morëm vesh që na kishin ftuar tek një vilëz, ne miqëve që kishim ardhur nga larg për të ndenjmur në fresk, aty kishte hije dhe pishinë. Vila ishte në një bllok vilash poshtë një mali, jo krejt poshtë, nja njëqind metra lartësi. Po shkojmë në këmbë, - na thanë. Daja i madh ishte më këmbëngulësi. I nxehti vazhdonte të ishte i tmerrshëm. U ngjitëm tek vila. Për çudi, ishte e mbyllur. Pritëm pak... Brenda dalloheshin pemë të mëdha me hije dhe pishina me ujë të rrjedhëm. Pritëm e pritëm, por asgjë. Oazi i mrekullueshëm ishte aty, por derën nuk e hapte kush! Kur i bie dajës celulari dhe marrim vesh që po na prisnin lart tek xhamia. – Ku asht xhamia? – pyeta. – Në gjysmë të malit, dhe rruga bëhet veç në këmbë, se makinat nuk kanë ka me kalu! – më tha daja me një ftohtësi që nuk freskonte aspak. – Po, a ban mos me shku?! – i thashë. Jo, se i kena dhanë fjalën, nuk kena ça me bâ tash! – thotë daja i madh. Kështu pohuan edhe disa të tjerë. Tunda kokë në shenjë habie. U ngjitëm nja njëzet metra dhe pashë se si filloi t’i rëndohej frymëmarrja nënës dhe disa të tjerëve në moshë. U ndala dhe iu drejtova të gjithëve: Ju jeni të çmendun. Unë me nanën po kthehena, nuk dona me përfundu në spital kot.

Kaq i thashë dhe krisi shamata, një palë që donin të avanconin dhe një

palë që donin të ktheheshin, për fat, numri i debatuesve ishte i barabartë dhe debati u ndez. Si përfundim, pala që donte të kthehej deklaroi: Ne po kthehen, ju bani ça të doni!

Kur e pa që nuk kishte çfarë të bënte, daja i madh tha: Hajt n'fe t'sams. S'jena tu ia ba mirë, veç!

Askush nuk i vuri më vesh, por filluam të zbrisnim duke shijuar lehtësinë e zbritjes dhe të hijeve të lehta të disa pemëve frutore anës rrugës. Shpejt mbërritëm tek makinat dhe u futëm menjëherë brenda. Dikush dha idenë fantastike që të shkonim në det për t'u freskuar. Vendosëm të shkonim në Ulqin. U nisëm dhe për gjysmë ore e gjetëm veten në plazhin e vogël të Ulqinit. Kush me rroba banje dhe kush me rroba dasme. Të gjithë u futëm në det. Ishte një çlirim madhështor, triumfues dhe i freskët ndaj të nxehtit dhe marrëzisë së asaj dite. Unë ndenja rreth gjysmë ore në ujë. Çuditërisht, kisha akoma fuqi për të notuar. Shkova larg për të shijuar edhe më shumë freskinë e ujit. Pasi u freskuam mirë e mirë, pushë buzëqeshje gëzimi në fytyrat e secilit... edhe batutat më të rëndomta krijonin humor dhe ilaritet! I kishim shpëtuar për mrekulli të nxehtit përvëlues dhe ngjitjes në mal. I hodha një sy vendit përreth... mandej bëmë një xhiro nëpër qytet. Gjatë gjithë shetitjes u përpoqa ta shihja qytetin me syrin e zemrës së përmalluar të gjyshit. E ndjeva praninë e tij gjithkund atje.

EDICIONI XI, VITI 2018

Andreas DUSHI

SHOKU YT, BABA



Përgjatë historisë, nuk besoj të ketë ndodhur ndonjë proces më vështirë i realizueshëm sesa emërtimi i ndjenjave. Si është shpjeguar për herë të parë frika, aq sa të gjithë të vendosnin ta quanin njëlloj? Po mërzia, lumturia e sa e sa të tjera? Nëse bini dakord (njëri me tjetrin se me mua kurrë!) që edhe dashuria është ndjenjë, atëherë themi lehtë se ky proces nuk ka mbaruar, por le ta lëmë jashtë kësaj trajtесе *artistike* këtë temë, frymëzuesen supreme të *artit* në tërësi.

Kur njeriu ka ndjerë mall për të parën herë, si ka qenë? Për kë u krijua kjo ndjenjë? Besoj një vetëdije shoqërore e ka pasur, padiskutim. Ndoshta edhe intelektuale, sepse t'ia dalësh të krijosh me dikë një raport intim, duhet ta perceptosh mënyrën e tij të të menduarit. Pastaj, pavetëdija afektive u vendos këmbën në grykë të gjitha vetëdijeve dhe malli buron diku nga frymënxjerrja plot vështirësi. Si tymra të bardhë (u zgjodh Papa?!) ngërthehen të gjitha, aq fort shtrënguar sa të mos shquhen dot.

Nuk di të them nëse sa po shkruaj është *tregim* a *sprovë*. Besoj të jetë një rropatje për të rrëfyer diçka të vërtetë fshehur në personazhe me kompleksitet të dyshimtë, ndërtuar me pendë nga flatrat e shumë kerubinëve.

Në Shkodër, një djalosh në klasën e gjashtë, i bie diku dymbëdhjetë vjeç, nuk kishte shokë. As shoqë. Askënd! Në klasë, ulej për kra

psherëtimave plot bezidsje. Në oborin e pallatit, ulej përkrah oshtimave plot tallje. Vetë as nuk psherëtinte, as nuk oshtinte. Veç rrallë, ndonjëherë kur qante me të madhe dhe lotët i rridhnin mbi firmën e dalë nga psherëtimat, për tu nisur mandej kushedi se ku, shtyrë nga forca e oshtimës. Por kjo i ndodhte kur ishte vetëm. Të qartësohemi: pse nuk kishte shokë e shoqe, nuk do të thotë se gjithmonë ishte vetëm. Herë pas here, ulej kërrusshëm në prehrin lëndëfole të të atit. Nga aty, bisedonte më shumë se dëgjonte dhe shpresonte më shumë se mendonte.

Djaloshit shkodran pa shokë, flokët ia rregullonte i ati. Tani, meqë nuk jeton më në Shkodër (te shokët s'është se ka ndonjë ndryshim të madh), flokët nuk i rregullon. Ai, veshjet i blinte me të atin dhe edhe tani, po me të i blen. Nën vështrimin ngjyrëshpresë të së ëmës, hante me të atin, ndërkohë që ajo ngrihej herë pas here për të sjellë sa një gjë, një tjetër. Sa i mungojnë djaloshit këto dreka.

Djaloshi u rrit e u bë adoleshent. Sikurse thashë, shoqëria s'pati ndonjë ndryshim të përmendshëm, por kjo nuk e shqetësoi. Kuptoi se shoqëria ishte përjetim dhe si i tillë, mund të gjendej në çdo njeri. Ai e kërkonte dendur jashtë familjes, sepse afrimiteti me to i ngjante natyral, rrjedhë normale e përroit të rrëmbyer të jetës. Por lexoi, mësoi dhe formësoi në mendje përqsasjen e saktë të shokut. Atëherë kuptoi se asnjë çast s'kishte qenë pa të, madje gjithnjë pranë e më pranë tij. Filloi t'i thoshte vetes se rrobat s'po i blinte me të atin, por me shokun, sikurse pjesa më e madhe e djemve të rinj bëjnë. Në atë kohë, djaloshi u dashurua për të parën herë. Kujt i tha? Sigurisht, shokut!

Çfarë shoku! Ai la keq veten për t'i plotësuar nevojat djaloshit. Hiqte dorë nga argëtimi i tij që të argëtohej e dashura e djaloshit për të lumturuar djaloshin. Sepse ai e dinte se djaloshit lumturia i rrinte në sytë e së dashurës! Sepse ai e dinte se djaloshi ishte budalla pasi e ndërtonte kështjellen e buzëqeshjes me rërën e së përkohshmes. Kur dallga e zhgënjimit e rrënoi atë, shoku i ndenji pranë.

Mëngjeset e vrenjtura sillnin kumte vetmie nga dritarja e dhomës së djaloshit. I ati i sillte librin e fundit të Michel Houellebecq. Dedikimi në faqen e parë: Nga shoku yt, Baba!

Njësimi i shokut me babën është aq i hershëm, sa kujtesa e djaloshit në tentativë për tu burrrëuar e shpreh paqartësisht në këtë tregim sprovë. E gjitha ndodhi me shpejtësinë e dritës, por edhe me butësinë e kalimit të saj mospërmas xhamit: ndikoi aq shumë pa cënuar asgjë! Edhe unë, ç'a tipi kam, flas në kohën e shkuar, thua se tani nuk ndikon!

Tani kur është larg nga shoku, djaloshit i është mbyllur në mendje një bylbyl plot vajë malli. Kënga e tij është aq e bukur për frymëzimin, sa është kob për atë vetë. Aq thellë në shpirt tejshpon sqepi i dëshpëruar i bylbylit, sa thërrmon edhe cipën e asaj farës së përbotshme e të përhershme, të gjendur pavarësisht veçanësisë së çdo njeriu diku thellë në bërthamën e qenies... Asaj fare që në brendi ruan grimcën e padukshme që bashkon të gjithë njerëzit e të gjitha kohërave, e cila brendashkruar ka materialin transhendent që na njëson me të gjithë frymorët e tjerë. Diku në orbitat e saj sillet trupi i pajtë i mallit. E mu aty, djaloshit i jeton shoku i tij, Baba.

Jetohet dot pa ujë? Aty, djaloshi nuk lejon të ketë qoftë edhe një pikë, sepse do që banorët e atjeshëm të largohen sa më parë. Të kërkojnë vendqëndrim në një tjetër orbitë, aty pranë por edhe larg, para se të treten në harresë. Shoku i tij, Baba është i ri dhe krejt i përkohshëm aty, këtë e di dhe djaloshi por prap: i duket padrejtësi të mbajë mbi shpatullat e zemrës qoftë edhe një çast ndjenjën e mallit për të atin.

Djaloshi mendonte se ishte shkrimtar. “Do të” vështirë ta thoshte sepse për të, e ardhmja është realitet i pakuptimtë, ashtu sikurse çdo e paqenë tjetër. Mandej, u bë me të vërtetë shkrimtar. Nga kush? Nga se? Vështirë ta thoshte, nuk e dinte! Pikërisht kjo është arsyeja pse u largua nga i ati: në një shkrimtar, ndikimi i të atit duhet të jetë shkërmoçës. E bezdiste shumë mbështetja e tij e edhe më, e shqetësonte gëzimi i tij për arritjet e të birit. Me domosdo, donte të kishte një Herman, pasi mendonte se veç ashtu mund të bëhej Kafkë. Por harronte se mes tij dhe Francit, lidhjet jetonin veç në vdekje.

Sërish, ai nuk ka shokë. Jeton mes katër mureve ngjyrë panë brenda të cilëve nuk ka asgjë të ëmbël, veç hidhësi vetmie. Nuk mendonte asnjëherë se kryeqyteti do të qe një *kalvar*¹ nëpër të cilin duhej kaluar pa asnjë *Simon Cirene*², me vështrimin e ngulur në Golgotën pa kryq. Simoni i qe dërguar Krishtit nga Ati. Po djaloshit, kë do t’i dërgojë i ati?

Nuk mendoj se *atësia* është një atribut i kotë a i rastësishëm i Zotit. Këtë mënyrë të menduari ma ka formësuar shoqëria me djaloshin. Shoqëri e largët, platonike e ndërtuar në substancën e paperceptueshme prej shqisave e cila ruhet në cipën prej vese të shpirtit. Sikur shpirti i djaloshit të qe me të vërtetë gjethe, e jeshilta prej klorofili domosdo do

¹ Rruga që përshkon Krishti me kryqin në shpinë kur ngjitet drejt Golgotas, Malit të Kafkës në të cilin kryqëzohet.

² Burri i cili ndihmon Krishtin të mbajë kryqin gjatë rrugës për në Golgota.

t'i buronte nga empatia për shokun e tij, Babën.

I ati i dërgoi vetveten. Sa herë kishte nevojë për diçka, prania e tij nuk e ngushëllon, por e ndihmon, e plotëson. Kur në ajrin prej bloze të kryeqytetit djaloshi hap sytë, pasi një rreze e lehtë malli për Shkodrën i përshkon atë pjesë që akoma vijon të ëndërrojë mbi vargun e Koliqit "ajri krilstaluer i Shkodrës", këmbanat bien me vrull në këmbanaren që mend e kap me dorë nga dritarja. Sa i ngjan e gjitha me zërin e të atit. Vallë do ta mendonte Vivaldi se qashtërsia e lakores së muzikës së tij, ndonjëherë do të mund të luhej prej këmbanave të rënda? Po baba, vallë e ka menduar se prania e tij e pupëlt dhe e përgjinjeshme pranë djaloshit do të tregohej në rëndesën kërrusëse të një tregimi? Nuk besoj!

Djaloshi tani dëshiron vetëm diçka: Ta gëzojë të atin. Po të mos e bëjë, shoqëria mes tyre i ngjan e pasinqertë. Ai vetëm merr, pa dhënë asgjë, asnjëherë. Dhe është me shumë fat, sepse shoku i tij, baba, gëzohet shumë thjesht. Një kafe në mëngjes, buzë rrugës ku sa herë shkel, shkërmoç gjethet vjeshtarake të kujtimit. Një drekë gjatë së cilës shohin veten të pasqyruar mbi sipërfaqen e liqenit të qytetit, me cënime të rralla falë valles së ndonjë peshku. Një darkë me pak verë të kuqe nën qiellin ku e bardha e yjeve puplohet rreth ndriçimit të hënës. Kaq... Një ditë e tillë për kushedi sa vjet përkushtim të kryer për hir të dashurisë.

Tani kam pjesën më të vështirë të tregimit. Djaloshi më ka kërkuar t'ia përshkruaj të atin! E shoh qartë, sa herë dua, kur sytë i drejtoj në një bimë shtatlartë që rron në parvazin e jashtëm të dritares së shtëpisë së djaloshit. Sepse atë bimë, ai ia ka dhënë. Është aq e gjelbër, sa shpresa e pashuar për më mirë, më mirë, më mirë.

Jo, nuk mundem! Ndoshta ndonjë teoricient, fragmentin e mëposhtëm e quan *postmodern*, sepse unë si autor largohem dhe vendin ia lë personazhit. Nuk mundem dot ta përshkruaj shokun e djaloshit, babën... Le ta bëjë vetë djaloshi!

(çka djaloshi tha, nuk më pëlqeu, ndaj po e heq, po e fshij. kam përshtypjen se atë, shokun e tij, babën, është më e lehtë ta imagjinosh sesa ta tregosh)

Dhe unë, duhet ta lë me kaq sa nuk më ka thënë djaloshi t'i shkruaj edhe për të ëmën. E di se do ma thotë, por një tjetër herë. Sot le të njihni shokun tim, babën! Dua të them, shokun e djaloshit... Se mos mbeti ndonjë prej jush pa e kuptuar këtë alterego të paalegori.

Skender **TEMALI**



"BANKA" E SHKODRËS

Shkodrën në shuplakë të dorës e kam,
Shkodra më ka në shuplakë të dorës,
Jam denbabaden i kshtenë dhe mysliman,
Lindun në rranjë e petale t' luleborës.

Lindun në rranjë të lisit të lirisë
Në degët e t' cilit s' pushon korbi, por shqiponja,
Ku mësova me gjak t'vadis tokat e Ilirisë
Rrethue nga malet plot mite e gëzhonja.

Edhe pse gjysh, tamlin e Rozafës përditë e pi,
Si pinjoll i Barletit e idhull i Migjenit të sjell një risi,
Do kem djep Liqenin që më përkundë me valë,
Jaret si arie që ma mbajnë shpirtin gjallë!

U mplaka, u zbardha, kuletën s'e kam plot
 Ti Shkodër më ban ma të pasunin në glob,
 Sa askush, jo-jo askush s'më ban karshillek
 Se kam Banken tande plot me zotnillek.

Shkodër, bijë e Krishtit dhe e Muhametit,
 Të puth ballin e ndritun e trinen e dorës,
 Ti që i jep forcë e shndrit fjalën e poetit,
 Të lindun në rranjën e shpirtin e luleborës!

Shkodër, 4 janar 2020

CIGANKA

-baladë-

S'qe Tanusha, bij' e krajlit,
 As sorkadhe zbrit' prej malit,
 Hën' e plotë në mes të natës
 M'u shfaq vajza e kurbatkës
 Sa m'i luajti mendt e kresë
 Lëjla, kjo panter' e zezë!

N'një rrasë guri rrobat lante,
 Her' këndonte e her' qante,
 I këndonte dashurisë,
 I vajtonte varfërisë,
 Këndo e qaj, qaj e laj,
 Herë janar e herë maj!

Jetë e saj si çdo cigan
 Herë puhiz e herë tufan,
 Pa themele të një shtëpie,
 Përplasur si zog stuhie,

Vilë mbi vilë një sharabajkë,

Léjla, Léjla moj kurbatkë.
Léjla, Léjla, Léjla, Léjla,
Sy jeshilja, kaçurrelja,
Seç u çmenda prapa saj,
Si ajo: këndoj e qaj!

Dhe një ditë, si çmos kurrë,
I dal para, bëhem burrë,
"O moj Léjla, Léjla, Léjla,
Ka një javë pas teje ngela,
Ma ke ngritur zemrën peshë,
Robi yt jam, o princeshë!

Moj cigankë, si yll drite
Jetën time seç ma ndrite,
Ç'ma rrëmbeve dashurinë,
sy jeshilja si rudinë,
M'le pa gjumë e më harbove,
Re puplore n'qiell m' çove.

N'vend të shtratit bërë me thupra
Të afrojt një shtrat me pupla,
N'vend t'karrocës shtegëtare
Një "Ferrari" shigjetare,
Për ty krejt do zbras kuletën
Sa n'avione ta çosh jetën".

Por ti qesh e qesh me mua:
"Më gënjen kur m'thua t'dua,
Në më daç, vjen në breg lumi
N' krahë të mij të të zërë gjumi.
Gjithë ç'ofrove s'vlejnë sa unë,
Se ku linda do të vdes,
S'rron zgalemi pa furtunë,
Tjetër fat në jetë s'pres!

Se n'kaçore kam jaranin,
Një xhambaz e trim me fletë,
Ku me arna kam jorganin
Po nën të parajsën vetë!
Prandaj ik, o çun qyteti,
Çup' mamaje shko e gjej,
Se të ishe dhe djalë mbreti
Me xhambazin s'të këmbej!"

Léjla, Léjla, Léjla, Léjla,
Rob i yti qeshë e ngela!

Edlira **LLUKAÇAJ**



KOHA ME IKË

Koha me ikë, shpirt, koha me ikë,
Koha me gjetë në qiell at'yllin që shndrit
E difton kah, për tën që jan tuj pritë.

Koha me ikë, shpirt, koha me ikë,
Me lë duart nën gurrat e dhimbjes
E mandej në fytyra t'errta me i fshì,

Koha me ikë...
Ka kohë që e pritshim, kohë që e ndijm,
Me fjalë shtrojm rrugët drejt mallit të ri
Me mall mbulojm deluzionin, shpirtin e grim

S'ka mà kohë lamshet me zhdavaritë,
E as me shkrù s'parit historitë,
Fatet janë në ballë, e drita, në shpirt,

Koha me ikë...

N'AT GRIMË BOTE

N'at grimë bote që m'ka rà për hise
Përdit vadis një lule t're shprese,
Herë çil, herë nuk çil...
Përdit një rè t'bardh e bëj fjongo mbi buzqeshje
Edhe pse 100 hërë dhimbja prap ma ngrin...

Kur drobitem,
Marr syt e një fëmije uhà
Qiellin s'parit me e pà,
Me u shendù e me u shkri n'gaz,
A aromën e blinit e mbështjell
Rreth çdo gjàje që vjen erë
E t'ndytën me mu ngjit s'e là...

Kur venitem,
Kërkoj një diell,
Prej fillimit mu e botën teme me e ndriçu
T'bukrën e t'shndritshmen me e nxjerr n'pah
Errësinën me e largù...

N'at grimë bote që asht e jemja,
Me vargje poezish i kam shtrù rrugët,
Trishtimin e nxjerri jashtë, e shkeli me kàmbë
Me fjalë, gurt nisi me pikturu
Derisa t'marrin ngjyrën që du un
Derisa t'kthehen n'rrugë, në zemër me m'çu...

E kur lodhem
N'jastekun e andrrave ma t'bukra mbështes kryt,
Në paqe t'plotë me vedin
Këndoj kàngën time, atë që veç un e di,
Derisa më mbyllen syt
Derisa tan çka kam pà e çka kam ndi
Kthehet n'hì

N'at grimë bote që m'ka ra për hise
Përdit nadje hapi syt,
Me jetu prej fillimit
Me dasht prej fillimit
Me buzqesh prej fillimit,
E prej fillimit Botës me i ik...

DIMNI NA RA PËR HISE

Qyshse burrat e mìr
Fjált e mira vunë mbi shpìnd
E n'brez rrokën burrnìn
E ikën matàn...

Qyshse rrànj't edhe ihèr hynen n'dhè
E gjethet mbeten t'lehta, trungu-kërcù u bà...

E gràt e mira u brengosën
Nderin e morën me vedi
E kur ikën, as hijen mbrapa s'e làn...

Dimni na rà për hise qysh at'hèr,
E legjendash u rrejtëm
Me mujt me shù mall...

VEÇ UJI SI HESHT

Veç uji si hesht...

Era e zhurmshme,
Shiu rrëmujë,
Tuj gërsitë bijnë

edhe gjetht',

Sa ftòft..
Sa shkodër..
Sa vjèshtë..

Nàntdhjèt e nànd zogj
Kan mùjt me u tubù e me ik rresht-
Nàntdhjèt e nànd fmij'
T'shpërndàmë nëpër glob, pa kërkhënd.

Mu duk se diçka deshta me thànë
Po ma mìr po hesht.

Sa ftòft..
Sa shkodër..
Sa vjèshtë..

Qamil GJYREZI

REFLEKSION, "HYRJE NË MUZIKOLOGJINË KONJITIVE" TË NIELS TRUSBAC HAUMANN



Studimi "*Hyrje në Muzikologjinë konjitive*", të autorit, *Niels Trusbak Haumann*, është një punë me vlera shkencore në këtë nëndisiplinë bashkëkohore, me të ardhme premtuese.

Ndër të tjera, autori shkruan në përfundimet e këtij studimi: "Prandaj, unë argumentoj që Muzikologjia Konjitive është një qasje premtuese, bashkëkohore ndaj psikologjisë së muzikës, me themel të fortë historik" (Haumann 2015). Psikologjia muzikore, ose psikologjia e muzikës, mund të vlerësohet si një degë e psikologjisë dhe muzikologjisë. Ajo synon të shpjegojë dhe kuptojë sjelljen dhe përvojën muzikore, përfshirë proceset përmes të cilave muzika përceptohet, krijohet, përgjigjet dhe përfshihet në jetën e përditshme.

Niels Trusbak Haumann PHD, (*Post-doktoraturë*) është kërkues teknik në *Universitetin e Aarhusit* dhe në *Spitalin e Universitetit të Aarhusit* në Danimarkë. Autori sjell në studimin e tij, hulumtime gjatë ekperiencës, për sa i përket kërkimit shkencor, si dhe studimeve akademike ndër vite, në zhanret: muzikologji, psikologji, neurologji, si dhe të shkencave kompjuterike.

Metodat e kërkimit shkencor marrin një rëndësi të veçantë në këtë studim. Trajtimi i metodave të kërkimit shkencor i jep gjithashtu një

ndihmë të rëndësishme kriterit dhe kërkimit shkencor edhe në disiplinat e tjera shkencore të lidhura me muzikologjinë konjitive. Autori shkruan: "*Nëse një teori nuk është testuar në mënyrë empirike, besueshmëria e teorisë është e pasigurt. Hipotezat specifike, ose pretendimet e provueshme, mund të nxirren nga teoritë dhe këto hipoteza mund të testohen me metoda sasiore empirike. Një nga llojet e metodës empirike është edhe analiza sasiore e muzikës*". Metodat empirike cilësore përdoren në një masë më të vogël në kërkimin empirik, në muzikologjinë konjitive.

Theksi metodologjik në muzikologjinë konjitive.

Zhvillimi *historiko-shkencor* i psikologjisë së muzikës si një supozim për muzikologjinë konjitive prezanton *konceptet* dhe *metodat teorike* për vëzhgimin e mekanizmave psikologjikë në themel të muzikës. Muzikologjia konjitive mund të dallohet nga degët e tjera të *psikologjisë muzikore* përmes *theksit të saj metodologjik*, duke përdorur *modelimin kompjuterik*, për të studiuar përfaqësimin e njohurive të lidhura me muzikën, me rrënjë në *inteligjencën artificiale* dhe *shkencën konjitive*. Përdorimi i modeleve kompjuterike siguron një *medium* të saktë, ndërveprues, në të cilin mund të formulohen dhe testohen teoritë. Kjo fushë ndërdisiplinore hulumton tema të tilla si paralelet midis *gjuhës* dhe *muzikës* në tru. Modelet e llogaritjes kompjuterike të frymëzuara *biologjikisht* përfshihen shpesh në kërkime, siç janë *rrjetet nervore* dhe *programet evolucionare*. Kjo fushë kërkon të modelojë sesi përfaqësohen, ruhen, përceptohen, performohen dhe gjenerohen njohuritë muzikore. Duke përdorur një mjedis të kompjuterit të strukturuar mirë, mund të vëzhgohen strukturat sistematike të këtyre fenomeneve konjitive. Edhe ndërsa shijoni *meloditë më të thjeshta*, ka procese të shumta të trurit që sinkronizohen për të kuptuar atë që po ndodh. Pasi stimuli hyn dhe i nënshtrohet përpunimit të veshit, ai futet në *korteksin dëgjimor* (auditory cortex), pjesë e *lobit temporal* (temporal lobe), i cili fillon përpunimin e tingullit duke vlerësuar *lartësinë* dhe *volumin* e tij. Nga këtu, funksionimi i trurit ndryshon midis analizës së aspekteve të ndryshme të muzikës. Për shembull, ritmi përpunohet dhe rregullohet në mënyrë standarde nga *korteksi i përparmë* (parietal cortex) i majtë, dhe *cerebellum* i djathtë. *Tonaliteti, ndërtimi i strukturës muzikore rreth një akordi qëndror*, vlerësohet nga *korteksi parafrontal*

(prefrontal cortex) dhe cerebellum (Abram, 2015).

Muzika është në gjendje të bëhet pjesë e shumë funksioneve të trurit, që nga ana e tyre luajnë një rol të pa ndarë, me funksione të tjera më tëlarta të trurit, siç janë *kontrolli motorik, memorja, gjuha, leximi dhe emocioni*. Hulumtimet kanë treguar që muzika mund të përdoret si një metodë alternative për të hyrë në këto funksione që mund të jenë të padisponueshme përmes *stimulit jomuzikor* për shkak të një çrregullimi.

Muzikologjia konjitive hulumton përdorimin e muzikës dhe si mund të sigurojë gjithashtu *rrugë alternative* të transmetimit për përpunimin e informacionit në tru, për sëmundje të tilla si *Parkinson* dhe *Disleksia*.

Fokusi i studimit të Niels Trusbak Haumann është *prezantimi i kërkimit themelor empirik* për muzikologjinë konjitive. Autori i këtij studimi shtjellon hulumtimet e qasjeve *atomistike, gestaltit, qasjes funksionaliste, testimi të aftësisë muzikore, qasjet behavioriste, qasjes konjitive dhe neuroshkencore* për psikologjinë e muzikës, të cilat ndërthurin dhe shtojnë *këndvështrime* dhe *metoda* të mëtejshme në ato paraprake.

Metodat e hulumtimit të shkencave humane dhe të shkencave natyrore të prezantuara në këtë libër, u zhvilluan pas zbulimeve nga fundi i shekullit 19-të dhe fillimi i shekullit 20-të.

Mund të argumentohet se ndërthurja ndërdisiplinore e metodologjisë nga shkencat humane dhe natyrore të *muzikologjisë konjitive*, bën të mundur që të minimizohen kufizimet e secilës qasje individuale. Hulumtimi ndërdisiplinor krijon gjithashtu mundësi për sinteza të reja të teorive dhe zgjidhje të problemeve metodologjike në teorinë moderne të muzikës, psikologjinë konjitive dhe neuroshkencën konjitive.

Pjesa përfundimtare thekson shkurtimisht dialektikën më të rëndësishme historike në një diskutim rreth problemeve të përgjithshme, të qenësishme metodologjike dhe mundësive që mbeten të përshtatshme për *muzikologjinë konjitive* në ditët e sotme.

Autori i studimit është mbështetur në një bibliografi shumë të pasur (ka cituar 206 autorë), bashkëkohore për muzikologjinë konjitive duke sjellur në këtë studim shkencor, mendimin dhe hulumtimet bashkëkohore në Europë dhe SHBA.

Përkthimi dhe botimi i studimit "*Hyrje në Muzikologjinë konjitive*" me autor, *Niels Trusbak Haumann* është një mundësi e mirë për studentët, profesorët dhe studiuesit e muzikës, psikologjisë, mjeksisë, shkencave kompjuterike, shkencave natyrore e shoqërore si dhe të

shkencave mjekësore teknike, për t'u njohur me të rejat shkencore në muzikologjinë konjitive.

Personalisht jam njohur me këto fusha të reja ndërdisiplinore, në një eksperiencë studimore në Danimarkë, gjatë vitit 1996. Kam bërë kërkime të tjera, në rrafshin shkencor, gjatë vitit 2008 në Universitetin "Ca Foscari" Venecia, ku kam hulumtuar mbi literaturën për terapinë e muzikës, muzikologjinë konjitive, si dhe kam përfunduar studimet pasuniversitare, duke marrë titullin Master i Shkencave.

Gjatë punës sime në degën e psikologjisë, në Universitetin e Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*", jam marrë me kërkim shkencor, si dhe kam zhvilluar disa teste, me studentët, në institucionet shëndetësore, edukuese dhe rehabilituese, për sa i përket terapisë së muzikës dhe muzikologjisë konjitive. Kam marrë pjesë në disa konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, ku ndër të tjera, kam trajtuar tema në lidhje me muzikologjinë konjitive, terapinë e muzikës për *Disfazinë, pacientët Kardiovaskular dhe Alzheimer-Parkinson*.

Përfundime: "Muzikologjia konjitive është një fushë e re".

Muzikologjia konjitive është një fushë relativisht e re. Sidoqoftë, ajo ka një prapavijë të pjesshme, 150-vjeçare historiko-shkencore në traditën e psikologjisë së muzikës. Psikologjia e muzikës dhe muzikologjia konjitive kombinojnë studimin e muzikës me vëzhgimet në mekanizmat psikologjikë që nënvizojnë perceptimin dhe performancën e muzikës.

Psikologjia e muzikës u shfaq rreth viteve 1850-1870, një periudhë në të cilën u paraqitën teoritë ndërdisiplinore, zbulimet shkencore dhe formula matematikore për marrëdhëniet midis valëve fizike tingëllore dhe perceptimit të muzikës. Gjatë periudhës midis viteve 1870 dhe 1930, psikologjia e muzikës u zhvendos në qasje të ndryshme. Qasja atomistike përqendrohet në parametra të vetëm muzikorë, si tonet e vetme, rrahjet, ose cilësitë e tingullit, ndërsa qasja gestaltit prezanton parime për organizimin e muzikës në modele, siç janë meloditë dhe ritmet.

Qasja funksionaliste prezanton gjykimin e funksioneve muzikore dhe mekanizmave të evoluar që shërbejnë për qëllime specifike në bashkëveprimet e njerëzve me mjediset e tyre shoqërore dhe fizike, për shembull, mekanizmat për të luajtur instrumente muzikore ose për të përjetuar emocione kur dëgjoni muzikë të një kulture të veçantë.

Qasja e testimit prezanton teste muzikore me qëllim të matjes së niveleve të aftësisë muzikore, për shembull, për të bërë dallimin midis jomuzikantëve, muzikantëve amatorë dhe muzikantëve profesionistë.

Qasja behavioriste prezantoi metoda më precize dhe më të besueshme për matjen e ndryshimeve fizike në sjelljen njerëzore si përgjigje ndaj muzikës. Qasja më e fundit konjitive kombinon degët tradicionale të psikologjisë së muzikës, duke përdorur metodat më të reja të modelimit kompjuterik dhe metodave të skanimit të trurit, shpjegon se si proceset konjitive dhe kujtimet ndodhin në mendjet dhe trurin e njeriut dhe si këto procese e kujtimet ndikojnë në përvojën tonë dhe performancën e muzikës. Mund të argumentohet se ndërthurja ndërdisiplinore e metodologjisë nga shkencat humane dhe natyrore të muzikologjisë konjitive bën të mundur që të minimizohen kufizimet e secilës qasje individuale. Gjithashtu, hulumtimi ndërdisiplinor krijon mundësi për sinteza të reja të teorive dhe zgjidhje të problemeve metodologjike në teorinë moderne të muzikës, psikologjinë konjitive dhe neuroshkencën konjitive. Prandaj argumentoj që *muzikologjia konjitive* është një qasje premtuese, bashkëkohore ndaj psikologjisë së muzikës, me themel të fortë historik.

EDICIONI XII, VITI 2019

Frano KULLI

**MBAMENDJET E ARDIAN NDRECËS
SI DËSHMI E NJË KOHE QYTETËSE TË LINGATUEME ¹
- Shënime rreth librit “Pa pikë pa presje”, botim i “ONUFRIT”**

Filli i mbamendjeve, në librin e sapodalë, të Ardian Ndrecës nis në rrugicën e vet në Shkoder. Rrugica *me erë myshkut, me erë gjellësh me të velë, me erë lulesh e me erë tingujsh*. Asht njena prej rrugicave të Shkodrës. Në fillimin e viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluem. Era e myshkut të vjerrun muresh, si peisazh i pezulluem, i shpërfillun e i lanë mbas dore, era e gjellëve me të velë, si gjendje e vobektë e jetesës

hjekakeqe e të neveritshme. Kurse era e luleve dhe era e tingujve përkundraill, si flad mbas zhegut zhuritës, si limfa që lidh e ushqen qelizat e jetës së mpime qytetëse. Ai langu gjallnues që ndërlihd segmente të njimbasnjishme të zigzakut të saj, ulje zbritjet e shformueme edhe kur rrugëtimi i saj asht në zgript.

Qysh në krye të herës, tue sjellë të vizatueme rrugicën e fëminisë së vet autori ngul një gozhdë ku lexuesi mundet me lidh për të fillin e leximit, e masandej nuk i dahet, por e ndjek këtë fill me të shpejtë, me shumë dëshirë e kureshtí. Se leximi akt kurreshtijet e dëshiret asht...

Kur më paten ra në dorë kujtimet e Simon Rrotës ”Po shkruiej për

vedi ...”, më qe ngulë ma thellë në vetëdije kërkesa e unshme që ka leximi, po edhe ma përtej, vetë kultura e vetë qyteti, për mbamendjet e shkrueme. Një shkak i fortë ka qenë, besoj unë, mirëpritja befasuese e librit me kujtime nga jeta qytetse e piktorit, themeluesit të shkollës së këtij “harti” në Shqipëri, ardhur prej një shkollimi shumë të mirë nga Akademia “Brera” e Arteve të Bukura të Milanos. Ndoshta shlirësia mahnitëse e ndershmëria e dallueshme e rrëfimit janë gravitacioni që lexuesin e ban me i përthithë me një hurm ato. Vetë mjeshtri i “hartit” i kishte mbyllë sytë, prarue në bindjen e thellë se gjithçka që kishte lanë të shkrueme do të ishte asgja ma tepër se një tubë kujtimesh të tijat, për të afermit e vet. Kujtimet përreth qytetit të tij të lindjes e të vdekjes. Dhe kaq.

Mirëpritja që i ra me qenë me të vërtetë një surprizë edhe për lexues genuinë të qytetit e ma përtej, por edhe për të tjerë ma të afërt në kohë me kujtimet e librit të piktorit, ka ndodhë gati 60 vjet mbasi ato ishin shkruet...

Ardian Ndreca, me librin “**Pa pikë pa presje**” të mbamendjeve të veta na ban një ftesë dashamire për me vizitue një tjetër kohë, atë të 40-50 vjetëve të shkueme; një kohe e lingatueme keqas prej rropullisë ku ishim gjindë pa dashjen e vullnetin tonë. Dhe, mua , përmbas leximit të mbamendjeve të shkrueme me sqimë, më duket se ja ka mbërrit me na e sjellë këtë copë kohë me të dukshmet e të nenkuptueshmet e saj, me tragjikën e saj e me komikën gjithashtu... Tash qyteti e kishte të skicueme mirë siluetën “e re”. Bëxhisteni i famshëm me rreshtin e 1500 dugâjve [dyqane, njësi tregtare], pa numrue agjensitë tregtare e zyrtat doganore, ishte rrafshu e tregu ishte transefue ma nalt në verilindje të qytetit. Si një tjetër pazar, që të vetmin ndryshim për mirë kishte sjellë ndrrimin e emnit të parë me etimologji turke me një tjetër emen të pa emen - **fishë**, që me siguri ka dashtë me përcaktue vendtregtimin e prodhimeve bujqësore e blegtorale të katundit. Aty mund të shifshe shllakas të vujtun me ndonji barrë qymyr...po edhe gra zadrimore të hijshme me burrat përkras, të unshëm me shit mallin, dikund të mshehun aty prej përndjekjes dhe, në fund të ditës me mujtë me ble një a dy bukë gruni 40 lekshe, e dëshirueshme prej fëmijve të katundarit që e prodhonte grunin! Por në dhjetëvjetshin e fundit të shekullit të XX, tolloni e radhat e pafundme për me mujt me ble gjithçka të nevojës vetëm sa me u mbajtë gjallë e kishin zhvleftësue e zbehë te s’ban. Çdo lavdi e dikurshme, tash kishte râ me krye poshtë e ishte kthye në gjendjen e

saj komike... *Si fëmijë na bahej mendja kùbel [njilloj peshku i lumit Buna] tue kalue prej një dyqani në një tjetër tue përsëritë emnin e kryefamiljarit para shitëses që shenjonte në një rregjister. Nji ditë mbasdite nana, që punonte si rrobaqepse në shtëpi, më nisi me ble 10 lekë susta e un iu drejtova shitëses: Gjon Ndreca 10 lekë susta...*

Edhe pa ndonji qëmtim të vemendshëm fort, po vihet re dukshëm se shkrimtaria e mbamendjes, ka kohë që ka bâ vend në dëshiren e leximit; kur shpërfaqet si një zhanderr i tillë, por edhe kur ndërthuret e i “kacavjerret” letërsisë (*fiction-t*). E sa ma shumë i largohemi së shkuemes aq ma e ngutshme ndjehet kjo nevojë. Njisoj si me vënen, që sa ma e vjetër aq ma e kërkue me bahet. Por dihet se koha nuk ka fillim as fund; kufij e caqe në kohë ka jeta e personit në të. Janë personat rrëfimtari ata që e nderlidhin kohen prej një segmenti në një tjetër, prej një brezi të kaluem te brezi që asht e në brezin që vjen. Mbamendjet e shkrueme janë aq shumë jetëgjata ose aq pak jetëgjata sa ç’asht në vedvedi mjeshtria e autorit që i shkruan; sa ç’asht qëmtimi në to për me zgjedh e me i rrëfye ata që janë ma pikantet, ma të detajuemet prej tyne. Por që ndërkaq munden me u ba njëherësh edhe private për secilin lexues, i cili në të vertetë nuk i ka jetue ai vetë, por nga çasti i leximit tek ai shënohen si ndodhi e përjetime të vetë atij, njehsohen me të tija. Aq fort, sa me i pasë shkruet ai vetë. Përndryshe, nëse kjo nuk ka ndodhë, atëhere kujtimet e lexueme, ndalen aty e dahren në një anë si rraqe të vjetra, që s’i lypen kuj gja.

Ardian Ndreca, i vetëdijshe për këtë na e thotë qysh në dy fjalët e para për lexuesin se: *”nji libër kësodore nuk asht nji produkt i kërpitun,*[punë e bame mirë] *pse nuk ka gja ma të papërkryeme se kujtimet”*. Por, në të vërtetë kujtimet e tija të mbledhuna me nji përkujdesje të përimitë tue ia nenshtrove edhe një pezullimit a pushimit njëzetvjeçar në laboratorin e vet krijues, por edhe të lidhuna mirë me konsevantin e nevojshëm premtojnë me patjetër jetëgjatësi...

”Mund të kem qenë rrotull shtatë vjeç e me shkue në Shirokë më dukej si me shkue në nji botë përrallash”. (Mua, si njenit prej lexuesve të radhës më vjen si i bashkëshoquem një kujtim i fëminisë seme i kund nja nji dekadë të mahershme pyetja e bame me vetvedin: E ku lahen ata që s’kanë Drí ?!) Atje mandej, nder përshtypjet ma të para veçon të folmen e dallueshme të shirokasve me *“do zanore të hapuna”*. Që e mëson së parit prej nandajes. Kurse vonë, mjaft ma vonë në kohë të pjekunisë, atëhere kur interesi i rritun edhe për dijet në lamin e fonetikës

e ban me i njoftë në mënyrë ma të thellueme, dallimet në të folmen e bashkëqytetarëve të vet të anës lindore me ato të anës perëndimore.

Në anën lindore të Shkodres ku kanë jetue e jetojnë, kryesisht familjet katolike e në anen perëndimore deri në *Livade* në breg të liqenit përgjithësisht ato myslimane. Andej e këndeje janë banesat, veprat urbane. Bashkë me shumë tjeter, një pikë shumë e shenjueme e asaj çka ndan janë Vorret e Rrmajit. Themelue, siç asht e ditun nga gjysa e parë e shekullit XVIII... Shí atëherë kur edhe në Europë varrezat katolike spostoheshin për arsye humane prej oborreve e rrethinave të Kishave e projektoheshin e ndertoheshin Varrezat publike.

Autorit i kishte ndodhë përgjatë fëminisë, të gjindej ndërmjet të dyjave, me gjysen e kohës te nandaja te Arra e Madhe në lindje e gjysen tjeter në shtëpinë e prindve në anen perëndimore. Ngjante diçka si kontrapunt, e duhej me kalue ende do kohë me mujt me e kuptue se kjo ndërthurje bante pjesë në krijimin e njeriut të ri, monokron pa dallesa, sidomos të atyne elementeve që lidheshin me përkatësi fetare. Qysh në klasën e parë pashë se “kishte edhe fjalë të tjera që un i shqiptoja ndryshe prej shokëve të shkollës. Un thoja *giu* ndërsa ata thonin *gju*, unë *giuhca* ata *gjuhca*, *kjoftë* për *qoftë*, *ndoshta* për *belqida*, apo ndonji fjalë tjeter, që po të më ndiente nana në shpi vrante vetullat... Edhe emnat e luleve shqiptoheshin ndryshe kilometër për kilometër, tue mbetë po aq erëkandëshme e të hijshme. ***Dhe e gjithë kjo lojë***-nënvizon autori-***kërkonte një impenjim të vazhdueshem për me u idendifikue nga pikpamja gjuhësore me njenin prej grupeve, gja që lypte mund dhe vemendje, mbasi edhe luhajtja ma e vogël vërehej menjëherë dhe po të rrëshqisje në rregjistrat e gabuem rrezikoje me u duk qesharak ose edhe ma keq...***Ç’prej aty zen e forcohet ndoshta ekzigjenca e autorit, që ma vonë përgjatë gjithë shkrimtarisë së vet të derikëtushme të përdorjës me mjeshtri të dallueshme variantin gegë të “Gropës së Shkodres” që është edhe maja ma e epërme e naltimit të këtij varianti.

Mbamendjet ma të fundit që përkojnë me rropullinë e ndrrimit të sistemeve, djaloshin, që shkollen s’e kishte qejf po ishte nxanës i mirë e gjejnë në gjimnazin e ri të qytetit me emnin “Oso Kuka”, krejt i papërshtatshëm simbas tij... Veçse u gjend me fat që mësuesja e letërsisë ishte e mirë. Një njohje e herëshme e saj me Lasgushin e me një librin e tij të pabotuem kishte qenë shkaku që të vinte aty për takime letrare Ismail Kadareja. Emni i Osos, trimit të përmendun edhe në “Lahutë...” mund të vihej kudo tjeter po në shkollë s’kishte perse. Ashtu siç nuk

mufti me iu përshatë kurrë pranimit të morisë kryesuese të emërtimit të ri të rrugëve të Shkodres veç me emna të luftëtarësh. Dhe të vendosjes në qytet veç të monumenteve të luftës së fundit, kryesisht. Por edhe të dikatorit simbol i përbotshëm urrejtjeje, Stalinit. Me rrëzimin e tij, në mënyrë të tërthortë gjindet i përziem përmes djelmnisë kryengritëse shkodrane, ku protagonistë të të cilit ishin edhe Kola që e kishim kushri dhe shoku i tij Rini[Monajka]. Edhe me Dom Simon Jubanin, protagonistin e Meshës së parë në 4 nandorin e nandëdhjetës, kështu në rrethana të tërthora qe njoftë. I ishte dashtë me i shkue në shtëpinë ku jetonte, me një porosi prej Tiranet për të...Një mbështetje e përkrahje prej diplomatëve perëndimorë, për atë që prifti kurajoz e i martirizuem po bante. Mandej, të dielen në Meshën që prej atij çasti u bâ e famshme dhe...ikja.

Këtu mbamendjet e Ardian Ndrecës “mpiksen”. Me pengun paplotënisë për të, por mbasi na kanë lanë dëshminë e çmueshme të një cope të lingatueme të jetës sonë qytetse.

Jozef **RADI**



Qyteti i gjanave t'Mëdha...

N'Kafë të Madhe
e pijmë kafën t'hidhtë zeher,
gjithçka mbas saj ma e ambël bahet.

N'Kishë të Madhe,
dita e Ringjalljes së të Lumit,
thyen kambanat e një çerek shekulli ankth.

N'Arrë të Madhe
sythët plasën me cicërima zogjsh,
e marsi ndjen frikë me i dalë para prillit.

N'qytetin e Gjanave t'Mëdha,
 përqafen Liqeni, Buna, Kiri,
 edhe Drini (i Bardhi e i Ziu bashkë)
 Po njerzia n'Qytetit e Gjanave t'Mëdha
 s'trembet pse Kupol'e Krimet ka urdhnuë:
 “Drini i Kuq, qytetin ta përmbytë!”

Prill'i përgjakun

I vyshkën rrugët t'hikunit,
 e mbramjeve
 n'ecjaket e zbraza
 përplasemi ndër puthje
 të mbetuna pezull
 e heshtje t'acarta.

N'sythat e dritës s're
 rrin strukë Shpresa,
 po prillit ndër duer t'përgjakta
 i asht përlye vesa!

Qelqe andrrash grimcë n'sheshe
 gëzhoja t'hjedhuna si oriz dasme
 e lulet e paçeluna, tha!

O Zot!
 Edhe gëzimin n'nji fitorje
 e firmosën me gjak
 prej puthjesh t'këputuna!

I vyshkën rrugët e marsit t'hikunit,
 prillin e drandofilleve
 e përgjakën heronjtë e dhunës.

Statujat pa kokë në Muzeun Kombëtar

Kaq rrëqethse
kokat tueja t'humbuna ndër shekuj,
sa përditë m'bren dyshimi
n'ekzistencën teme!
Përpëlitem zgjuet dhe n'andërr
m'e bindë vedin se s'asht e vërtetë,
se kryet e kam e njasaj i bindem,
edhe n'se vuej, pa grimë droje e them:
se vuej bash pasjen e saj mbi supe!

Po ju, o bukuri t'lashta,
me pamje tronditëse,
ju o heroizma kryekputuna
që rrekeni me na bindë
se prej kohnash t'hikuna
te kohnat që shkojmë
t'parat, janë kokat që psojnë...

N'shpirtin tem,
nqethse mungesa e kokave tueja.
Gjymtimi juej net've më trazon!
E ndërsa vuej kokat tueja,
t'humbuna ndër shekuj,
kqyri vazhdimisht kokën teme,
që e mbyt n'dyshime kohën teme!

Pylli i Jetës

Ky asht njaj pylli
ku tana rrugët të thrrasin
e asnjena prej tyne s'të qet,
ku pemët, si gra t'hazdisuna, përfloken
e degtë zgjaten tue përtypë diell
ndër nofulla t'blerta.

E kam kërkue fajin e lindjes seme
ndër drunj e zgërbonja t'këtij pylli,
e kam ndjekë hap mbas hapi fatin e jetës
ndër fiskaja drite lshue qiellnajash
e bebzash t'zmadhueme prej territ,
besoja, se një zà vajze a zane
ka me m'mësue si vritet droja
e si hiket prej portave të ferrit.

E kam ndjekë prronin e shpresës,
mshehë ndër gjethe të vjeshtës,
pa mujtë me e gjetë as lumin, as detin.

Ja, ky asht njaj pylli zemërgjanë,
që t'vërtetën s'ta kallzon kurrë,
e dashunisht t'fal gjithçka,
veç mos me hikë prej tij...

Ahmet **PRENÇI**



ATDHEU

Atdheu u ngjitet shkallëve gjer në qiell
E poshtë zbret deri në zemrën e tokës;
Atdheu është pranverë që fryn si fyell
Dhe një kokërr mollë në prehërin e lokës.

Atdheu ngjitet kapilarëve, aortës sime
E zbret poshtë si drithërimë e zemrës;
Atdheu është bekimi i çdo fryme
Vështrimi im, ëndrra ime e shpresës.

Atdheu ngjitet në mal, zbret në fushë, lahet në det
dhe flokët i kreh në zjarr si Prometeu;
Atdheu s`ka mort, s`ka parajsë e ferr,
Tek të gjallët e të vdekurit është ATDHEU!

PËRJETIM

E varrosëm të vdekurin e rradhës
 Megjithëse ishte dimër me borë e me ngricë,
 Të vdekurit varrosen në të gjitha stinët
 Në të gjitha stinët kanë lindur një ditë.

Në lindje e në vdekje jemi kaq njerëzor,
 Në vdekje e në lindje s`jemi hipokritë.

KULLA

Po shembet kulla ime në fshat
 I ka rënë suvaja, hatullat, parvazet;
 Muret mezi mbahen në erën e thatë,
 siç mbahen me paterica sakatët...

Anuar kulla.
 I dhëmbin ijet.
 Kurri i dalë.
 Romatizmi ja ka mpir këmbët;
 Me syze miopi anuar në anë,
 Si nallane dhëmbët.

Qindra vjet do rronte stoike kulla,
 ndërtuar me gurë e gëlqere safi;
 E shkretë vatra e udha pa njerëz,
 siç vdes Planeti po s`pati njeri!

PËRSËRI NË ËNDËRR

Asnjëherë s`më ke ardhur në ëndërr si këtë natë shkurti.
 Trokite me flokët ngjitur në ballë si fije bari;

Shkrepëtimat - kërcitje kockash, binin e vinin nga qielli,
Por nuk ndizej zjarri!

Ne ishim bashkë.

Frikë nuk kishim as nga shejtani e as nga lugati.

Isha në ëndërr.

Çizmet më mbetën në dëborë dhe ecja këmbëzbathur;

Kisha ftohtë.

Kisha frikë se nga i ftohti do të plaste kupa e qiellit si lëkurë gjarpëri;

Ndaj të mbështolla me trikon time të leshtë.

Ndeza një zjarr në zemër,

E prapë kisha frikë se do të ngrish në gardhin e natës si lule marsi.

Dhe të mbështolla me shpirtin.

E kur u zgjova isha zbuluar nga kujdesi për ty.

Pastaj hyri nëna si Hirushe e na mbuloi me një velenxë të artë të
dyve...

I NGUJUARI

Vetmia ja ka grryer shpirtin,

Fati si sorrë e zezë e ka ndry,

Si shigjeta të holla dritat ja shpojnë sytë

Më kot pret shpresën, kaq imët t'i vij.

Udhë gjaku n'sy. Sterrinë!

Të vetmet lajmtarë, korbat. Mënxyrë!

Pus i thellë në kraharorë. Shkretëtirë!

Natë e pafund kjo kthinë. Errësirë.

Udhëton dhimbja bashkë me të

Brenda një dhome kyçur,

Zotit - ja ka mbaruar krejt lutjet.

Bashkim **GOLEMI**



MASKAT BIEN

Çdo ditë
bëj gjithçka mundem.
Përpiqem të jem
sa më afër emrit
Njeri.
Ëndrrat t'i mbaj të ndezura
në flakën e shpresës.
Të jetoj.
Të kapem mbas tyre.
Të mos ikin të vetmuara.
Qoftë dhe një çast
do të doja të isha
mbi krahët e tyre
në një hapësirë pa peshë.

Të jem vetëdije
në ajrin e elektrizuar.
Ku maskat bien.
Dhe sipari ngrihet.
Një botë e zhveshur
pa ngjyra fals, ku e shëmtuara vrapon
pas errësirës.
Duke u përpjekur të fshih fytyrën e saj.
Thjeshtësia shkëlqen në ngjyra ylberi.
Në shtatë shqisat e fytyrës
sinqeriteti si një copëz diell
dhuron ngrohtësi.
Në botën lakurique
Në boten pa maska.
Do të doja të isha!

BUZË LUMIT

I mbështetur në parmakun e shëtitores,
i lodhur,
brenda një trishtimi ku vdes,
çdo dëshirë, shikoj rrjedhën e lumit.
Pranë meje,
pedonalja e mbushur me jetë,
të thirrura, të qeshura,
cicërima fëmijësh e
vështrime kureshtarësh.
Ndërsa rrudhat e ujit
nga era e lehtë e mbrëmjes,
vjedhin vështrimin tim
të përhumbur, pa dritë.
Le ta marre lumi me vete!
Ta shëtis mes natyrës, në ajrin e freskët të ujit që
vrapon drejt detit,
shtratit të përhershëm.

Herë të qetë, herë të zemëruar,
që përkëdhel dhe godet fuqishëm,
si vetë jeta.
Hëna mbretëron lart në qiell.
Si projektor gjigant rrezaton qetësi.
Miliona vështrime puthen
nën madhëstini e saje.
Ëndrrat thurin çerdhen e tyre,
dhe ndërthuren
duke transmetuar në tokë
magjinë e jetës.
I çliruar nga ankthi
i pritjes dhe mungesës
ndihem i lehtësuar, i përqafuar nga jeta.
Ndjenja pranë frymëmarrjes tënde.
Valët e dëshpërimit derdhen në dete.
Në sa, zëri yt troket në zemrën time
Dëshirat tona u përqafuan në hënë.
Dhe zbritën si shkrepitima dashurie,
në gjirin e jetës.

EDICIONI XIII, VITI 2020**Ag APOLLONI****GOETHE- HAUS**

Unë erdha në shtëpinë tënde sivjet,
ti në shtëpinë time ke ardhë shekullin e kaluar.

Ishte fund i prillit e unë isha ende fëmijë
kur më more përdore më çove në tavernë.

Atë natë e hapa universin si një pergamenë.

Tash jam rritë,
në tavernë shkoj vetë dhe dehem sa të dua.
Herë qeras unë djallin, herë djalli mua.

Tash ti nuk je, e shtëpinë ta kanë bërë muze.
 Nuk më lanë të prek asgjë tënden, as qelq, as letër.
 Rojet më panë me bisht të syrit sikur e dinin
 që shkrimtari i ri vjedh nga shkrimtari i vjetër.

Sot, n'shtëpinë tënde, nuk më pritën si mik, po si hajn,
 këtu në Der Grosser Hirschgraben, në Frankfurt am Mein.

FLETA E FUNDIT **(Lavde për lapën)**

Luhatet fleta e fundit në degën e
 pemës së zhveshun,
 në betejë me erën si i mbrami ushtar.
 Luhatet në erë gjethi i fundit si fleta e
 fundit e librit mesjetar.
 Mbahet për pemë me duer e me
 dhambë,
 me ra prej majës në baltë nuk asht
 punë e lehtë.
 Ajo e di se atë që bie e shkelin me
 kambë, po asht lapë e lumtun se në tragjedinë
 e stinës asht e fundit fletë.
 (*Në pjesën juglindore të Kosovës, lapë i thonë gjethit)

CAFÉ PROCOPE

Kafja është më e fortë se kështjella,
 Kamerieri më i pushtetshëm se mbreti.

Më besoni, se unë vij nga sheshi Konkor!

Nga bedenat mbreti pyeti: çfarë dëshironi?
Populli i tha: si s'të vjen turp që pyet?

Nëpër sheshin Konkor era vërtiste pamfletet
Mbi kokat e nxehura.

Nga banaku kamerieri pyeti: çfarë dëshironi?
Volteri ua shkeli syrin Rusoit, Didëroit e Kondorsetit,
mandej porositi kafë dhe kokën e mbretit.

Kafet vonuan, tri koka u thinjën e shkuan,
Ndërsa kapelat frigjiane përtypnin pamfletet e Prokopesë.

Mandej zemërimi i zemrave të lidhura ziente në shesh.

Nga bedenat erdhi mbreti drejt në gijotinë.
Nga banaku kamerieri e solli porosinë.

Garson, je vonuar dhe porosinë e ke ngatërruar,
i tha Kondorseti kamerierit duke buzëqeshë,
Ne kërkuam kafë e mbret, ti na solle edhe mbretëreshë.

(Shënim: Café Procope ka qenë vendtakim i filozofëve
iluministë, të cilët aty i shkruanin pamfletet që i prinë
revolucionit francez)

AG APOLLONI

Dhe ra drita një natë mbi kodrën Anchiano,
Dhe e panë tre të urtit nga bregu i lumit Arno.

Dhe në Ponte Vecchio, në Piazza della Signoria
Dhe në Duomo thonë se ai ish Biri ku bunte dija.

Dhe gjurmët e gjeniut gjenden sot rrugëve me gur,
Dhe botën e mendojmë pa Zot, por jo pa një pikturë.

Dhe e dimë se dashuria e tij kish huret e një muze,
Dhe nuk e zgjidhim dot sekretin e cepit të një buze.

Dhe me shpikjet e tij endemi në ajër, tokë e ujë
Dhe e dimë se erdhi qetë, por pas la art dhe bujë.

Dhe në spitalin e Firenzes bëhem njeriu vitruvian
Dhe më pagëzojnë me zjarr, më bekojnë me temjan.

Dhe e mbyll ungjillin e artit si shenjti n'trans kur bjen.
Dhe në emër të Artit, Birit e Shpirtit të Shenjtë. Amen

Durim TAÇI

FJALIA

tregim



U desh ngacmimi cingritës i piklave të fundit të ujit mbi lavaman, fill pasi mbylli rubinetin, që ai të vinte në vete, të kuptonte se si ka mundësi i qe dukur krejt normal ai gjesti i saj i mëhershëm, një e tundur koke që ai të linte mbledhjen e bordit e ta ndiqte pas, zakonisht për të pirë cigare, veç më tej pasuan fjalët mikluese, kolegia e ftoi të merrnin makinën e të bënin një shëtitje tek vila e saj në liqen, tevona e njëjta gjë me shëtitjet në kopsht, kapur përdore si rastësisht e, së mbrami ngjitja lart, një aperitiv në verandë, një e çikur e saj me majën e gjuhës rrëzë veshit, puthje, zhveshja e vrullshme e rrobave tek njeri-tjetri, rënia në shtrat, harkimet e rënkimet e trupave deri në djersë, - asgjë nga këto, pra, nuk i kishte kujtuar peshën e fajit – as gatimi i saj, ngrënia bashkë, trokitja e gotave me verë të kuqe, jo, ishte vetëm ajo larje bashkëpunuese e pjatave, e enëve, e lugëve, e pirunëve, tharja pastaj me pecetë, ajo që ja kalonte e ai që i fshinte dhe i vendoste me radhë në lavapjatë, një e nga një, - veprim që nuk e kishte bërë ende asnjëherë me gruan e tij – gjest i cili tani, ngacmuar fort nga shqisa e dëgjimit, e kishte bërë ta ndjente deri në palcë fajin e të hidhej përpjetë, si pa peshë aq sa tjetra u tremb, e pa me frikë, mbase edhe ngaqë ai kishte ende një nga thikat në dorë, të cilën nuk e la në vend, por

e futi në xhep nga hutimi dhe u turr për nga dera, me ca lëvizje që të bënin për të qeshur e ajo u gajas në fakt, edhe kur e pa nga xhami se si i nxori dorën autobusit të linjës, deri aty se pastaj ai do të linte pas shpine muzgun e do hynte në qytezën e tij, në rrugën e tij, në shtëpinë e tij, gati për t'i rënë në gjunjë gruas për atë që kishte bërë, por ja që duhej të priste ca kohë e i shkrepiti të përqaftonte fëmijët si fillim, të cilët e shikonin të habitur, derisa ai vetë nuk e duroi më gjendjen e tyre yshtur nga sjellja e tij siç duket e çuditshme, pyeti dhe i thanë që mami kishte shkuar të bënte joga, kështu që i hipi biçikletës, mbërriti tek palestra dhe priti, kaloi kohë, askush nuk po dilte, portieri i tha se seanca kishte mbaruar, gratë kishin dalë e ai duhet të besonte, të kthehej, por nuk e bëri, hyri brenda dhe heshtja aty në korridor e grishi më shumë për të shkuar deri në fund, shtyu derën e parë që pa, për drejt, pa zhurmë dhe gjeti gruan e tij që puthej me instruktorin, në fakt, pa vetëm një shpinë burri gjithë muskuj, fytyra e të cilit ishte mbuluar nga flokët e saj të dendur, si poshtë një çadre në shi, e më poshtë fustani i saj i kuq ashtu i hapur iu duk si një njollë e madhe gjaku, sidoqoftë këta nuk e panë, prandaj ai u kthye pa u vënë re, armëzbrazur, i detyruar ta presë në shtëpi, derisa ajo erdhi pas një ore, u përshëndetën si çdo darkë këto vitet e fundit, por nuk u sqaruan, nuk folën, fjetën e u zgjuan, morën rrugët e tyre të nesërmen, ai do bënte një bredhje në qytet me duart rrasur në xhepa, pa dëshirë për të vajtur në zyrë, edhe pse aty mund të shikonte sërish atë, se punonte arkitekt në një studio projektimi, por prej do kohësh mund të bënte çfarë të donte se punë nuk kishte, kriza kishte pllakosur gjithandej, kurse ajo ishte mësuese liceu, martuar me të prej njëzetë vjetësh, shkonte çdo ditë në shkollë dhe, tani që fëmijët ishin rritur, pasdite, kish filluar të merrej me joga e kështu do të kalonin ditë të tjera dhe burri do e priste me tradhtinë e vet në gji që ajo t'i shpjegohej, le të fliste edhe ai pastaj, le të çliroheshin që të dy e të merrnin një vendim, nga ata që fëmijët nuk ua falin kurrë prindërve, ndarjen, por gruaja nuk dukej të kishte asgjë për të thënë, kthehej çdo ditë paksa më vonë e paksa më e qeshur, kurse tek burri grumbullohej një mllef, i cili një ditë mori formën e vendimit, u përforcua e u bë konkret kur veshi xhaketën që kish pasur në trup një javë më parë e në xhepin e djathtë të saj zbuloi thikën e marrë me vete rastësisht, dërguar nga fati për dorën e një burri që e lan tradhtinë me gjak, kështu përfytyroi kronikën e zezë në mbrëmje, dy fëmijët e tyre që qanin, fytin e prerë të nënës së tyre, ambulanca, makina e sinjale të ndezura e ai me duart

lidhur pas me pranga, pamje e cila nuk i pëlqeu, sigurisht, por nuk ju duk diçka e habitshme e, kjo e befasoi, nuk shikonte dot rrugë tjetër, ndaj eci në këmbë, shtrëngoi fort thikën në xhep, sa u pre e u gjakos se mbërtheu tehun në vend të dorezës, gishtat ju ngjitën pas metalit e preferoi t'i mbante pastaj ashtu, teksa nga bezja bezhë e xhaketës lino njolla përhapej, i vinte të kujtonte gjithë jetën e tyre, si ishin njohur, ajo që i kish ngritur dorën teksa ai ngiste makinën për ta çuar deri tek stacioni i trenit, ai që nuk e njihte qytetin, xhironte e humbiste, sillej pa pushim, në ankth me kalimin e minutave se mos tjetra mendonte se e bënte me qëllim, derisa i thotë asaj të zbresë, nuk është i zoti ta çojë në destinacion, por ajo nuk pranon, i thotë se ky mbase paskësh qenë destinacioni i tyre, të sillen bashkë në kërkim të një shtegu e që atëherë studentë në atë metropol, do të takoheshin shpesh, do të vendoseshin më vonë në qytezën e saj, do të martoheshin e do të bënin fëmijë, gjithçka do të shkonte mirë deri tek kriza, pastaj investimet e gabuara familjare, sa erdh puna të mbaheshin vetëm me të ardhurat e saj, në pritje që gjithçka të ndryshonte, për të mbërritur deri në këtë pikë, kur hapi i tij i qetë po ecte i sigurt drejt fatalitetit e ja tani ka mbërritur në palestër, i shmanget portierit që po shikon një ndeshje futbollit nga celulari, hyn brenda dhe shtrëngon fort thikën kapur mirë nga doreza, teksa aty është po ajo heshtje, si herën e parë, dera po gati, sërish, vetëm për ta shtyrë, por ja që e gjen gruan vetëm, në gjunjë me çadrën e saj pis të zezë të flokëve ka mbuluar gjunjët, ai nuk është, po mbase me të nuk do kishte punë, në çdo rast, kur ajo e ndjen që hyn e ngre kokën, nuk befasohet kur e sheh, shkon e i hidhet në qafë, e përlotur, ai ndjen trupin e saj ti ngjitet si një kulpër e do ta shkëpusë nga vetja, po nuk e bën, dalin dhe ecin bashkë në rrugicën e tyre, metrat po mbarojnë, pas pak do të vijë shtëpia, burri kujtohet e nxjerr dorën e gjakosur, i rrëshqet thika në xhep, gruaja e sheh dhe befas i vjen keq, nuk di për rrezikun që i kanoset, i thotë ku ishte gjithë këtë kohë, nuk e kupton sa po vuante ajo, madje deshi t'i shpjegonte, por u step se nuk ishte e sigurt në mund t'i thoshte se donte ta ndante pikërisht me të, me burrin e saj, edhe dhimbjen për ndarjen nga i dashuri, i cili e kish braktisur shumë më shpejt nga sa e kishte bërë të njëjtën gjë indiferentizmi i të shoqit dhe po vonohej pa ditur se duhet të ecte shpejt, ta hapte derën para se dora e burrit që e kishte nxjerrë më në fund thikën të ngrihej e të godiste mbi zverkun e saj për të vrarë një herë e mirë aty tradhtinë e vet.

Rudolf **MARKU**



Sa shpejt

Sa shpejt lotët thahen dhe nata
të premtan një fillim të ri.
Nëse ti e shmang çatinë
dhe vështron trenat që kalojnë pranë
në një nivel me shkallët
që ofrojnë siguri.
Madje mund të përfytyrosh edhe fluturimin
drejt një vendi që nuk ia gjen as emrin.
Joshja e rënies së lirë,
për fat, është larg, në libra fizike,
në formulat e ngatërruara të Isak Njutonit.
Por ti mos qaj në korridor,
qoftë dhe fshehurazi nga të tjerët.

Ji mirënjohës që më së fundi i lyen
në ngjyrë kanarinë muret e dhomës.
Kafazi yt është në ngjyrë të çelët,
kafazi yt është i ngrohtë, i mirë,
s'ka arsye t'u prishësh gjumin të tjerëve,
nuk ka kuptim përpjekja të jesh i lirë.

Trishtim

Nuk ishte e lehtë të vështroja horizontet e largëta
nga bregu i detit. Të ëndërroja për vendet që nuk do t'i
shihja kurrë,
brigjet e Italisë, Francës, Spanjën,
Amerikën e Largët a Saharen e pluhurt e të shkretë,
Ishullin e Kruzos, vendet për të cilat flet Guliveri
dhe guvat e detit që më kujtonin se njeriu gjithmonë do ta
ketë shtëpinë e vet.

Njeriu udhëton nëpër botë që ta zbusë trishtimin.

Përherë e më shpesh bredh nëpër botë; nga brigjet e Paqësorit
a nga ishujt e Atlantikut,
Nga lartësia e Murit të Madh a nga një ajsberg në Antarktikë,
ngrihem në majë të gishtërinjve që ta shoh edhe një herë
atë fëmijën që e lashë në bregun e Adriatikut,
duke ëndërruar për vendet e panjohura që nuk do t'i shihje
kurrë.

Trishtimi më thotë se ende nuk e kam nisur udhëtimin!

Migjeni

Duke ecur deri vonë, shumë larg, larg,
U vonua.

Në fillim leximet, rreshtat, fjalët,
pastaj fjalët që nuk ishin më fjalë,
fshatra, qytete, pllaja, vetmia e poetit,
rrëzimi i idhujve, vështrimi i një gruaje në kalim,

Vdekja filloi të mos kishte më durim.

Pastaj prapë rrugët, thasët e grisur, humnerat,
malet, lypësit, vetmia e poetit,
pastaj pyetja; Këngë e vaj, ç'je? - Hapësirat e mjerimit,
dhe ecja, ecja, ecja, kurrë pa fjetur,

Derisa u bë tepër vonë për të vdekur!